# RAPORT PËRFUNDIMAR MBI
# " AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË USHTRUAR NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT LEZHË, SHKODËR , KUKËS


| | **Përmbajtja** | 1 |
|---|---|---|
| **I.** | **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** | 2-2 |
| | 1.Përshkrim i shkurtër Raportit Përfundimtar | 2-2 |
| | 2.Përshkrim i gjetjeve kryesore | 2-7 |
| | 3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit | 7-10 |
| **II.** | **HYRJE** | 10-10 |
| | 1.Objekti i auditimit | 10-10 |
| | 2.Qëllimi i auditimit | 10-10 |
| | 3.Identifikimi i çështjes | 10-10 |
| | 4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese | 10-11 |
| | 5.Përgjegjësitë e audituesve | 10-11 |
| | 6.Kriteret e vlerësimit | 11-12 |
| | 7. Standartet e auditimit | 12-12 |
| | 8.Metodat e auditimit | 12-13 |
| | 9.Dokumenti i auditimit | 13-13 |
| **III.** | **PËRSHKRIMI I AUDITIMIT** | 13-13 |
| | Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim | 13-13 |
| | 2.Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit | 13-13 |
| | 1.Mbi hartimin dhe Zbatimin e buxhetit të shtetit zbatimin e kritereve dhe procedurave të hartimit të buxhetit (PBA) | 13-19 |
| Pika 1 | Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe pagave | 19-23 |
| Pika 2 | 3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin , ruajtjen , dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetar edhe mbajtjen e kontabilitetit konkretisht/Pasqyrat financiarë dhe plotësimin i bilancit dhe anekseve përkatëse sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave për ketë qellim.<br>-Inventarizimi i pronës shtetërorë dhe paraqitja e saktë të tyre në pasqyrat financiare. | 23-30<br>30-33 |
| Pika 3 | 4.Auditim I procedurave për dhënie mendimi nga DRM, për lejet mjedisore të Tipit A, B, si dhe vlerësimi i proceduarave me ndikim në mjedis, për (VNM) paraprake dhe të thelluara. | 33-59 |
| Pika 4 | 5. Auditimin inspektimeve, monitorimeve, kontrolleve të kryera nga sektori i Inspektimeve të Mjedisit dhe Ujërave në DRM. | 59-89 |
| Pika 5 | Auditimi i zbatimit të proceduarve për shkeljet e konstatuara dhe masat e marra deri në ekzekutimin e tyre. | 89-93 |
| Pika 6 | Të tjera gjatë auditimi | 93-99 |
| **IV.** | **GJETJET DHE REKOMANDIMET** | 99-106 |

| V. | ANEKSE | |
|---|---|---|
| | | |

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjencia Rajonale e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës kryen veprimtarinë në zbatim të VKM-së, nr.568,datë 17.07.2019,"Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së.

**I .1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit**

Agjencia Rajonale e Mjedisit, Lezhë, Shkodër, Kukës kryen veprimtarinë e saj referuar VKM-së, nr.568,datë 17.07.2019,"Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së., Ligjit Nr.52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit etj. ka për objektiv: dhënien e mendimeve për leje të Tipit A, B mendime për VNM paraprake dhe të Thelluara, monitorimin e subjekteve të licencuara, inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave ndaj subjekteve të pajisura me leje mjedisore, ndjekjen në rrugë gjyqësore deri në arkëtimin e e tyre ndaj subjekteve që janë marrë masa administrative me dënime (gjobe) si dhe si veprimet financiare .

**I .1. Përshkrim i shkurtër i Raportit tëAuditimit**

**I.2** Përshkrim i përgjithshëm i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

| GJETJA NR. | PËRMBLEDHJE E GJETJES | REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR | RËNDËSIA | REKOMANDIMI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Për periudhën objekt auditimi, rezulton se Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës nuk ka hartuar dhe dorëzuar raportimet 4 mujore të monitorimit të buxhetit, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në kundërshtim me nenin 65 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". | Fq.13-19 | *E Mesme* | Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës dhe nënpunësi zbatues, në funksion edhe të planifikimit me eficiencë, të marrin masa për hartimin dhe dërgimin periodik të raporteve të zbatimit të buxhetit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për të gjitha periudhat e raportimit që përcaktohet nga kuadri ligjor. |
| 2 | Nga auditimi u konstatua se në 9 raste nga inspektorët nuk janë plotësuar listë verifikimet sipas nenit 39,41, të Ligji nr.10433 dt.16.06.2011"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe | Fq.62-70 | *E mesme* | Inspektoret e Sektorit të Mjedisit të marrin masa që në çdo inspektim të plotësojnë të gjitha rubrikat që përmban liste-verifikimi për |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ligjit nr.52/2020 "Për Lejet e Mjedisit "shtojca 4.1 etj...sipas aktiviteteve që kryejnë subjektet. | | | identifikimin e veprimtarisë që kryen subjekti sipas ligjit të sipërcituar. |
| 3 | Në inspektimet e kryera në terren, për plotësimin e procesverbalit të inspektimit nuk është i gjithë informacioni i nevojshëm duke u bazuar në kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti dhe zbatimin e secilit prej kushteve, si dhe të gjitha mangësitë e konstatuara nga ushtrimi i aktivitetit, sipas inspektimit në terren nga ana e inspektorëve, nuk ka përshkrime specifike mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore, konstatimet e inspektorëve janë të përgjithshme dhe për rrjedhim detyrat e lëna kufizohen në plotësim të dokumentacionit, si dhe kryerjen e dërgimin e vetë monitorimeve. | *Fq.59-65,* | *E meme* | Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të marrë masa, që në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, të përmirësojnë formatin elektronik, "pikën 3 Lloji i aktivitetit", me qëllim që të identifikohet saktë veprimtaria dhe aktiviteti i subjektit në rubrikën përkatëse. |
| 4 | Nga auditimi i ankesasve dhe shqetësimeve të mbërritura në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë,Shkodër Kukës, mbi çështjet e ndotjes së mjedisit, rezulton se shqetësuese mbetet mungesa e laboratorit dhe pajisjeve të akredituara, për realizimin e matjeve dhe nxjerrjen e përfundimeve. Deri në momentin e auditimit, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk janë marrë masa për t'i dhënë një zgjidhje këtij problemi. Në pjesën më të madhe të ankesave, në mungesë të laboratorit dhe pajisjeve matëse të akredituara, ARM nuk është në gjendje ti kthejë përgjigje qytetarëve nëse shqetësimi i tyre mbi nivelin e ndotjeve qëndron dhe rrjedhimisht të marrë edhe masat e nevojshme, siç përcaktohet në | Fq.93-95 | *E Lart* | Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë,Shkodër Kukës dhe grupet e punës sipas rastit, të marrin masa për garantimin e dokumentimit të çdo procesi apo veprimtarie të kryer nga këta të fundit, duke pasqyruar me hollësi situatën e konstatuar në terren, dokumentimin në formë shkresore të komunikimeve me institucionet e përfshira dhe përgjigjet e tyre, si dhe ndjekien e përmbushjes së rekomandimeve apo sugjerimeve të lëna për përmirësim nga subjektet private. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | kuadrin ligjor që sanksionon veprimtarinë e saj. | | | |
| 5 | Nga auditimi u konstatua se, programi vjetor i inspektimit për periudhën korrik 2020 dhjetor 2021, nuk është hartuar sipas përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjat "a, c, ç dhe d" të pikës 2 të Urdhrit nr.5, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve".<br>Gjithashtu programet mujore të inspektimit për periudhën korrik 2020 dhjetor 2021, nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi". | Fq.65-70 | *E mesme* | Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës në bashkëpunim, me sektorët e inspektimit, të marrë masa për subjektet e inspektuara, të bëjë një vlerësim të paraqitjes së tyre ndaj respektimit të kërkesave ligjore, ku në bazë të këtij vlerësimi të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët), e për rrjedhojë edhe frekuenca e inspektimit të tyre, gjatë planifikimit të inspektimit. |
| 6 | Nga auditimi u konstatua se 85 raste, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës për periudhën shtator 2020- dhjetor 2022, ka dhënë mendime për VNM paraprake/ të thelluar dhe për leje mjedisore të Tipit A, B, duke i përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Si palë e përfshirë në proces, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës nuk ka marrë informacione për vendimet e marra nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, veprime këto që janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe me nenin 11 të Ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis. | Fq.40-52 | | Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të kryejë korrespondencë zyrtare me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për vendimet e marra për VNM paraprake / të thelluar dhe me Qendrën Kombëtare të Biznesit për aplikimet për Leje mjedisore Tipi A/B dhe përditësimin në formë elektronike të regjistrit të lejeve të tipit A/ B dhe VNM-ve. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7 | Nga auditimi rezultoi se në 12 subjekte që ushtrojnë aktivitet, për nxjerrjen e mineraleve rërës dhe argjilës, nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur, nuk ka dokumentacion mbi Zërat Kadastralë të sipërfaqeve ku zhvillohet ky aktivitet, nqs janë apo jo pjesë e fondit pyjor kullosor që duhet hequr nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në momentin e pajisjes me leje shfrytëzimi. Veprim në kundërshtim me VKM-së, nr.391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave "pika 8 i cili përcakton: "8.Për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 8, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi "Lidhja 8 "Tarifat e shpërblimit të dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor" pika 1. | Fq.35-45 | *E Lartë* | Agjencia Rajonale e Mjedisit, Lezhë,Shkodër Kukës të marrë masa që në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të përcaktojnë sipërfaqet janë apo jo pjesë e fondit pyjor kullosor ku zhvillojnë aktivitet subjektet për nxjerrjen e mineraleve për të konstatuar dhe evidentuar situatën e gjendjes së mjedisit, ekzamininimin e dëmtimeve në mjedis të shkaktuar nga aktiviteti i tyre si dhe në raste kur ka shkelje të bëhet përcaktimi i vlerës së dëmit dhe kërkimin e rehabilitimit të këtyre parcelave në përputhje me planet e mbarështimit të pyjeve të NJQV-ve. |
| 8 | Nga auditimi u konstatua se, për periudhën shtator 2020- dhjetor 2022, në 97 praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B. | Fq.36-40 | *E Lartë* | Sektori i Lejeve,në praktikat e dhënies së mendimit për VNM apo mendime për Leje Mjedisore Tipi A/B, të bashkëlidhindhe përfshijnënëdosje dokumente plotësuese dhe mbështetëse, që të vërtetojnë realizimin e procedurave në dhënien e mendimit. |
| 9 | Nga auditimi u konstatua se, programi vjetor i inspektimit për periudhën shtator 2020 dhjetor 2022, nuk është hartuar sipas përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjat "a, c, ç dhe d" të pikës 2 të Urdhrit nr.5, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve". Gjithashtu programet mujore të | Fq.70-74 | *E Lartë* | Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës në bashkëpunim, me sektorët e inspektimit, të marrë masa për subjektet e inspektuara, të bëjë një vlerësim të paraqitjes sipas kërkesave ligjore, ku në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | inspektimit, nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi. | | | bazë të këtij vlerësimi të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët), gjatë planifikimit të inspektimit. |
| 10 | Sektori i Mjedisit dhe Burime Ujore Lezhë, Shkodër, Kukës, gjatë periudhës 01.09.2020 deri 31.12.2022, nga inspektimet e kryera, në 38 (tridhjetetetë) raste janë vendosur sanksione kryesore ligjore (gjoba) në vlerën e përgjithshme prej 9,330 mijë/lekë.<br>Për **8** subjekte në shumën **930 mijë/lekë**, nga ana e ARM Lezhë nuk është ndërmarrë asnjë hap për të filluar procedurën e arkëtimit të gjobave, pavarësisht se janë brenda afatit Gjoba e vendosur gjatë muajit Shtator 2020, për subjektin R. 2015,prej **50 mijë/lekë, është parashkruar.** | Fq.78-82 | *E Lartë* | Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, deri në arkëtimin e plotë të gjobave të vendosura, duke nisur me ato gjoba që janë më afër afateve të parashkrimit 2 vjeçar, si dhe t`i është drejtohet Ministrit, me propozimin për pezullimin e lejes së subjektit, i cili nuk ka paguar gjobën. |
| 11. | Nga auditimi u konstatua se Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, për 20 subjekte (për plotësimin e dosjeve të subjekteve me dokumentacion si dhe të dosjeve në sistemin e-Inspektimeve duke aplikuar masa administrative) për subjektet të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e vetmonitorimit/vete monitorimit mjedisor si dhe dokumentacion ligjore, Nga auditimi u konstatua se Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, për 20 subjekte (për plotësimin e dosjeve të subjekteve me dokumentacion si dhe të dosjeve në sistemin e-Inspektimeve duke aplikuar masa administrative)për subjektet të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e | Fq.60-71 | *E Lartë* | Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të hartojë programin e inspektimit për 20 subjekte, të cilat nuk kanë plotësuar raportet e monitorimit mjedisor si dhe dokumentacion ligjore dhe për këto rastet të konstatuara me shkelje, të aplikojë masa administrative me gjobë. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | vetmonitorimit/vete monitorimit mjedisor si dhe dokumentacion ligjore. | | | |

## A. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

**1. Për auditimin e përputhshmërisë**

Ne kemi audituar veprimtarinë e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, përsa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord kriteret, e auditimit të përputhshmërisë dhe bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të krijuar me VKM-së, nr.568,datë 17.07.2019,"*Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*", dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së"*, anë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës. janë evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar/kualifikuar.*

**Baza për opinionin (I modifikuar/kualifikuar)**

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, si vijon:

-Në pasqyrat financiare u evidentua se transaksionet financiare të realizuara gjatë aktivitetit të subjektit, të cilat paraqiten në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të vitit 2022, paraqiten në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, në kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

- Për vitin 2022, janë nxjerrë pasqyrat financiare, sipas ligjit nr.25/2018, datë 10.05.2018 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* dhe UMF nr.8,datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".*

-ARM Lezhë, Shkodër, Kukës, (Sektori i Financës) nuk ka hartuar/plotësuar regjistrin e aktiveve formati i të cilit përmban datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, kohën e shpenzimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes , datën e daljes nga pronësia, në moszbatim të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* pika 82, 30.

- Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, (Sektori Ujëra) gjatë periudhës Qershor 2021-Dhjetor 2021, ka ushtruar inspektime në 57 subjekte,por në këto inspektimet nuk përfshiihet veprimtaria e subjektit lidhur me ujërat, por vetëm për puset. ARM Lezhë, Shkodër, Kukës gjatë periudhës 01.09.2020 deri 31.12.2022, nga 43 inspektime të kryera, në 38 (tridhjetetetë) prej tyre janë vendosur sanksione kryesore ligjore (gjoba) në vlerën e përgjithshme prej 9,330 mijë/lekë.

-Për **8** subjekte, në shumën **930 mijë/lekë**, nga ana e ARM Lezhë, nuk është ndërmarrë asnjë hap për të filluar procedurën e arkëtimit të gjobave, pavarësisht se janë brenda afatit Gjoba e vendosur, për subjektin R. 2015, prej **50 mijë/lekë, është parashkruar.**

Janë pothuajse të parashkruara gjobat e vendosura në muajin Qershor 2021, për Borshi dhe F. Sh., gjithsej 350 mijë/lekë, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative", *"Parashkrimi i dënimit administrative"* neni 46.

-Gjithashtu konstatohet se në asnjë rast nga ana e ARM Lezhë-Shkodër-Kukës nuk i është drejtuar Ministrit, me propozimin për pezullimin e lejes së subjektit, i cili nuk ka paguar gjobën, në kundërshtim me ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", neni 69, pika 8.

-Sektori i Inspektimit mjedisit në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës , nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun Lezhë, Shkodër, Kukës, mbështetur në këto të dhëna të bëhej identifikimi i subjekteve dhe veçimi i atyre me risk të lartë me ndikim në mjedis. Kjo në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhrat e Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015 *"Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë"* dhe nr.6 datë 19.02.2015*"Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut".*

**-** Në shumë raste inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet, se nuk gjendet në adresën e dhëne, ose nuk kryen aktivitet. Këto mangësi dhe pasaktësi të konstatuara në kryerjen e inspektimeve janë në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 "*Për Mbrojtjen e Mjedisit*" seksioni 2 neni 62-66 "*Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit*".

-Në muajin tetor janë planifikuar 56 inspektime, pasi janë hedhur në sistem janë anuluar 23 inspektime.

-Për 20 subjekte të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e monitorimin/vete monitorimit mjedisor si dhe dokumentacion ligjore, në 14 raste me vlere gjobe 300,000 lekë, në 2 raste në vlere 500,000 lekë, dhe në 4 raste 1,000,000 lekë, nuk është aplikuar masa administrative në vlerën totale prej **920,000 lekë** , veprim në kundërshtim me nenin 29 pika b (ii) të ligjit nr. 10488/2014 "*Për lejet e mjedisit"* si dhe Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011"Për menaxhimin e integruar te mbetjeve "neni 62.

-Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës për periudhën shtator 2020- dhjetor 2022 ka dhënë mendime për VNM paraprake/ të thelluar dhe për leje mjedisore të Tipit A, B, në 85 raste , duke i përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si palë e përfshirë në proces, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës nuk ka marrë informacione për vendimet e marra nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, veprime këto që janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe me nenin 11 të Ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011"*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*".

-Nga auditimi u konstatua se, për periudhën shtator 2020- dhjetor 2022 në 97 raste, në praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B në dosjet përkatëse mungojnë dokumente mbështetëse, që dëshmojnë realizimin e procedurave si: akt-verifikime apo akt inspektime në terren, dokumente këto paraprake, mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi.

**Përgjegjësitë e Drejtuesve të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës.**

Strukturat drejtuese të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, janë përgjegjëse: për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Si dhe për përdorimin e burimeve financiare .

-Inspektimet në fushën e Mjedisit dhe Ujërave,

-Dhëni mendimit për VNM paraprake dhe VNM të Thelluara si dhe mendim për Leje të Tipit A e B.
**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë:**
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatimin e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr.351/1 datë 12.04.2023, "*Auditim përputhshmërie dhe rregullshmërisë mbi veprimtarinë*" ARM Lezhë, Shkodër, Kukës*"* në subjektin Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës për periudhën nga 01.09.2020 deri në 31.12.2022, u krye auditimi "Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

**Grupi i Auditimi me përbërje:**

1.V. B., përgjegjës grupi
2.Sh.H., anëtare
3.A. V., anëtar
4.A. P., anëtar
***1.Objektivat dhe qëllimi i auditimit*: **Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të saj për procedurat e monitorimit të subjekteve në mjedis, vlerësimit të kryerjes së inspektimeve në fushën e mjedisit, dhënie mendimi subjekteve për pajisjen me leje mjedisore të Tipit A, B, aktivitetit ekonomiko-financiar dhe përmbushjes së funksioneve ligjore të mbrojtjes së mjedisit.
***2.Qëllimi i auditimit*: v**lerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare të Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, mbi çështjet që lidhen me ruajtjen, menaxhimin, monitorimin inspektimin në fushën e mjedisit.
***3. Identifikimi i çështjes***
**1-**Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit
**2**-Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe pagave
**3-** Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin , ruajtjen , dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetar edhe mbajtjen e kontabilitetit konkretisht ;

a. për pasqyrat financiare, bilancin dhe anekset,
b. për inventarizimin e pronës shtetërore dhe paraqitja e tyre në pasqyrat financiare
**4**- Auditim i procedurave për dhënie mendimi nga DRM, për lejet mjedisore të Tipit A, B si dhe vlerësimi i proceduarave me ndikim në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara.
**5**- Auditimi i inspektimeve, monitorimeve ,kontrolleve të kryera nga Sektori i Inspektimeve të mjedisit dhe Ujërave në ARM.
**6-** Auditimi i zbatimit të proceduarve për shkeljet e konstatuara dhe masat e marra deri në ekzekutimin e tyre.
**7-** Të tjera gjatë auditimi

**<u>4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar</u>**:

Drejtoria Rajonale e Mjediset Lezhë, Shkodër, Kukës, është përgjegjëse për veprimtarinë duke u Referuar: VKM-së nr.568,datë 17.07.2019 **"**Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së, ligjit dhe me ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"; VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "
-dhënie mendimi VNM paraprake dhe të thelluara, dhënie mendimi për leje mjedisore Tipi A, B.
-Inspektimi i praktikave në fushën e mjedisit dhe ujërave, si dhe dënimet administrative

***<u>5. Përgjegjësitë e audituesve:</u>***

Grupi i auditimit të KLSH$^{-së}$, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, grupi i auditimit ka zbatuar Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit, si dhe Standardet e Miratuara të Auditimit të cilat kanë në qendër të vëmendjes:
- Monitorimi dhe vete monitorimi i subjekteve që pajisen me leje.
-Dhënia mendimi për lejet mjedisore të tipit A, B.
Dhënia mendimi për VNM të thelluara dhe paraprake, konsultime me publikun.
- Inspektimi i praktikave në fushën e mjedisit në portal.
Ankesat e administruara nga të tretët.
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, mbi përmirësimin e punës ne veprimtarinë që kryen institucioni.

**<u>6. Kriteret e vlerësimit:</u>**

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës ,normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe data basë e subjekteve të pajisura me leje mjedisore ,VNM dhe dhënieve për mendim për lejet mjedisore. Në të gjitha fazat e auditimit sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën është patuar si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",-Ligjin Nr.10433 date16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" VKM nr.568, datë 17.07.2019 "Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së. Ky angazhim ka patuar si mision auditimin, përputhshmërisë dhe financiar, asetet, sistemin organizativ të funksionimit të mjedisit, ujërave dhe monitorimit, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës . Veprimtaria e

kësaj strukture bazohet në Ligjin Nr. 53/2020 " Për disa ndryshime të Ligjit Nr.10431, date 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit, "i ndryshuar, Ligji Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Ligjit Nr.52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit". Ligji nr. 10433, dt.16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" Ligj Nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në ligjin nr. 111/2012", Ligj Nr. 9115 dt. 24.07.2003 "Për trajtimin e ujërave të ndotura" të ndryshuar, Ligj Nr. 8905, datë 06.06.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar, Ligji Nr. 9103, datë 10.07.2003 "Për mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitare" i ndryshuar'.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:
-llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;
-procedurat e mekanizmave të auditimi, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;
-nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;
-anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimi, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;
-ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe:
-shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve.

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë, konfirmo me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

***7. Standardet e auditimit***

Rregullorja e Brendshme "Mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme "Për procedurat e auditimit të KLSH"; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016" Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t" (ISSAI), "Standardet e Kontrollit të KLSH", "Manualeve" si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

**8. Metodat e auditimit**

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

-*Metoda e ekzaminimit*: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe evidencën e veprimeve.

-*Metoda e ekzaminimit kryq*: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve**.**

-*Metoda e intervistimit*: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të

menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patuar përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxheria dhe operacionet gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

-*Metoda e testimit të detajuar*: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

**<u>9. Dokumentimi i auditimit</u>**

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230"Dokumentimi i Auditimit". Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

## <u>III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</u>

### I. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Rajonale e Mjedisit, Lezhë, Shkodër, Kukës kryen veprimtarinë e saj referuar VKM-së, nr.568,datë 17.07.2019,"Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së., Ligjit Nr.52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit etj. ka për objektiv: dhënien e mendimeve për leje të Tipit A, B mendime për VNM paraprake dhe të Thelluara, monitorimin e subjekteve të licencuara, inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave ndaj subjekteve të pajisura me leje mjedisore, ndjekjen në rrugë gjyqësore deri në arkëtimin e e tyre ndaj subjekteve që janë marrë masa administrative me dënime (gjobe) si dhe si veprimet financiare .

### 2 . Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

### 2.1.Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të ARM Lezhë, Shkodër, Kukës

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 351/1, datë 12.04.2023, "Mbi auditimin e hartimit dhe zbatimit të Buxhetit", baza ligjore:

1. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
2. Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar";
3. Ligjet vjetore të buxhetit;
4. Udhëzimet e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të dala nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë;.
5. VKM nr. 568, datë 17.7.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit

të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit".

u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;

-Situacioni i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit';

-PBA dhe buxheti vjetor;

-Raportet e monitorimit;

-Dokumente të bankës etj.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës është krijuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 23, datë 03.02.2020 dhe ka filluar funksionimin në korrik 2020, në kuadër të ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

***Viti 2021***

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës është njoftuar nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për përgatitjen dhe dorëzimin e PBA 2021-2023, me e-mail të datës 09.09.2020.

Me shkresën nr. 179 prot, datë 08.09.2020, ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, me e-mail të datës 08.09.2020, ka dërguar parashikimet e buxhetit për llogarinë 600, 601 dhe 602 të cilat paraqiten si më poshtë:

*Në lekë*

| Artikulli | Llogaria Ekonomike | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 |
|---|---|---|---|---|
| Pagat | 600 | 30,190,680 | 30,310,820 | 30,430,960 |
| Sig. shoqërore | 601 | 5,041,844 | 5,061,907 | 5,081,970 |
| Shp. Operative | 602 | 2,000,000 | 2,590,000 | 2,750,000 |

*Burimi: ARM Shkodër, Lezhë, Kukës*

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, në zbatim të ligjit nr. 137, datë 16.11.2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, si në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23724/65, datë 14.01.20218490/1 prot, datë 28.12.2020, me shkresën. 23724/65 Prot, datë 14.01.2021 si dhe na mbështetje të shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 8490/1, i dërgohet miratimi i buxhetit AKM-së, e cila me anë të shkresës përcjellëse nr. 321/1, i dërgon ARM Shkodër, Lezhë, Kukës miratimi i buxhetit për shpenzime korente për vitet 2021 – 2023.

Sipas miratimit të buxhetit për vitin 2021 - 2023 shpenzimet për llogaritë 600, 601 dhe 602 paraqiten si vijon:

Në lekë

| Artikulli | Llogaria Ekonomike | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 |
|---|---|---|---|---|
| Pagat | 600 | 28,500,000 | 28,500,000 | 28,500,000 |
| Sig. shoqërore | 601 | 4,700,000 | 4,700,000 | 4,700,000 |
| Shp. operative | 602 | 1,000,000 | 1,000,000 | 1,000,000 |

*Burimi: ARM Shkodër, Lezhë, Kukës*

Gjatë vitit 2021, buxheti për këtë njësi ka pësuar 2 herë ndryshime dhe konkretisht pakësimi në llogaritë 600 & 601 (paga dhe sigurime) ne muajin gusht 2021 dhe dhjetor 2021. Ne muajin gusht 2021 janë pakësuar fondet në dispozicion të llogarisë 600 nga 28,500,000 në vlerën 26,500,000 lekë dhe ne muajin Dhjetor 600 nga 26,500,000 në vlerën 22,500,000 lekë, 601 nga

4,700,000 në vlerën 4,200,000 lekë. Këto pikësime në llogaritë 600(Pagat) dhe 601(Sigurimet shoqërore), kana ardhur si pasojë e vendeve vakante që kanë ekzistuar në ARM Shkodër, Lezhë, Kukës gjatë vitit 2021. Për vitin 2021, planifikimi dhe realizimi i buxheti paraqitet si vijon:

*Në lekë*

| Artikulli | Planifikim | Çelje buxhet | Pakësimi | Plan përfundimtar | Fakt | Realizim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Pagat | 30,190,680 | 28,500,000 | 6,000,000 | 22,500,000 | 20,574,763 | 91% |
| Sig. shoqërore | 5,041,844 | 4,700,000 | 500,000 | 4,200,000 | 3,119,556 | 74% |
| Shp. operative | 2,000,000 | 1,000,000 | | 1,000,000 | 998,562 | 99.90% |
| Investime | - | - | - | - | - | |
| **Totali** | **37,232,524** | **34,200,000** | **6,500** | **27,700,000** | **24,692,881** | **89%** |

*Burimi: ARM Shkodër, Lezhë, Kukës*

Nga auditimi rezulton se nga nevojat për fonde për shpenzime operative, për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës në parashikimin e llogarisë 602 dërguar Ministrisë së Turizmit dhe AKM-së me anë të shkresës nr. 179 prot, datë 08.09.2020, në pasqyrën nr. 5 "Parashikimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime për secilin program të Njësisë së Qeverisjes Qendrore (Llogaria 602)", janë parashikuar 2,000,000 lekë.

Por nga Ministria e Financës janë miratuar për llogarinë 602 një total prej 1,000,000 lekë, pra gati 50% më pak se parashikimi i bërë nga ana e ARM Shkodër, Lezhë, Kukës.

Duke patur këtë fond të reduktuar për zërin shpenzime operative (llogaria 602), gjatë vitit 2021 nga ana e ARM Shkodër, Lezhë, Kukës ka patur kërkesa të vazhdueshme për shtesë fondesh zëra të ndryshëm në llogarinë 602.

Konkretisht me shkresë nr. 872 prot, datë 09.08.2021, me lëndë "Kërkesë për fonde financiare shtesë për karburant për vijimin e inspektimeve", drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në AKM është kërkuar shtesë fondi për karburant një total prej 2.800 litra, sasi e barasvlershme me 542.500 lekë.

Gjithashtu me shkresën nr. 1247 prot, datë 04.11.2021 me lëndë "Kërkesë për detyrime të prapambetura", drejtuar AKM është kërkuar shtesë fondi për detyrime të akumuluar për:

Energji elektrike për një total prej 50.130 lekë.

Posta për një total prej 23,705 lekë

***Pra një total prej 73.835 lekë detyrime të akumuluara. Pra faturat tatimore për këto shërbime nuk janë likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48.2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontrakturë e tregtare", neni 7.***

| **Titulli i gjetje** | Vonesa në pagesat e detyrimeve kontraktore dhe tregtare. |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi rezulton se nga nevojat për fonde për shpenzime operative, për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës në parashikimin e llogarisë 602 dërguar Ministrisë së Turizmit dhe AKM-së me anë të shkresës nr. 179 prot, datë 08.09.2020, në pasqyrën nr.5 bashkangjitur "Parashikimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime për secilin program të Njësisë së Qeverisjes Qendrore (Llogaria 602)", janë parashikuar 2,000,000 lekë.<br>Por nga Ministria e Financës janë miratuar për llogarinë 602 një total prej 1,000,000 lekë, pra gati 50% më pak se parashikimi i bërë nga ana e ARM Shkodër, Lezhë, Kukës.<br>Duke patur këtë fond të reduktuar për zërin shpenzime operative (llogaria 602), gjatë vitit 2021 nga ana e ARM Shkodër, Lezhë, Kukës ka patur kërkesa të vazhdueshme për shtesë fondesh zëra të ndryshëm në llogarinë 602. |

| | |
|---|---|
| | Konkretisht me shkresë nr. 872 prot, datë 09.08.2021, me lëndë "Kërkesë për fonde financiare shtesë për karburant për vijimin e inspektimeve", drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në AKM është kërkuar shtesë fondi për karburant një total prej 2.800 litra, sasi e barasvlershme me 542.500 lekë.<br>Gjithashtu me shkresën nr. 1247 prot, datë 04.11.2021 me lëndë "Kërkesë për detyrime të prapambetura", drejtuar AKM është kërkuar shtesë fondi për detyrime të akumuluar për:<br>Energji elektrike për një total prej 50.130 lekë.<br>Posta për një total prej 23,705 lekë.<br>Pra një total prej 73.835 lekë detyrime të akumuluara. Pra faturat tatimore për këto shërbime nuk janë likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48.2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7. |
| **Kriteri:** | - Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7. |
| **Ndikimi/Efekti** | Vonesa në pagesat e detyrimeve kontraktore dhe tregtarë sjell rrisk për krijimin e detyrimeve kontraktuale. |
| **Shkaku** | Parashikim jo i saktë i buxhetit afatmesëm (PBA) në të cilin nuk janë përfshirë edhe këto detyrime. |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Pagesat e detyrimeve kontraktore dhe tregtarë të kryhen brenda afateve ligjore të përcaktuara. |

**Për vitin 2021,** fondet për shpenzime operative janë përdorur kryesisht për zërat e shërbimeve (ujë, energji, telefon), karburant, mirëmbajtje automjeti dhe kancelari, realizuar në masën 99.9% të fondeve në dispozicion. Nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se veprimet mbahen në mënyrë kronologjike, në bazë të çdo urdhër-shpenzimi të nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, si dhe të konfirmuara nga nëpunësi i thesarit. Urdhër shpenzimet në të gjitha rastet kanë bashkëlidhur dokumente vërtetues dhe justifikues sipas natyrës së shpenzimit ( liste-prezenca, programe pune, fatura tatimore, urdhër prokurime, proces verbale), për blerjet e materialeve është bashkëlidhur fletë hyrja dhe proces verbali i marrjes në dorëzim nga komisioni, për çdo rast të shpenzimit. Vlerat e shënuara në urdhër shpenzim përputhen me vlerat e dokumenteve financiare si dokumente vërtetues dhe shlyerja e detyrimeve është bërë brenda afateve, duke shmangur aplikimin e kamatë vonesave.

Ndërkohë, sa i takon zërit paga (llogaria 600) rezulton se fondi është miratuar në vlerën 22,500,000 lekë dhe realizuar në vlerën 20,574,763 lekë, ose në masën 91%.

sa i takon zërit sigurime shoqërore (llogaria 601) rezulton se fondi është miratuar në vlerën 4,200,000 lekë dhe realizuar në vlerën 3,119,556lekë, ose në masën 74%.

sa i takon zërit shpenzime operative (llogaria 602) rezulton se fondi është miratuar në vlerën 1,000,000 lekë dhe realizuar në vlerën 998,562 lekë, ose në masën 99%.

Për vitin 2021, fondet për shpenzime operative janë përdorur kryesisht për zërat e shërbimeve (ujë, energji, telefon), karburant, mirëmbajtje automjeti dhe kancelari, realizuar në masën 81% të fondeve në dispozicion.

Në total, buxheti në dispozicion është miratuar në vlerën 27,700,000 lekë dhe realizuar në vlerën 24,692,881 lekë, ose në masën 89% të fondeve të miratuara dhe kjo për arsye të mos plotësimit të strukturës së miratuar për vitin 2021.

***Viti 2022***

Me shkresën nr. 1070 prot, datë 29.09.2021, ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, ka dërguar parashikimet e buxhetit për llogarinë 600, 601 dhe 602 të cilat paraqiten si më poshtë:

Në / lekë

| Artikulli | Llogaria Ekonomike | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 |
|---|---|---|---|---|
| Pagat | 600 | 30,160,968 | 30,430,960 | 31,615,530 |
| Sig.shoqërore | 601 | 5,041,844 | 5,061,907 | 5,081,970 |
| Shp. Operative | 602 | 2,600,000 | 2,710,000 | 2,960,000 |

*Burimi: ARM Shkodër, Lezhë, Kukës*

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, në zbatim të ligjit nr. 115/2021, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 8490/1 prot, datë 28.12.2020, me shkresën nr. 23724/65 Prot, datë 14.01.2021 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, i dërgohet miratimi i buxhetit AKM-së, e cila me anë të shkresës përcjellëse nr. 321/1, i dërgon ARM Shkodër, Lezhë, Kukës miratimi i buxhetit për shpenzime kornete për vitet 2022 – 2024. Sipas miratimit të buxhetit për vitin 2022 - 2024 shpenzimet për llogaritë 600, 601 dhe 602 paraqiten si vijon:

*Në/ Lekë*

| Artikulli | Llogaria Ekonomike | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 |
|---|---|---|---|---|
| Pagat | 600 | 28,500,000 | 28,500,000 | 28,500,000 |
| Sig. shoqërore | 601 | 4,700,000 | 4,700,000 | 4,700,000 |
| Shp. operative | 602 | 2,000,000 | 2,000,000 | 2,000,000 |

*Burimi: ARM Shkodër, Lezhë, Kukës*

Gjatë vitit 2022, buxheti për këtë njësi ka pësuar një herë ndryshim dhe konkretisht pakësimi në llogaritë 600 & 601 (paga dhe sigurime) ne muajin dhjetor 2022. Dhe konkretisht në muajin Dhjetor llogaria 600 nga 28,500,000 lekë është pakësuar në vlerën 21,500,000 lekë dhe llogaria 601 nga 4,700,000 lekë është pakësuar në vlerën 4,200,000 lekë. Këto pikësime në llogaritë 600 dhe 601 kana ardhur si pasojë e vendeve vakante që kanë ekzistuar në ARM Shkodër, Lezhë, Kukës gjatë vitit 2022. Për vitin 2022 buxheti paraqitet si vijon:

*Në/ lekë*

| Artikulli | Planifikim | Çelje buxhet | Pakësime | Plan përfundimtar | Fakt | Realizim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Pagat | 30,160,968 | 28,500,000 | 7,000,000 | 21,500,000 | 18,728,157 | 87% |
| Sig. shoqërore | 5,041,844 | 4,700,000 | 1,400,000 | 3,220,000 | 3,104,724 | 96% |
| Shp. operative | 2,600,000 | 2,000,000 | | 2,000,000 | 1,615,666 | 81% |
| Investime | - | - | - | - | - | |
| **Totali** | **37,232,524** | **35,200,000** | **8,400,000** | **26,720,000** | **23,448,547** | **88%** |

*Burimi: ARM Shkodër, Lezhë, Kukës*

Nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se veprimet mbahen në mënyrë kronologjike, në bazë të çdo urdhër-shpenzimi të nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, si dhe të konfirmuara nga nëpunësi i thesarit. Urdhër shpenzimet në të

gjitha rastet kanë bashkëlidhur dokumente vërtetues dhe justifikues sipas natyrës së shpenzimit ( liste-prezenca, programe pune, fatura tatimore, urdhër prokurime, proces verbale), për blerjet e materialeve është bashkëlidhur fletë hyrja dhe proces verbali i marrjes në dorëzim nga komisioni, për çdo rast të shpenzimit. Vlerat e shënuara në urdhër shpenzim përputhen me vlerat e dokumenteve financiare si dokumente vërtetues dhe shlyerja e detyrimeve është bërë brenda afateve, duke shmangur aplikimin e kamatë vonesave.
Ndërkohë, sa i takon zërit paga (llogaria 600) rezulton se fondi është miratuar në vlerën 21,500,000 lekë dhe realizuar në vlerën 18,728,157 lekë, ose në masën 87% sa i takon zërit sigurime shoqërore rezulton se fondi është miratuar në vlerën 21,500,000 lekë dhe realizuar në vlerën 18,728,157 lekë, ose në masën 87%, sa i takon zërit shpenzime operative (llogaria 602) rezulton se fondi është miratuar në vlerën 2,000,000 lekë dhe realizuar në vlerën 1,615,666 lekë, ose në masën 81%.
Për vitin 2022, fondet për shpenzime operative janë përdorur kryesisht për zërat e shërbimeve (ujë, energji, telefon), karburant, mirëmbajtje automjeti dhe kancelari, realizuar në masën 81% të fondeve në dispozicion. Mos përdorimi i fondeve të vëna në dispozicion për llogarinë 602 (Shpenzime Operative) ka ardhur si pasojë e ndërprerjes së inspektimeve në terren gjatë vitit 2022.
Në total, buxheti në dispozicion është miratuar në vlerën 26,720,000 lekë dhe realizuar në vlerën 23,448,547 lekë, ose në masën 88% të fondeve të miratuara dhe kjo për arsye të mos plotësimit të strukturës së miratuar si dhe për arsye të ndërprerjes së inspektimeve në terren gjatë vitit 2022.
Për fondet e përdorura, sektori i financës ka përpiluar situacionet mujore të shpenzimeve të cilat, pasi janë rakorduar edhe me degën e thesarit brenda afateve të përcaktuara, janë raportuar rregullisht pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Nga auditimi rezulton se shpenzimet janë kryer brenda tavaneve buxhetore mujore të përcaktuar. Edhe për këtë vit, rezulton se, siç parashikuar në nenin 65 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", "*Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancës financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm"*, në pikën 5 të nenit 4 të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar *("Njësi të qeverisjes qendrore" janë njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore. Njësia e qeverisjes qendrore përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e vartësisë të kontrolluara prej saj*) dhe pikën 23/1 të po këtij Ligji, si dhe paragrafi 47 i Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", *"Në njësitë shpenzuese të ndërtuara me më shumë se dy nivele vartësie, punonjësit e financës, në strukturat përgjegjëse për financat, të vendosur në nivelet e poshtme të vartësisë konsiderohen punonjës të deleguar të nëpunësit zbatues, të njësisë nga varen, të cilët raportojnë në mënyrë të dyfishtë tek nëpunësi zbatues i njësisë nga varen dhe nëpunësi autorizues përkatës".*
***Nga auditimi gjithashtu u konstatua se për periudhën objekt auditimi, rezulton se Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës nuk ka hartuar dhe dorëzuar raportimet 4 mujore të monitorimit të buxhetit, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në kundërshtim me nenin 65 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", kapitulli VI "Raportet e Monitorimit" pika 270 që thotë"***

***Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore, duhet të paraqesin raportet e monitorimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues, deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj, 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm, sipas të dhënave përfundimtare, pas rakordimeve me Ministrinë përgjegjëse për Financat".***

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetje** | Mos hartimi dhe mos dorëzimi i raporteve 4 mujore të monitorimit të buxhetit, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. |
| **Situata:** | Nga auditimi gjithashtu u konstatua se për periudhën objekt auditimi, rezulton se Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës nuk nuk ka hartuar dhe dorëzuar raportimet 4 mujore të monitorimit të buxhetit, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në kundërshtim me nenin 65 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", kapitulli VI ". |
| **Kriteri:** | - Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".<br>- Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". |
| **Ndikimi/Efekti** | Mos hartimi dhe mos dorëzimi i raporteve 4 mujore të monitorimit të buxhetit sjell një panoramë jo të qartë të buxhetit dhe si rrjedhojë mund të sjellë një parashikim jo të saktë të PBA për institucionin. |
| **Shkaku** | Mos raportim dhe mos dorëzim i raporteve të monitorimit veprime në kundërshtim me Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Të hartohen raportet e monitorimit si dhe të kryhet dorëzimi i tyre brënda afateve ligjore të përcaktuara. |

**Për sa u trajtua në këtë raport përfundimtarë mbajnë përgjegjësi:**
Z. B. F., Drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës;
Znj. D. Sh., (Specialiste e Sektorit të financës – deri në maj 2022 – më pas Përgjegjëse e Sektorit të Financës)

**2.2.Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me i Zbatimi "Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe pagave".**

Nga auditimi në lidhje mbi respektimin e strukturave në Agjencinë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës. për periudhën 01.09.2020 deri më 31.12.2022, u konstatua se me VKM nr. 568, datë 17.7.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", AgjenciaKombëtare e Mjedisit, (në vijim AKM) e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në 2 nivele:
1- Nivel qendror, përmes Drejtorisë së Përgjithshme;
2- Nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) Agjencive Rajonale të Mjedisit (në vijim ARM).
Sipas Urdhër nr. 23, datë 03.02.2020 i Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës numëri i punonjësve për ARM Lezhë sipas strukturës plan është 42 punonjës.

Grupi auditimit ka konstatuar se struktura fakt:
- Në fillim të muajit nëntor 2020 ka qenë 36 punonjës;
- Në fillim të muajit janar 2021 struktura fakt ka qenë 34 punonjës,
- Në fillim të muajit janar 2022 struktura fakt ka qenë 29 punonjës
- Në fund të muajit dhjetor 2022 struktura fakt ka qenë 29 punonjës.

**Pra sa më sipër,** ndonëse kemi një strukturë plan të miratuar me 42 punonjës, konstatohet se kemi vende të paplotësuara për gati 30% të pozicioneve të vendeve të punës, faktor i cili është një tregues jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të ARM Lezhë e për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të këtij institucionit në realizimin e objektivave.

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetje** | Vendet bosh të krijuara në Agjencinë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës. |
| **Situata:** | Nga auditimi në lidhje mbi respektimin e strukturave në Agjencinë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës, u konstatua se, Sipas Urdhër nr. 23, datë 03.02.2020 i Kryeministrit për miratimin e struktures dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës numëri i punonjësve për ARM Lezhë sipas strukturës plan është 42 punonjës.<br>Grupi auditimit ka konstatuar se struktura fakt aktualisht është 29 punonjës.<br>- Pra sa më sipër, ndonëse kemi një strukturë plan të miratuar me 42 punonjës, konstatohet se kemi vënde të paplotësuara me punonjës për gati 30% të pozicioneve të vendeve të punës, faktor i cili është një tregues jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të ARM Lezhë e për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të këtij institucionit në realizimin e objektivave. |
| **Kriteri:** | - Urdhër nr. 23, datë 03.02.2020 i Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës. |
| **Ndikimi/Efekti** | Vendet e paplotësuara me punonjës është një fenomen jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë në Agjencinë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës, e për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të institucionit në realizimin e objektivave. |
| **Shkaku** | Mos plotësimi i Vakancave në Agjencinë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës dhe mungesa e korrespondencës me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për plotësimin e tyre. |
| **Rëndësia** | E mesme. |
| **Rekomandim** | Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të plotësojë me punonjës pozicionet bosh sipas organikës. |

**Planifikimi Rekrutimeve në ARM**

Në zbatim të nenit 18, Kreu II, të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", përgatitet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.

Nga auditimi u konstatua se ARM Lezhë ka dërguar shkresën me:
- Nr. 372 prot, datë 21.05.2021, drejtuar z. E.K., Drejtor i Përgjithshëm i AKM, për plotësimin e vendeve vakante për 9 punonjës.
- Nr. 1306 prot, datë 18.11.2021, drejtuar z. E. K., Drejtor i Përgjithshëm i AKM, për plotësimin e vendeve vakante për 13 punonjës.

Për shkresat e sipërcituara nuk është marrë një përgjigje për procedurat që ka ndjekur AKM me DAP për rekrutimet e punonjësve në ARM Lezhë.

Duhet theksuar se nga ana e ARM Lezhë nuk ka patur një korrespondence më të shpeshtë me AKM për procesin e rekrutimeve për vendet e paplotësuara me punonjës.

Gjithashtu grupi i auditimit ka konstatuar që sipas rregullores së brendshme të ARM Lezhë, pika nr. 8 e kësaj rregullore thotë që "Detyrat funksionale të Specialist / Burime Njerëzorë, Protokoll - Arkivë – Magazinë, administron dosjet e personeli, regjistra, libreza pune, duke i azhornuar ato ne sistemin HRMIS". ***Pas verifikimeve të kryera u konstatua që për periudhën objekt auditimi azhornimi i këtij informacioni në sistemin HRMIS nuk është bërë nga personat përgjegjës. Për sa është trajtuar në këtë Akt-Konstatim nr.2, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me të tyren nr. 504 prot., datë 16.06.2023 dhe me tonën nr. 351/2 prot datë 16.06.2023.***

***<u>Pretendimi i subjektit:</u>***

*Ju bëjmë me dije se:*

*Që nga momenti që është krijuar ARM Lezhë me VKM nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", institucionit tonë nuk i janë dhënë kredencialet për tu loguar në sistem pasi menaxhimin dhe funksionimin e këtij sistemi e ka vetëm AKM.*

***<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>***

*Përsa i përket observacionit në lidhje me mos azhornimit të informacionit në sistemin HRMIS për dosjet e personelit, regjistrat e punonjësve, librezat e punës etj, nga personat përgjegjës grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë pasi në rregulloren e brendshme të ARM Lezhë, pika nr. 8 e kësaj rregullore thotë që "Detyrat funksionale të Specialist / Burime Njerëzorë, Protokoll - Arkivë – Magazinë, administron dosjet e personeli, regjistra, libreza pune, duke i azhornuar ato ne sistemin HRMIS".*

*Gjithashtu në observacionin e subjektit nuk ka asnjë dokument që të justifikojë observacionin.*

| **Titulli i gjetje** | Mos azhornimi i informacionit në sistemin HRMIS për dosjet e personelit, regjistrat e punonjësve, librezat e punës etj., nga personat përgjegjës. |
|---|---|
| **Situata:** | Në zbatim të nenit 18, Kreu II, të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", përgatitet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.<br>Nga auditimi u konstatua se ARM Lezhë ka dërguar shkresën me:<br>- Nr. 372 prot, datë 21.05.2021, drejtuar z. E. K., Drejtor i Përgjithshëm i AKM, për plotësimin e vendeve bosh për 9 punonjës.<br>- Nr. 1306 prot, datë 18.11.2021, drejtuar z. E. K., Drejtor i Përgjithshëm i AKM, për plotësimin e vendeve bosh për 13 punonjës.<br>Për shkresat e sipërcituara nuk është marrë një përgjigje për procedurat që ka ndjekur AKM me DAP për rekrutimet e punonjësve në ARM Lezhë. |

| | |
|---|---|
| | Duhet theksuar se nga ana e ARM Lezhë nuk ka patur një korrespondence më të shpeshtë me AKM për procesin e rekrutimeve për vendet e paplotësuara me punonjës.<br>Gjithashtu grupi i auditimit ka konstatuar që sipas rregullores së brendshme të ARM Lezhë, pika nr. 8 e kësaj rregullore thotë që "Detyrat funksionale të Specialist / Burime Njerëzore, Protokoll - Arkivë – Magazinë, administron dosjet e personeli, regjistra, libreza pune, duke i azhornuar ato ne sistemin HRMIS". ***Pas verifikimeve të kryera u konstatua që për periudhën objekt auditimi azhornimi i këtij informacioni në sistemin HRMIS nuk është bërë nga personat përgjegjës.*** |
| **Kriteri:** | - Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"<br>- VKM nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", përgatitet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.<br>- Rregullore e brendshme e Agjencinë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës. |
| **Ndikimi/Efekti** | Mos azhornimi i informacionit në ne sistemin HRMIS i dosjeve të personelit krijon një informacion jo të qartë të personelit aktual si dhe të vëndeve të paplotësuara me punonjës që janë krijuar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës. |
| **Shkaku** | Mos azhornimi i i informacionit në ne sistemin HRMIS i dosjeve të personelit, regjistrit të personelit, librezave të punës etj nga personat përgjegjës. |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Të kryhet azhornimi i vazhdueshëm i informacionit të dosjeve të personelit, regjistrit të personelit, librezave të punës etj, në sistemin HRMIS nga personat përgjegjës. |

**Dosjet e Personelit**

-Gjatë auditimit u konstatua se, për nëpunësit e ARM Lezhë zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil parashikuar për institucionet e administratës shtetërore. Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit rezultoi se, ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Për periudhën objekt auditimi është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë të bashkëlidhura në çdo dosje të nëpunësit. Kjo në përputhshmëri me VKM nr. 117, datë 5.3.2014, pika nr. 3 *"Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë"*.

U audituan gjithsej 13 dosje personale të punonjësve të ARM Lezhë.

Nga auditimi i këtyre dosjeve u verifikua nëse në zbatim të VKM nr. 117, datë 05.03.2014, "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit"* në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë : LIDHJA NR 1. *"Fletë inventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe* LIDHJA NR 2. *"Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit 1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri;*

*3. Numri kombëtar i identifikimit;4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimimi; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaj; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;"17. Trajnimet e ndryshme pranë DAP, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).*

***Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se në 6 nga këto 13 dosje mungonte Fletë inventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje, kjo në kundërshtim me VKM nr. 117, datë 05.03.2014, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit" në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë: LIDHJA NR 1. "Fletë inventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje.***

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetje** | Mungesë dokumentacioni në dosjet e personelit në Agjencinë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës. |
| **Situata:** | -Gjatë auditimit u konstatua se, për nëpunësit e ARM Lezhë zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil parashikuar për institucionet e administratës shtetërore. Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit rezultoi se, ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".<br>Për periudhën objekt auditimi është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë të bashkëlidhura në çdo dosje të nëpunësit. Kjo në përputshmëri me VKM nr. 117, datë 5.3.2014, pika nr 3. *"Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë".*<br>U audituan gjithsej 13 dosje personale të punonjësve të ARM Lezhë.<br>Nga auditimi i këtyre dosjeve u verifikua nëse në zbatim të VKM nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit"* në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë : LIDHJA NR 1. *"Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe* LIDHJA NR 2. *"Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit 1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri; 3. Numri kombëtar i identifikimit;4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimimi; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaj; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;"17. Trajnimet e ndryshme pranë DAP, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).*<br>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se në 6 nga këto 13 dosje mungonte Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje, kjo në kundërshtim me VKM nr. 117, datë 05.03.2014, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit" në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë: LIDHJA NR 1. "Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit".* |

| | |
|---|---|
| **Ndikimi/Efekti** | Mos arkivim i saktë i dokumentacionit të dosjeve të personelit. |
| **Shkaku** | Mos plotësimi i dokumentacionit sipas VKM nr. 117, datë 05.03.2014, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit". |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Të kryhet plotësimi i të gjithë dokumentacionit të dosjeve të personelit sipas kërkesave ligjore. |

**2.3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen , dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare edhe mbajtjen e kontabilitetit konkretisht/ pasqyrave financiare dhe plotësimi I formularëve te bilancit dhe anekseve përkatëse sipas udhëzimeve , të nxjerra nga Ministria e Financave.**

*- Pasqyrat financiare dhe plotësimi i formularëve të bilancit dhe i anekseve përkatës sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim.*

***Mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM) Lezhë, në bazë të Programit të Auditimit nr. 351/1, datë 12/04/2023, mbajtur në datë 09/06/2023.***

*Pasqyrat financiare dhe plotësimi i formularëve të bilancit dhe i anekseve përkatës sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim.*

Objekti i këtij akt verifikimi është: "Rregullshmëria e pasqyrave financiare dhe niveli i performancs së mbajtjes së kontabilitetit".

Për auditimin e kësaj pike sipas drejtimeve të përcaktuara në programin ***nr. 351/1, datë 12/04/2023, pika 3,*** u mbështetëm në kriteret ligjore si më poshtë:

***Ligji nr. 25/2019, datë 10.05.2019****"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*
*-Ligji nr. 40/2020 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Standardet Rajonale të Kontabilitetit (SKK 2 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare"), të përcaktuara në Ligjin nr. 25/, datë 03.2019 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".*
***Ligji nr. 10296, datë 8.7 2010*** *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".*
***Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011*** *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*
***Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008,*** *"Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë".*
***-UMF nr. 8, datë 09.03.2019****"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".*

***1.Mbi auditimin e rregullshmërisë së pasqyrave financiare.***

***Lidhur me këtë çështje të programit, u ushtrua auditim mbi ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe vlerësimin e aktivitetit financiar, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, nxjerrjen e llogarisë vjetore, kuadri ligjor i përdorur mbi sistemin dhe procesin kontabël, kompjuterizimin, raportimin e pasqyrave financiare****, në zbatim* ***të pikës 3*** *të programit të auditimit të miratuar nga kryetari i KLSH,* ***nr. 351/1, datë 12/04/2023,*** *për periudhën* ***01.09.2020 deri me datë 31.12.2022, mbajtur me datë 09.06.2023.***

Në bazë të programit të auditimit ***nr. 351/1, datë 12/04/2023, pika 3 "Auditim mbi rregullshmërisë së pasqyrave financiare", për periudhën 01.09.2020 deri me datë 31.12.2022"***, u shqyrtua dhe u verifikua dokumentacioni i vënë në dispozicion, i Pasqyrave Financiare, ditarët e magazinës, të arkës e të bankës, ditarët e shpenzimeve kornetë progresive vjetore, zbatimi i buxhetit për vitet në auditim ***2020, 2021deri me datë 30.11.2022*** të plotësuara nga ***Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë,*** në zbatim të ligjit për Kontabilitetin e Pasqyrat Financiare ***nr. 25/2019, datë 10.05.2019****"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*

Udhëzimit nr.37, datë 19.12.2006, Udhëzimit nr.26, datë 27.12.2007, dhe Udhëzimit nr.10, datë 27.02.2008, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, vendore dhe njësitë që varen prej tyre dhe Ligjit nr. 10296, datë 8.7 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe udhëzimit MF nr. 30, datë 27.12.2011" Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"**.**

Sa më sipër, u konstatua si problematikë e përgjithshme se:

***<u>Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022.</u>***

***Mbas shqyrtimit të dokumentacionit të sipër cituar konstatohet se:***

***Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë,*** e ka kryer veprimtarinë e saj për periudhën 01.01.2022 deri me datë 31.12.2022 dhe Pasqyrat Financiare rezultojnë të përgatitura nga Specialiste e Financës *znj. D. Sh. dhe është miratuar nga Drejtori z. B. F.***,** të nisura me shkresë nr. 240, datë 29.03.2023, Degës së Thesarit Lezhë dhe e vulosur prej saj.

*Pasqyrat financiare janë të konfirmuara nga Dega e Thesarit Lezhë, në parim dhe në çdo faqe.*

***<u>Pika 1/a- Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit sipas planit unik kontabël për institucionet publike.</u>***

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin ***2022,*** japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (i shfuqizuar),ligjin nr. 25/2019, datë 10.05.2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2019 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", u analizuan pasqyrat financiare të vitet ***2022*** dhe pasqyra e shpenzimeve deri me datë ***31.12.2022,*** nga ku rezultoi:

Mbasi u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion bazuar në Kriteret e vlerësimi në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"**,** Ligjin nr. 25/2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, UMF nr. 8, datë 09.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", UMF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", rezultoi:

*<u>ARM Lezhë, ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2022, sipas ligjit nr. 25/2019, datë 10.05.2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".</u>*

Pjesë përbërëse të PF/2022 janë: Pasqyra e pozicionit financiar (F1); Pasqyra e performancës financiare (F2); Pasqyra e flukseve monetare (F3); Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4); Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5); Pasqyrat statistikore: Investimet dhe burimi i financimit (F6); Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a); Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b); Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8).

*<u>ARM Lezhë, ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2022.</u>*

Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të UMF nr. 8, datë 09.03.2019, ku është dhënë informacion mbi Emrin e njësisë ekonomike raportuese, ARM Lezhë me ***NIPT M.........A.***

Pasqyrat financiare mbulojnë:

-Një njësi ekonomike raportuese individuale;

-Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2022-31.12.2022.

-Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë.
Hartimi dhe dorëzimi i Pasqyrave Financiare në Degën e Thesarit është bërë me datë 29 Mars 2023 brenda afatit ligjor.

***Nga auditimi i Pasqyrave financiare rezultoi:***

Pasqyrat financiare vjetore 2022 janë dorëzuar në Degën e Thesarit me datë 29 Mars 2023, me të dhënat e mëposhtëme:

***AKTIVI*** ***Në lekë***

| *Llogaritë* | *Gjendje në fund të vitit 2022* | *Gjendja në fund të vitit 2021* |
|---|---|---|
| ***A. Aktivet*** | ***10,289,803*** | ***10,709,440*** |
| ***I. Aktivet Afat shkurtra*** | ***1,975,910*** | ***1,733,866*** |
| ***1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre*** | ***0*** | ***0*** |
| ***2. Gjendje Inventari Qarkullues*** | ***0*** | ***0*** |
| *Materiale* | ***0*** | ***0*** |
| *Inventar i Imët* | ***0*** | ***0*** |
| ***3. Llogari të Arkëtueshme*** | ***1,975,910*** | ***1,733,866*** |
| *Operacione me shtetin(Të drejta)* | *1,975,910* | *1,733,866* |
| ***II. Aktivet Afat gjata*** | ***8,313,893*** | ***8,975,574*** |
| ***1.Aktive Afatgjata jo materiale*** | ***0*** | ***0*** |
| ***2. Aktive Afatgjata materiale*** | ***8,313,893*** | ***8,975,574*** |
| *Pyje, Plantacione* | | *-* |
| *Ndërtesa e Konstruksione* | *3,565,627* | *3,753,292* |
| *Instalime teknike, makineri e paisje* | *0* | *0* |
| *Mjete Transporti* | *3,815,929* | *4,016,766* |
| *Inventar Ekonomik* | *932,337* | *1,205,516* |

**PASIVI** ***Në lekë***

| *Llogaritë* | *Gjendje në fund të vitit 2022* | *Gjendja në fund të vitit 2021* |
|---|---|---|
| ***B. PASIVET (DETYRIMET)*** | ***1,975,910*** | ***1,733,866*** |
| ***I.Pasivet Afat shkurtra*** | ***1,975,910*** | ***1,733,866*** |
| ***1.Llogari të Pagueshme*** | ***1,975,910*** | ***1,733,866*** |
| *Furnitorë e llogari të lidhura me to(401)* | *0* | *0* |
| *Detyrime ndaj personelit* | *1,389,891* | *1,179,259* |
| *Hua Afat shkurtra* | *-* | *-* |
| *Detyrime ndaj shtetit(Tatim taksa)* | *104,446* | *85,213* |
| *Sigurime Shoqërore* | *411,857* | *343,939* |
| *Sigurime Shëndetësore* | *57,216* | *47,787* |
| *Organizma të tjerë Shtetërorë* | | *-* |
| *Kreditorë për mjete në ruajtje* | | *-* |
| *Kreditorë të ndryshëm* | *12,500* | *77,668* |
| ***C. AKTIVET NETO/FONDET (A-B)*** | ***8,313,893*** | ***8,975,574*** |
| ***D. FONDI I KONSOLIDUAR*** | ***8,313,893*** | ***8,975,574*** |
| *Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar* | *8,313,893* | *8,975,574* |
| *Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore* | *-* | *-* |
| *Teprica e Granteve kapitale të Brendshme* | *-* | *-* |
| *Teprica e Granteve kapitale të Huaja* | | *-* |
| ***E. TOTALI I PASIVEVE(B+C)*** | ***10,289,803*** | ***10,709,440*** |
| | | |
| ***KONTROLLE Shifra 0(zero)- Tregon Kuadraturën*** | ***Kuadratura*** | ***Kuadratura*** |
| *K1.Aktivet Neto a janë të barabarta me Fondin e Konsoliduar* | ***0*** | ***0*** |
| *K2.Totali i Aktiveve a është i barabartë me=Totalin e Pasiveve* | ***0*** | ***0*** |

***Më poshtë evidentohen testet thelbësore*** në lidhje me llogaritë të cilat janë vlerësuar si materiale, bazuar në materialitetin e përcaktuar dhe që përbëjnë një evidencë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të auditimit mbi pasqyrat financiare të mbyllura për periudhën 01.09.2022-31.12.2022.

Nga të dhënat e evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2022 sipas aktivit, ***Grupi II-Aktivet Afat gjata*** evidentohen me një vlerë prej ***8,313,893 lekë nga 8,975,574 lekë për vitin 2021***. Totali aktivit evidentohet në vlerën ***për 10,289,803 lekë*** dhe është i barabartë me totalin e Pasivit.

Më hollësisht plotësimi i pasqyrave financiare analizohet si mëposhtëm:

***Llogaritë e Klasës 3,*** sikurse evidentohen në pasqyrat financiare me datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën ***1,975,910 lekë*** që përbëhet nga llogaria kontabël *Operacione me shtetin(Të drejta)* në vlerën *1,975,910lekë.*

***Llogaritë e Klasës 3 "Llogari të Arkëtueshme"***

| *Llogaritë kontabël* | *Emërtimi i llogarive* | *Viti 2022* | *Viti 2021* | *Diferenca 2022-2021* |
|---|---|---|---|---|
| ***3*** | ***Llogari të arkëtueshme*** | ***1,975,910*** | ***1,733,866*** | ***242,044*** |
| 4342 | Operacione me shtetin(të drejta) | *1,975,910* | *1,733,866* | *242,044* |

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (Debitor) në vlerën ***1,975,910*** **lekë** pasqyron detyrimin e shtetit ndaj Institucioneve publike për shpenzimet e konstatuara të vitit 2022 por që do të përballohen nga buxheti i vitit 2023, si dhe detyrime ndaj punonjesve për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, e rakorduar kjo me llogaritë në pasiv 421,431,435,436 në Postin B- të Bilancit.

***Llogaritë e klasës së 4,*** kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës së 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës së 5.

***Grupi A- AKTIVE Afatgjata***

***II-Aktivet Afatgjata*** evidentohen në vlerën ***28,964,695 lekë***.

Llogaritë e Klasës 21 "***Aktivet Afatgjata materiale*** " përfaqësojnë vlerën ***28,964,695 lekë*** sipas te dhënave pasqyruar për vitin ushtrimor 2022.

| *Llogaritë kontabël* | *Emertimi i llogarive* | *Viti 2022* | *Viti 2021* | *Diferenca 2022-2021* |
|---|---|---|---|---|
| ***21*** | ***2-Aktive Afatgjata materiale*** | ***8,313,893*** | ***8,975,574*** | ***-661,681*** |
| 210 | *Toka, Troje, Terrene* | *0* | *0* | |
| 211 | *Pyje, Plantacione* | *0* | *0* | |
| 212 | *Ndërtesa e Konstruksione* | *3,565,627* | *3,753,292* | *-187,665* |
| 213 | *Rruge, rrjete, vepra ujore* | *0* | *0* | *0* |
| 214 | *Instalime teknike, makineri e paisje* | *0* | *0* | *0* |
| 215 | *Mjete Transporti* | *3,815,929* | *4,016,766* | *-200,837* |
| 218 | *Inventar Ekonomik* | *932,337* | *1,205,516* | *-273,179* |

*Formulari i përdorur nuk përmban llogarinë 219 "Amortizimi i AAM"*

***Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"*** evidentohet në një vlerë prej ***3,565,627 lekë***, me një pakësim nga viti 2021 prej ***187,665 lekë,*** që paraqet vlerën e ndërtesave në pronësi të ARM më datë 31.12.2022, cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në mbyllje të vitit ushtrimor. Vlera prej 187,665 lekë paraqet amortizimin vjetor të vitit 2022.

***Llogaria 215 "Mjete transporti"*** evidentohet në një vlerë prej ***3,815,929 lekë***, me një pakësim nga viti 2021 prej ***200,837 lekë,*** që paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të ARM më datë 31.12.2021, cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në mbyllje të vitit ushtrimor. Vlera prej 200,837 lekë paraqet amortizimin vjetor të vitit 2022.

*Llogaria kontabël 218 "Inventar ekonomik"* është evidentuar në bilanc në një vlerë prej ***932,337 lekë***, me një pakësim nga viti 2021 prej ***273,179 lekë,*** që paraqet vlerën e inventarit ekonomik në pronësi të ARM më datë 31.12.2022, cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në mbyllje të vitit ushtrimor. Vlera prej 273,179 lekë paraqet amortizimin vjetor të vitit 2022.

***Pasqyra nr. 7/a***

***Pasqyra e Aseteve llog. 212, 215,218 (Bruto)***

| ***Nr. Llog.*** | ***Emërtimi*** | ***Gjendja me datë*** | ***Shtesë transf. kap.*** | ***pikësime të tjera*** | ***Gjendja në fund me datë*** |
|---|---|---|---|---|---|

| | | 01.01.2022 | viti 2022 | viti 2022 | 31.12. 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| ***212*** | ***Ndërtesa e Konstruksione*** | *4,862,807* | - | - | *4,862,807* |
| ***215*** | ***Mjete transporti*** | *6,702,929* | - | - | *6,702,929* |
| ***218*** | ***Inventar Ekonomik*** | *6,515,562* | - | - | *6,515,562* |
| | ***T O T A L I*** | ***18,081,298*** | **-** | **-** | ***18,081,298*** |

***B.PASIVET (DETYRIMET) e Pasqyrave Financiare vjetore*** evidentohet në ***vlerën 10,289,803 lekë*** e kundruara me aktivin e Pasqyrave Financiare vjetore në të njejtën vlerë dhe përfaqëson:

***I. Pasivet Afat shkurtra për vitin 2022,*** të cilat evidentohen në vlerën ***1,975,910 lekë*** dhe përfaqësohen nga llogaritë e ***klasës 4 " Llogari të Pagueshme"*** në të njëjtën vlerë.

***Llogaritë e klasës 4,*** në pasiv të Pasqyrës, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e ARM më 31.12.2022, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, huatë afat shkurtra, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, si më poshtë:

| Llogaritë | | Viti 2022 | Viti 2021 | Dif /ndryshimi |
|---|---|---|---|---|
| | **I.Pasivet Afat shkurtra** | ***1,975,910*** | ***1,733,866*** | ***242,044*** |
| | **1.Llogari të Pagueshme** | ***1,975,910*** | ***1,733,866*** | ***242,044*** |
| 401-408 | Furnitorë e llogari të lidhura me to | - | - | - |
| 42 | Detyrime ndaj personelit | *1,389,891* | *1,179,259* | *210,632* |
| 16,17,18 | Hua Afat shkurtra | - | - | - |
| 431 | Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa | *104,446* | *85,213* | *19,233* |
| 432 | Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal | - | - | - |
| 433 | Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore | - | - | - |
| 435 | Sigurime Shoqërore | *411,857* | *343,939* | *67,918* |
| 436 | Sigurime Shëndetësore | *57,216* | *47,787* | *9,429* |
| 467 | Kreditore te ndryshëm | *12,500* | *77,668* | *-65,168* |

***Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit"*** evidentohet në një ***vlerë 1,389,891 lekë*** që përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

***Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa"*** evidentohet në një ***vlerë prej 104,446 lekë*** që përfaqëson detyrime për tu paguar nga subjektit ndaj shtetit tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

***Llogaria 435, "Sigurime shoqërore"*** evidentohet në ***vlerën 411,857*** **lekë** dhe paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të cilat paguhen në vitin e ardhshëm në Janar.

***Llogaria 436, "Sigurime shëndetësore"*** evidentohet në ***vlerën 57,216 lekë*** dhe paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të cilat paguhen në vitin e ardhshëm në Janar.

***C. AKTIVET NETO/FONDET (A-B)*** në fund të ***vitit 2022*** evidentohet në ***vlerën 8,313,893 lekë,*** *me një* ***vlerë të barabartë me klasën D "FONDI I KONSOLIDUAR".***

***D. "FONDI I KONSOLIDUAR",*** *në fund të* ***vitit 2022*** evidentohet në ***vlerën 8,313,893 lekë*** *dhe paraqitet si më poshtë:*

| Llog. | | Viti 2022 | Viti 2021 | Diferenca/ndryshimi |
|---|---|---|---|---|
| **D** | **Fondi i Konsoliduar** | ***8,313,893*** | ***8,975,574*** | ***-661,681*** |
| 101 | Teprica(Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar | *8,313,893* | *8,975,574* | *-661,681* |

| | Viti 2022 | Viti 2021 | Diferenca/ndryshimi |
|---|---|---|---|
| ***E. TOTALI I PASIVEVE (B+C)*** | ***10,289,803*** | ***10,709,440*** | ***-419,637*** |

***Pasqyra e Performancës financiare (F2)***

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të ARM më datë 31.12.2022 janë të rakorduara me Degën e Thesarit, konkretisht:

| Llog. | | Viti 2022 | Viti 2021 | Diferenca/ndryshimi |
|---|---|---|---|---|
| 72 | *V- Grante Korente* | | | |
| 720 | ***1.Grant korent I Brendshëm*** | ***24,160,591*** | ***24,399,536*** | ***-238,945*** |
| 7200 | Nga Buxheti për NJQP(Qëndrore) | ***22,184,681*** | ***22,665,670*** | *-480,989* |
| *7206* | *Financim i pritshëm nga buxheti* | *1,975,910* | *1,733,866* | *242,044* |

***Pasqyra Flukseve Monetare (CASH FLOË), Formati nr. 3***

Në Pasqyrën e Flukseve Monetare, evidenton likuiditetet dhe gjendjen më datë 31.12.2022.
Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi akordimin e fondeve buxhetore për shpenzime korente, për detyrime e shpenzime korente, për shpenzimet kapitale (investimet), transfertat, rritja/rënia neto e mjeteve monetare, si dhe tepricat e likuiditeteve në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor, përmbledhtazi si më poshtë:

| Nr. | PËRMBAJTJA | Periudha Raportuese | Periudha Paraardhëse |
|---|---|---|---|
| **I** | **VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT** | **2,801,453** | **7,507,119** |
| **1** | **Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente(+)** | 26,720,000 | 32,200,000 |
| **2** | **Arkëtime e të hyra(Cash), gjatë vitit ushtrimor** | **0** | **0** |
| | Të hyra, Sponnsorizime nga të tretë (+) | 0 | 0 |
| **3.** | **Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente** | **-23,918,547** | **-24,692,881** |
| | Për detyrime e shpenzime nga viti i kaluar(-) | - | - |
| | Për detyrime e shpenzime te vitit ushtrimor(-) | -23,918,547 | -24,692,881 |
| **II** | **VEPRIMTARITË E INVESTIMEVE** | - | - |
| **III** | **TRANSFERTA E TË TJERA** | **-2,801,453** | **-7,507,119** |
| | Transferime në buxhet të Fondeve të pa përdorura(-) | -2,801,453 | -7,507,119 |
| **IV** | **Rritja/Rënia neto e Mjeteve monetare** | **0** | **0** |
| **V** | **Teprica në fillim të vitit ushtrimor** | **-** | **-** |
| **VI** | **Teprica e Likujditeteve në fund të vitit ushtrimor** | **-** | **-** |

***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO/FONDET NETO, Formati 4***

| *Numër llogarie* | *Emërtimi* | *Fonde bazë Dhe Grante Kapitale* | *Rezultatet e Ushtrimit Tepricë/Deficit* | *GJITHSEJ Aktive/Neto Fonde/Neto* |
|---|---|---|---|---|
| ***101*** | ***I.AKTIVET NETO/FONDET NETO*** | ***8,975,574*** | - | ***8,975,574*** |
| | ***II.NDRYSHIMET NË AKTIVET/FONDET NETO*** | ***0*** | *-661,681* | ***-661,681*** |
| | ***1.NGA BURIME TË BRENDSHME*** | | *-661,681* | ***-661,681*** |
| ***105*** | *Nga grantet e brendshme kapitale(+)* | | | |
| ***85*** | *Nga rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)* | | | |
| ***115*** | *Nga Fondet e veta të investimeve (+,-)* | | | |
| **1013** | *Nga konsumi i AAGJ(-) Amortizimi* | | *-661,681* | ***-661,681*** |
| | **2. NGA BURIME TË JASHTME** | | | |
| 106 | Nga grantet e Jashtme kapitale(+) | | | |
| | ***TOTALI I FONDEVE TË VETA (I+II)*** | | ***-661,681*** | ***-661,681*** |

Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/Fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar" ***në vlerën 8,975,574 lekë.***
Pasqyra e Aktiveve neto/Fonde neto është plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në UMF për "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".
Edhe shënimet shpjeguese (Pasqyra F5) në përgjithësi janë plotësuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. nr. 8, datë 03.09.2019, pika 3.7 "Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale".

***PASQYRAT STATISTIKORE***

***Pasqyra statistikore nr. 8 "Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave".***

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave" është bërë në në zbatim të kërkesave të përcaktuara në UMF nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.8.4 "Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave", si më poshtë:

| Nr. | Kategoritë | Numri mesatar vjetor i punonjësve gjithsej | NUMRI I PUNONJËSVE ndryshuar gjatë vitit | | | FONDI I PAGAVE DHE KONTRIBUTET | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Pr, të rin | Larguar | Gjendje në fund të vitit ushtrimor | Fondi i pagave gjithsej | Shpërblime suplementare | Ndihma shoqërore të menjëhershme | Kontributi sig.shoq. dhe shëndetësore | Shpërblime të tjera | Tatimi mbi të ardhurat |
| | **Nr.i punonjës gjithsej ( 1+2+3+4+5)** | - | **29** | - | - | **17,610,394** | **0** | **0** | **3,104,724** | **0** | **1,117,763** |
| 1 | Drejtues | - | 1 | 0 | 0 | 820,692 | | | 114,348 | | 85,920 |
| 2 | Specialist me arsim të lartë | - | 26 | - | - | 16,016,926 | - | - | 2,892,912 | | 1,031,843 |
| 3 | Teknikë | - | - | - | - | | | | | | |
| 4 | Nëpunës të thjeshtë | - | - | - | - | | | | | | |
| 5 | Punëtorë | - | 2 | - | - | | | | 97,464 | | |
| 6 | Punëtorë të përkohshëm | - | | | | | | | | | |

***Formati 3/1-Shpenzimet e vitit ushtrimor 2022.***

*Shpenzimet e ushtrimit të vitit 2022, sipas formatit 3/1, evidentohen në vleren 23,918,547 lekë që përfaqësohen nga:*

*I. Pagat dhe përfitimet e punonjësve me një vlerë 18,728,157 lekë*

*II. Kontribute të Sigurimeve në vlerën 3,104,724 lekë*

*III Blerje Mallra e Shërbime në vlerë 1,615,666 lekë e cila përbëhet nga: llogaria 6020 "Materiale zyre e të përgjithshme" në vlerën 294,486 lekë, llog 6022 "Shërbime nga te trete" vlerën 289,983 lekë, llog. 6023 "Shpenzime Transporti" në vlerën 465,437 lekë, llog.6024 "Shpenzime udhëtimi" në vlerën 280,540 lekë, llog. 6025 "Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme" në vlerën 285,220 lekë.*

*(Sa më sipër është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 03, datë 09.06.2023)*

**Pretendimi i subjektit:**

*ARM Lezhë-Shkodër-Kukës, me shkresë nr. 504, datë 16.06.2023, ka dërguar observacionin për Akt-Konstatimin nr. 3, datë 09.06.2023,* ***observacion i cili nuk është i konfirmuar nga hartuesi me emrin dhe mbiemrin****, por megjithatë u shqyrtua nga ana jonë.*

*Observimi ka të bëjë më mosparaqitjen e shumës së akumuluar te amortizimit në llogarinë 219 si dhe në llogarinë 681 "Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit", ku është dhënë opsioni se formati i pasqyrave financiare nuk I paraqit llogaritë 219 dhe 681.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Megjithëse observacioni lë shumë për të dëshiruar me parregullsitë e paraqitjes, për shkak të mos konfirmimit të tij, meqenëse formati i pasqyrave financiare nuk I paraqit llogaritë 219*

*dhe 681, merret parasysh në çështjet të cilat konsiderohen të pandryshueshme dhe reflektohet në Projekt-Raportin e Auditimit.*

***<u>Pika 3.1.Inventarizimi i pronës shtetërore dhe paraqitja e saktë në pasqyrat financiare</u>***

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 01.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, të VKM nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", të Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 54, datë 24.02.2020 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPUT qendër dhe degëve rajonalë të saj në institucionet e tjera të varësisë së MTM", të udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër-Lezhë-Kukës, ka nxjerrë urdhra të brendshëm, për marrjen në dorëzim të inventarit ekonomik të DRM-ve dhe ISHMPUT-ve Shkodër, Lezhe, Kukës.

Të gjithë proces-verbalet e përmendura me sipër janë nënshkruar nga dorëzuesit ish-specialistë të DRM-ve dhe ISHMUP-ve, të shoqëruara me inventarët përkatës të marrë në dorëzim, me fletë-hyrjet përkatëse dhe me fletë-daljet për personat që kanë marrë në ngarkim këto inventarë.

Në zbatim të Programit të Auditimit (Inventari fizik), u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. *Urdhrat e titullarit për inventarizimin:*
2. *Pasqyrat e inventarit dhe proces-verbalet.*

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm;

-*Ligji Nr.10296 , datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin " i ndryshuar;*

-*Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik " i ndryshuar;*

**<u>Vitet 2020, 2021, 2022</u>**

Nga auditimi u konstatua se Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", neni 26 ku citohet: "*Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur."*

Për vitet 2020, 2021, 2022, janë nxjerrë urdhrat e Drejtorit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë-Shkodër-Kukës *"Për krijimin e komisionit të inventarizimin dhe vlerësimit të Aktiveve"*

**Nga auditimi u konstatua se;**

1.Komisionit të inventarizimit i ngritur me urdhrin e Titullarit të institucionit, në fillim të procesit të inventarizimit i është vënë në dispozicion, lista e aktiveve për inventarizimin e hartuar nga Nëpunësi zbatues mbi bazën e të dhënave të pasqyruara në regjistrat kontabël të njësisë , duke zbatuar Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

***2***-Në momentin e fillimit në objekt të procesit të inventarizimit, anëtarët e komisionit nuk kanë përpiluar deklarata, nëse kanë konflikt interesi, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* pika 82, <u>ku përcaktohet se</u>: "*Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi...*";

***3***-Komisioni i inventarizimit fizik ka bërë verifikimin në natyrë, gjendjen e vlerave materiale që ndodhen në përdorim nga punonjësit në çdo zyrë të ARM –së dhe ka bëri verifikimin faktik të gjithë bazës materiale të AQT, Inventar i Imët gjendja faktike dhe të shpërndara të punonjësit, u rakordua me kartelat personale të punonjësve dhe në përfundim të procesit ka

përgatitur raportin informues për të paraqitur te Titullari i njësisë shpenzuese, informacionin mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve dhe materialeve të institucionit, përfshirë në mënyre analitike dhe përmbledhëse inventarizimin e kryer sipas llogarive në objektet përkatëse; sipas inventarizimit të kryer në fakt, për gjendjen fizike të vlerave materiale në përfundim të periudhës raportuese data 31.12.2020, e UMF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*

***4***-Komisioni i inventarizimit, në fletët e inventarizimit fizik ka pasqyruar në lidhje me gjendjen cilësore të aktiveve, aseteve e vlerave materiale mbi të cilën njësia shpenzuese të bëjë vlerësimin e gjendjes cilësore të tyre, veprim në përputhje me pika 85, germa (a); 86 dhe 95 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit, u konstatua se komisioni ka bërë vlerësimin e aktiveve në përputhje të me UMF Nr. 30, datë 27.11.2011 ku përcakton se; "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*

**5-**Rregjistri kontabël rakordon me regjistrin fizik.

a. Inventari ekonomik dhe i imët (218( vlera 6,515,562 lekë

**Totali: vlera 6,515,562 lekë**

**6-**Inventarizimi i mjeteve: Agjencia Rajonale e Mjedisit ka gjithsej 3 Automjete të cilat të janë makina në përdorim.

or megjithatë u konstatua se:

*Nga ana e Sektorit të Financës nuk është plotësuar regjistri i aktiveve formati i të cilit përmban datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, kohën e shpenzimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes , datën e daljes nga pronësia, në mospërputhje me pikën 30 e UMF Nr. 30, datë 27.11.2011 ku përcakton se; "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" e cila përcakton se "Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia."*

***Persa mangësitë e trajtuara më sipër mban përgjegjësi Përgjegjësja e Sektorit të Financës znj. D. Sh.***

*(Sa më sipër është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 03, datë 09.06.2023)*

**Pretendimi i subjektit:**

*ARM Lezhë-Shkodër-Kukës, me shkresë nr. 504, datë 16.06.2023, ka dërguar observacionin për Akt-Konstatimin nr. 3, datë 09.06.2023,* ***observacion i cili nuk është i konfirmuar nga hartuesi me emrin dhe mbiemrin****, por megjithatë u shqyrtua nga ana jonë.*

*Observimi ka të bëjë më paraqitjen e inventarit të viteve 2020, 2021, 2022, lidhur me llogarinë 215 "Mjete Transporti", inventar i cili nuk na u paraqit gjatë periudhës së auditimit. Materiali për inventarët është fotokopje e pa njëjësuar me origjinalin, si dhe*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Megjithëse observacioni lë shumë për të dëshiruar me parregullsitë e paraqitjes, për shkak të mos konfirmimit të tij si dhe dokumentacionit fotokopje, merret parasysh në çështjet të cilat konsiderohen të pandryshueshme dhe reflektohet në Projekt-Raportin e Auditimit.*

| Titulli i gjetje | Mungesë dokumentacionin në regjistrimin dhe inventarizimin e aseteve |
|---|---|
| Situata: | -ARM Lezhë-Shkodër-Kukës, (anëtarët e komisionit), në momentin e fillimit në objekt të procesit të inventarizimit, nuk kanë përpiluar deklarata, nëse kanë konflikt interesi.<br>-ARM Lezhë-Shkodër-Kukës, (Sektori i Financës) nuk ka hartuar/plotësuar regjistrin e aktiveve formati i të cilit përmban datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, kohën e shpenzimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes , datën e daljes nga pronësia. |
| Kriteri: | - Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* pika 82, 30. |
| Ndikimi/Efekti | Ulje e përformancës së pasqyrave financiare dhe procesit të inventarizimit |
| Shkaku | Mungesë koordinimi dhe njohjeje |
| Rëndësia | E Mesme |
| Rekomandim | Agjencia Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës (Sektori i Financës), të marrë masat që anëtarët e komisionit të inventarizimit të përpilojnë deklaratat e konfliktit të interesit në momentin e fillimit të procesit të inventarizimit si dhe të hartojë/plotësojë regjistrin e aktiveve. |

***2.4."Mbi auditimin e procedurave për mendimet e dhëna nga ARM, për lejet mjedisore të Tipit A dhe B, auditim i procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM paraprake/ të thelluara) " u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:***

1. Aplikimet për VNM paraprake / të thelluar;
2. Aplikimet për leje mjedisi Tipi A/B;
3. Mendimet e ARM-së për VNM paraprake/ të thelluar;
4. Mendimet e ARM-së për lejet e mjedisit Tipi A/B;
5. Konsultimet me publikun.

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që;**
Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL" si dhe VKM nr.686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore", Agjencitë Rajonale të Mjedisit japin mendimin e tyre me shkrim Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për aplikimet (Leje mjedisi Tipi A/B, aplikimet për VNM paraprake/të thelluar ) që ndodhen në juridiksionin territorial të tyre.
Referuar formatit për dhënie mendimi për VNM-të, i miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr.228 prot., datë 03.02.2016, pika 6 përcakton se; *Agjencitë Rajonale të Mjedisit kanë për kompetencë verifikimin në terren të raporteve të VNM-ve.*
Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës ne strukturën organizative ka 5 specialistë lejesh mjedisore dhe 1 përgjegjës lejesh mjedisore. Çdo aplikim për leje mjedisi Tipi A/ B dhe

aplikimet për VNM paraprake/ të thelluar shqyrtohet nga një specialistë lejesh mjedisi dhe konfirmohet nga përgjegjësi i sektorit të lejeve të mjedisit.
Subjektet kanë aplikuar për VNM paraprake/ të thelluar , nëpërmjet sistemit të lejeve e-albania. Në rrugë elektronike, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i ka dërguar aplikimet në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. AKM-ja, i ka përcjellë në mënyrë elektronike kërkesat për leje ARM-së Shkodër, Lezhë, Kukës. Të gjitha kërkesat e subjekteve që kanë ardhur në formë elektronike në ARM Shkodër, Lezhë, Kukës ruhen në arkivin e dokumenteve elektronike, gjë që lejon mundësinë e verifikimit të tyre, nëse janë kryer procedurat e përcaktuara në Vendimin Nr.686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore".
Për periudhën 01.09.2020-31.12.2020, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës ka dhënë mendime për VNM paraprake / të thelluar për 57 dosje.
Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e dhënies së mendimit për subjektet si më poshtë:

- **Aplikimet për VNM paraprake / të thelluar për vitin 2020**

| Nr.rendor | Subjekti | Aktiviteti/Veprimtaria | Vendndodhja | Mendimi i ARM Lezhë, Shkodër, Kukës | Mangësitë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | I.G | Ndërtimi i resortit turistik Silver Stand Resort | Pulaj-plazh të Velipojës | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.187 prot., datë 09.09.2020) (Konc. Sh. F., K. H., është e pa firmosur | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 2. | A. D. | Prodhim i produkteve me bazë qumështi | Fshati Tarazh, Bashkia Mirditë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.302 prot., datë 05.10.2020) (Konc. Sh. F., i pa firmosur | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 3. | T.-2. | Instalime për therjen e kafshëve | Njësia Administrative Bajram Curri | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.187 prot., datë 09.09.2020) (Konc. Sh. F., është e pa firmosur ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 4. | A. S. | Kërkim,zbulimin dhe shfrytëzimin e mineralit të kromit | Njësia Administrative Kthellë dhe Selitë , Bashkia Mirditë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.399 prot., datë 20.11.2020) (Konc. Sh. F., është e pa firmosur ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 5. | A. | Nxjerrja e ujit nëntokësor dhe skemat e tjera për rimbushjen artificiale të ujërave nëntokësor | Njësia administrative Qafë Mali, Bashkia Fushë Arrëz | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.400 prot., datë 20.11.2020) (Konc. Sh. F.,është e pa firmosur ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 6. | K. | Instalime industriale për prodhimin e energjisë elektrike | Bashkia Vau i Dejës | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.378 prot., datë 06.11.2020) (Konc. Sh. F., është e pa firmosur ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 7. | P. M. | Përpunim i gëlqerorit dhe tregtimin e tij në lastra dhe pllaka | Njësia administrative Iballë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.213 prot., datë 15.09.2020) B. F.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 8. | B. J. | Mbarështim intensiv të pulave | Njësia Administrative Lac, Bashkia Kurbin | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.220 prot., datë 18.09.2020) Sh. F., është e pa firmosur ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 9. | A. R. | Prodhim i produkteve me bazë qumështi dhe përpunim i produkteve agro | Njësia Administrative Kthellë, Bashkia Mirditë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.265 prot., datë 28.09.2020) Konc.Sh. F., është e pa firmosur ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |

- Gjatë vitit 2021, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës ka dhënë mendime për **106** dosje. Nga grupi i auditimit u përzgjodhën për shqyrtim, praktikat si më poshtë:

| Nr.rendor | Subjekti | Aktiviteti/Veprimtaria | Venndodhja | Mendimi i ARM Lezhë, Shkodër, Kukes | Mangësitë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | E. P. | Ndërtim Heci | Fshati Kalis, Bashkia Kukës | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1352 prot., datë 01.12.2021) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2. | L. N. | Magazinë për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore | Fshati Gajush, Njësia Administrative Shënkoll | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1382 prot., datë 09.12.2021) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 3. | K.N. | Instalime për rritjen intensive të kafshëve | Fshati Kukel , Bashkia Vau i Dejës | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1400 prot., datë 14.12.2021) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 4. | P. H. | Servis për riparimin e makinerive për punimin e tokës bujqësore, dyqan për pjesë këmbimi të këtyre makinerive bujqësore dhe servis gomisteri | Lac, Kurbin | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1294 prot., datë 15.11.2021) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 5. | P. P. | Magazinë për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore | Njësia Administrative Shëngjin | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1190 prot., datë 26.10.2021) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 6. | V. D. | Instalime për rritjen intensive të kafshëve. Kompleks blegtoral | Fshati Beltojë , njësia administrative Bërdicë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.741 prot., datë 15.07.2021) (Konc. Sh. F., konfirmoi B.Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 7. | E. Gj. | Instalime për rritjen intensive të kafshëve. Kompleks blegtoral | Fshati Mali Hebaj, Njësia Administrative Bërdicë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.740 prot., datë 15.07.2021) (Konc. Sh. F., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 8. | K. K. | Fermë Blegtorale | Fshati Dedej | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.995 prot., datë 08.09.2021) (Konc. A. N. , konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 9. | F. D. | Fermë për mbarështimin intensive të derrave dhe dosave ekzistuese | Fushë Mamuras, Lac | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.986 prot., datë 07.09.2021) (Konc. A. N. , konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 10. | L. A. | Shfrytëzim i inerteve lumore në shtratin e lumit Mat | Ura e Matit, Pllanë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.500 prot., datë 09.06.2021) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 11. | G. | Shfrytëzim i inerteve lumore në shtratin e lumit të Matit | Njësia Administrative Milot | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.487 prot., datë 08.06.2021) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 12. | G. | Shfrytëzim i inerteve në shtratin e lumit Buna | Bërdicë, Shkodër | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.333 prot., datë 07.05.2021) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 13. | M. | Pulari për prodhimin e vezëve dhe ndërtim i stallës së re në shërbim të pularisë ekzistuese | Njësia administrative Kastrat, bashkia Malësi e Madhe | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.309 prot., datë 30.04.2021) (Konc. A. N.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 14. | Gj. | Shfrytëzim i inerteve në lumin Mat | Lezhë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.267 prot., datë 16.04.2021) (Konc. A. N.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 15. | A. M. | Ndërtim kompeks agroturistike | Fshati Gojan i Vogël , Njësia Administrative Gjegjan | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.171 prot., datë 17.03.2021) (Konc. A. N., Konf B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 16. | E. | Ndërtim kapanon 1 kat me funksion industrial, magazinim dhe përpunim i produkteve bujqësore | Njësia Administrative Bujan, Bashkia Tropojë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.30 prot., datë 21.01.2021) (Konc. Sh. F., Konf.B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 17. | U. | Rindërtimi i objekteve të banimit | Njësia Administrative Lac, Bashkia Kurbin | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.69 prot., datë 04.02.2021) (Konc. Sh. F., Konf.B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 18. | Z.M. | Instalime për rritjen intensive të kafshëve | Fshati Mabë, njësia Administrative Dajc | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.87 prot., datë 09.02.2021) (Konc. A. N., Konf.B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 19. | A. C. | Nxjerrja e mineraleve nga marina ose llumrat lumore | Njësia Administrative Milot | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.51 prot., datë 29.01.2021) (Konc. Sh. F., Konf .B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |

- Gjatë vitit 2022, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës ka dhënë mendime për **120** dosje.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën për shqyrtim, praktikat si më poshtë:

| Nr. | Subjekti | Aktiviteti/Veprimtaria | Vendndodhja | Mendimi i ARM Lezhë,Shkoder, Kukës | Mangësitë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | I. | Projekte për zhvillime urbane , duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave urbane dhe parkimet për makinat . Ndërtim bujtine për akomodim turistike | Bashkia Tropojë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.452 prot., datë 02.03.2022) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |
| 2. | G. | Shfrytëzim i mineralit krom | Njësia Administrative Ungrej | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.165 prot., datë 14.02.2022) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren. |
| 3. | T. | Projekte për zhvillime urbane , duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave urbane dhe parkimet për makinat. Ndërtimi i objektit kullë bujtinë | Njësia Bugjon, Bashkia Fushë Arrëz | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.268 prot., datë 17.02.2022) (B.F.) | Mungon verifikimi në terren. |
| 4. | Gj. | Gurore, miniera sipërfaqësore dhe nxjerrja e torfës | Fshati Gjobardhaj | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.266 prot., datë 17.02.2022) (B.F.) | Mungon verifikimi në terren. |
| 5. | 4 –A.. | Nxjerrja e mineraleve nga marina ose llumërat lumore. Shfrytëzim i inerteve lumore në shtratin e lumit Mat | Njësia Administrative Zejmen , Bashkia Lezhë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.499 prot., datë 16.03.2022) (Konc A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 6. | F.D. | Fermë për mbarështimin intensive të derrave dhe dosave ekzistuese | Lac , Kurbin | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.474 prot., datë 09.03.2022) (Konc. A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 7. | B. | Shpim për furnizim me ujë | Njësia Administrative Bërdicë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.472 prot., datë 08.03.2022) (Konc Sh. F., konf. B.Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 8. | L. &K. E. | Instalime peër prodhimin e energjisë hidroelektrike | Përroi i Thatë, Bashkia Kukës | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.766 prot., datë 20.06.2022) (Konc. A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 9 | H. E.L | Godinë banimi 7 kat dhe 1 kat parkim nëntokë | Bashkia Shkodër | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.38 prot., datë 13.01.2022) (Konc. A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 10. | F. Gj. | Strukturë me 2 kate në funksion të blegtorisë.Rritje intensive e shpendëve në një instalim | Njësia Administrative Kthellë, Bashkia Mirditë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1110 prot., datë 10.10.2022) (Konc. A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 11. | A.M. | Kapanon Bujqësor 1 kat | - | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1197 prot., datë 27.10.2022) (Konc. A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 12. | A.C. | Industria nxjerrëse. Gurore | Njësia administrative Mamurras , Bashkia Kurbin | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1307 prot., datë 22.11.2022) (Konc. A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 13. | A. K sh..p.k | Instalime për prodhimin e energjisë. Prodhim i pastër i energjisë elektrike | Përroi i Leshnicës, Njësia Administrative Kolsh | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1214 prot., datë 01.11.2022) (Konc. A.N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 14. | V. M. | Magazinë bujqësore 1 kat | Njësia administrative Milot | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1328 prot., datë 02.11.2022) (Konc. A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 15. | P.-V. sh.p.k | Shfrytëzim i inerteve lumore në Lumin Fan | Njësia Administrative Rubik | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1015 prot., datë 26.09.2022) (Konc. A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 16. | A. sh,p.k S | Shfrytëzim i inerteve lumore në lumin Mat | Njësia administrative Milot, Bashkia Kurbin | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.973 prot., datë 13.09.2022) (Konc. A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 17. | B. sh.p.k | Magazinë 1 kat | Njësia Administrative Lac, Bashkia Kurbin | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.831 prot., datë 13.07.2022) (Konc A. N., konf. B. Sh. ) | Mungon verifikimi në terren. |
| 18. | S. S | Shfrytëzim i mineralit të kromit | Bashkia Has | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.904 prot., datë 22.08.2022) ( B. F. ) | Mungon verifikimi në terren. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 19. | B. e H. | Agroturizëm | Bashkia Pukë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.1353 prot., datë 01.12.2022) (Konc. A. N., konfirmoi B. Sh.) | Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së |

Në çdo aplikim për VNM paraprake/ të thelluar bashkëlidhur gjendet:
-raporti teknik i projektit të propozuar;
-raporti paraprak/ të thelluar i VNM-së;
-akti i regjistrimit të personit fizik/juridik;
-një kopje e faturës së pagesës së tarifës së shërbimit.
Referuar formatit të dhënies së mendimit për VNM-të paraprake/të thelluar, miratuar nga Agjencia Kombëtare të Mjedisit, pika 6 e formatit përcakton; **verifikimi të bëhet në terren dhe jo nga dosja që vjen elektronikisht**. Nga auditimi konstatohet se Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, pikën 6 të shkresës për dhënie mendimi nuk e plotëson me të dhëna.
ARM Lezhë, Shkodër, Kukës e jep mendimin për VNM paraprake/ të thelluar duke e shqyrtuar dosjen në mënyrë elektronike, kjo në kundërshtim edhe me zbatimin e ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"**,** neni 63, pika ç, ku përcaktohet**;**
*"Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit përfshin :*
*ç) verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë"* .
Po kështu, nga auditimi u konstatua se në ëeb-in e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës nuk është publikuar asnjë raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), nëpërmjet të cilës publiku të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore, kjo në kundërshtim me pikën 1, të Rregullores nr.01, datë 03.03.2017 "Për zbatimin e procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ku përcakton se;

*Për një proces sa më transparent për informimin e publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së dhe marrjen e mendimit nga publiku, punonjësi i autorizuar nga ARM e qarkut përkatës, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së aplikimit për procedurë të VNM-së paraprake, publikon në faqen zyrtare të internetit informacionin e plotë siç ka mbërritur nga zhvilluesi/kërkuesi.*

**Konkluzione:**
-Nga auditimi rezultoi se gjatë periudhës 01.09.2020-31.12.2022, mendimet për VNM paraprake/ të thelluar janë dhënë nga shqyrtimi në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit e-leje dhe nuk është kryer verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së, veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"**,** neni 63, pika ç, dhe me pikën 6 të formatit të miratuar për dhënie mendimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
Po kështu, për periudhën 01.09.2020-31.12.2022, titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës nuk ka përcaktuar asnjë person përgjegjës për publikimin e raporteve të VNM-së paraprake në ëeb-in e ARM-së për informimin e publikut gjatë procedurës për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, veprime që bien në kundërshtim me rregulloren nr. 01, datë 03.03.2017 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit "Për zbatimin e procedurave dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".
**Për sa u trajtua në këtë projekt raport mbajnë përgjegjësi:**
Z. B. F., Drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës;

Z. B.Sh., përgjegjës i sektorit të lejeve të mjedisit;
Znj.A.N., specialiste e lejeve mjedisore.
*(Sa më sipër është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 4, datë 09.06.2023)*

- **Aplikimet e Lejeve Mjedisore dhe mendimet përkatëse të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës gjatë vitit 2020**

Mendimet për leje mjedisi Tipi A/B jepen bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.419, datë 25.06.2014 dhe rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr.120 prot, datë 12.01.2021.

Sipas VKM nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL" , kreu III, kërkuesi që aplikon për tu pajisur me leje mjedisi Tipi B duhet të dorëzojë këto dokumente:

a*) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;*
*b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit";*
*c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;*
*ç) Kopjen e vendimit të AKM-së për VNM-në paraprake ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";*
*d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet;*
*dh) Relacionin rreth dëgjesës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi.*

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka dërguar një kopje të aplikimit në ARM-në Shkodër, Lezhë, Kukës, për 317 dosje në total për periudhën 01.09.2020-31.12.2022, e cila ka dhënë mendimin e saj me shkrim.

Gjatë vitit 2020, Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës ka kryer dhënie mendimi për **20** leje mjedisore Tipi A/B .

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën praktikat si më poshtë:

**1.Subjekti C. ( LC-1... )** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike me vendndodhje në Malësinë të Madhe.

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 165 prot., datë 04.09.2020 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**C.**" sh.p.k.(Shkresa është firmosur nga B. F.)

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e planifikimit të zonës;
-Sipas pikës 2 të formularit informues, subjekti nuk ka bashkëngjitur planimetri, plan vendosje të instalimit;
-Subjekti nuk ka bashkëngjitur leje për përdorimin e ujit nga institucionet kompetente;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.

**2.Subjekti M. ( LC-3...)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to me vendndodhje në bashkinë Tropojë.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 236 prot., datë 22.09.2020 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**M.**"sh.p.k.( Shkresa është firmosur nga B. F.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**3.Subjekti V. I. I. ( LC-1..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin nxjerrja e mineraleve, rërës, argjilës nga miniera me shfrytëzim në qiell të hapur me vendndodhje në objektin Mamëz- Qarku Kukës.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 304 prot., datë 06.10.2020 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**V. I. I.**" sh.p.k.( Shkresa është firmosur nga B. F.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Referuar pikës 1.6 të formularit informues, subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e planifikimit të zonës;
- Referuar pikës 5 të formularit informues, subjekti nuk deklaron sesi menaxhohen mbetjen që dalin nga aktiviteti;
-Nuk është kryer verifikimi në terren i instalimit.
**4.Subjekti L. Gj. ( LC-2..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin magazinim, rikuperim i hekurishteve /skrapeve të metalit ose çmontimi i mbetjeve nga motorët e makinave. Lyerja dhe lustrimi i makinave. Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave me vendndodhje në Gur i Zi, Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 340 prot., datë 21.10.2020 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**L. Gj.**" sh.p.k.(B. F.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues nuk është bashkëngjitur dokumenti i planifikimit të zonës;
-Sipas pikës 2 të formularit informues nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;
-Subjekti nuk ka bashkëngjitur raportin e vlerësimin në mjedis;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**5. Subjekti R. ( LC-2...)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin funksionim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane. Gaz natyror ose GLN , përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A ose përzierje e aromave me vendndodhje në Shënkoll.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr.379 prot., datë 06.11.2020 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**R.**" sh.p.k.(Shkresa është konceptuar nga I. S., por nuk është firmosur)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Sipas pikës 1.6 të formularit informues nuk është bashkëngjitur dokumenti i planifikimit të zonës;**
**-Mungon verifikimi në terren i instalimit .**

**6.Subjekti P.-S. ( LC-2..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin nxjerrja e mineraleve, rërës , argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret me vendndodhje në bashkia Lezhë.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 429 prot., datë 04.12.2020 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**P. –S.**”sh.p.k.( Shkresa është konceptuar nga I. S., por nuk është firmosur)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Subjekti nuk ka bashkëngjitur planin e veprimit për guroret;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.

- **Leje mjedisi Tipi A/B gjatë vitit 2021**

Gjatë vitit 2021, Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës ka kryer dhënie mendimi për **176** Leje mjedisore Tipi A/B .
Nga grupi i auditimit u përzgjodhën praktikat si më poshtë:
**1.Subjekti B. J. ( LC-3..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin rritje intensive e shpendëve në një instalim, me vendndodhje në Kurbin, Lezhë.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 17 prot., datë 15.01.2021 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**B. J.**” (Shkresa është konceptuar nga A. D., por është e pa firmosur)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungon projekti i mbrojtjes nga zjarri;
-Sipas VKM Nr. 416 datë 25.06.2014 mungon një relacion për dëgjesën me publikun;
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;
-Sipas pikës 2 të formularit informues, mungojnë skica, planimetri të instalimit;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**2.Subjekti A. C. ( LC-4..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos , si dhe prodhim i llacit, kollës , gëlqeres, me vendndodhje në lagjja nr.6, rruga e Patokut, Lezhë.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 97 prot., datë 12.02.2021 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**A. C.**” sh.p.k ( Specialistë B. Sh., A. D.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Subjekti nuk ka paraqitur një akt miratim nga institucionet kompetente për përdorimin e ujit në dobi të aktivitetit;**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**3.Subjekti A. P. &P. sh.p.k ( LC-4..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin prodhim i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë gdhendjen , tornimin , zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit, me vendndodhje në lagjja nr.6, Laç.

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 114 prot., datë 23.02.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A. P. &P.** "sh.p.k.(Specialistë B. Sh., A. D., shkresa është e pa firmosur)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Nuk është paraqitur raporti i vetmonitorimit të subjektit;**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**4.Subjekti A. Y. ( LC-4..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin spitalet, me vendndodhje në rruga "Babej", Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 142 prot., datë 03.03.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A.Y.**"sh.p.k.(Specialist A.N., përgjegjës B. Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Raporti i sigurisë është për aktivitetin spitalet ditore pa shtretër, kurse formulari i aplikimit është për aktivitetin spital;
- Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur dokumenti i planifikimit të zonës;
-Sipas pikës 2 të formularit informues, mungojnë skica, planimetri të instalimit;
-Nuk është kryer verifikimi në terren për instalimin.
**5.T. B. ( LC-6...)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave, me vendndodhje në Vaun e Dejës, Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 190 prot., datë 23.03.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**T.B.** "sh.p.k.(B. Sh., I. S. e pa firmosur)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Certifikata e pronësisë nuk është për vendndodhjen për të cilën subjekti kërkon të pajiset me leje mjedisi;
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**6.Subjekti A. B. ( LC-5..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit në zonat urbane me vendndodhje në Postribë, në Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 259 prot., datë 14.04.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A.B.**"sh.p.k.(B.F.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Në formularin informues Tipi B, aplikuesi ka përshkruar aktivitetin e një subjekti tjetër;
- Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;
-Certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit i ka mbaruar afati;
-Mungon një vetëdeklarim i subjektit për shlyerjen e detyrimeve financiare;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.

**7.Subjekti E. O. ( LC-6..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant, me vendndodhje në lagjja Dardania , Tropojë.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 444 prot., datë 3.06.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**E. O.**"sh.p.k.(Specialistë A. N., B. Sh. përgjegjës )
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Raporti i vetmonitorimit nuk është i 6 mujorit të fundit;
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**8.Subjekti E. ( LC-6.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin impiantet e pasurimit të mineraleve me vendndodhje në Fushë Kalimash-Kalimash.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 329 prot., datë 06.05.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**E.**"sh.p.k.(Specialist A. D., konfirmoi B. Sh. )
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e planifikimit të zonës;
- Referuar VKM Nr. 419 , datë 25.06.2014, subjekti nuk ka bashkëngjitur raportin e sigurisë;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**9.Subjekti A.F. ( LC-7350)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin rritje intensive e shpendëve në një instalim me vendndodhje në Mamurras, Kurbin, Lezhë .
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 647 prot., datë 2.07.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A. F.**"sh.p.k.(Specialiste A. N. , B. Sh. përgjegjës )
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Mungon leja e përdorimit të ujit nga institucionet kompetente;**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**10.Subjekti J. ( LC-7.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin prodhim i mobilieve me vendndodhje në Lezhë.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 830 prot., datë 02.08.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**J.**"sh.p.k.(B. F.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti nuk ka bashkëngjitur një dokument të planifikimit të zonës;
-Sipas pikës 2 të formularit informues, nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**11.Subjekti A. T. ( LC-41.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret me vendndodhje në fshatin Stajkë, Shkodër.

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 926 prot., datë 19.08.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A. T.**"sh.p.k.(Specialist S. M., B. Sh. përgjegjës )

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

**-Referuar formularit informues Tipi B, tabela 1.7 është e paplotësuar;**

**-Mungon Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis(VNM);**

**- Mungon verifikimi në terren i instalimit.**

**12.Subjekti M. A. ( LC-9.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve me vendndodhje në fshatin Shelqet, Shkodër .

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 1173 prot., date 22.10.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**M.A.** "sh.p.k.(Specialist Sh. F., B. Sh. përgjegjës )

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

-Subjekti duhet të bashkëngjisë Vendimin e AKM për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ( VNM);

-Sipas pikës 1.6 të formularit informues subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e planifikimit të zonës;

-Mungon verifikimi në terren i instalimit.

**13.Subjekti B. P. ( LC-9.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin gaz natyror ose GLN përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A ose përzierje e aromave. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zona urbane, me vendndodhje në autostrada "Mamurras-Laç", km 5.

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 1172 prot., date 22.10.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**B. P.**" sh.p.k.(B. F.)

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

**-**Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;

-Mungon shkresa e AKM për ri-klasifikimin e subjektit në leje të Tipit B;

-Sipas VKM-së nr. 419 datë 25.06.2014, subjekti nuk ka bashkëngjitur një relacion për dëgjesën me publikun;

-Mungon një vetëdeklarim për shlyerjen e të gjithë detyrimeve financiare( gjobë+ tarifë vjetore);

-Mungon verifikimi në terren për instalimin.

**14.Subjekti i. ( LC-0.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin gaz natyror ose GLN përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A ose përzierje e aromave. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zona urbane me vendndodhje në Laç.

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 1429 prot., datë 24.12.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**i.**"sh.p.k.(Specialist Sh. F., B. Sh. përgjegjës )

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

**-Raporti i sigurisë nuk i përket adresës për të cilën subjekti kërkon të pajiset me leje mjedisi ;**

-Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**15.Subjekti U. K. ( LC-9.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin trajtim i ujërave të ndotura me vendndodhje në Shëngjin. ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 1370 prot., datë 06.12.2021 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim negativ drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**Ujësjellës Kanalizime**”.( Specialist Sh.F. , përgjegjës B. Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**16.Subjekti P. ( LC-4.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, me vendndodhje në Shënkoll, Lezhë .
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 178 prot., datë 18.03.2021 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**P.** ”sh.p.k.(Specialiste A. D., konfirmoi B. Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Subjekti nuk ka bashkëngjitur shkresën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si subjekt i ri klasifikuar për leje mjedisi Tipi B;
-Referuar pikës 2 të formularit informues, nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**17.Subjekti L. T.( LC-4.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në Velipojë , Shkodër .
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 179 prot., datë 18.03.2021 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**L.T.**”sh.p.k.(B. F.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Subjekti nuk ka bashkëngjitur shkresën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si subjekt i ri klasifikuar për leje mjedisi Tipi B;
-Referuar pikës 2 të formularit informues, mungojnë planimetri, skica të instalimit;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**18.Subjekti G. ( LC-5.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin Gaz natyror aromatik ose GLN , përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A ose përzierje e aromave. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në Dajc, Shkodër .
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 509 prot., datë 10.06.2021 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**G.**” sh.p.k.(Specialiste A. D., konfirmoi B.Sh. )
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Subjekti nuk ka bashkëngjitur shkresën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si subjekt i ri klasifikuar për leje mjedisi Tipi B;
- Subjekti nuk ka bashkëngjitur një vetëdeklarim për shlyerjen e detyrimeve financiare ( tarifë vjetore +gjobë);
-Aktiviteti që subjekti ka qenë i pajisur me leje mjedisi Tipi C nuk përputhet me aktivitetin për të cilën subjekti aplikon.

**19.Subjekti D. &E. ( LC-5.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin nxjerrja e mineraleve , rërës, argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret me vendndodhje në objektin Droje 5 , Lezhë .
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 106 prot., datë 18.02.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**D.&E.**" sh.p.k.(Specialiste A. D. , konfirmoi B. Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mbetjet nuk janë deklaruar sipas legjislacionit mjedisor në fuqi;
-Sipas pikës 2 të formularit informues , nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**20.Subjekti I. ( LC-5)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin prodhim i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri nqs veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimi me rërë , gdhendjen, tornimin , zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit me vendndodhje në ish- Kombinati i Drurit, Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 219 prot., datë 31.03.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**I.**" sh.p.k.(Specialiste I.S., konfirmoi B. Sh. )
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Sipas pikës 1.6 subjekti duhet të bashkëngjisë dokumentin e planifikimit të zonës;
-Subjekti nuk ka bashkëngjitur një vetëdeklarim për dorëzimin e raporteve të vetmonitorimit dhe shlyerjen e pagesës vjetore ;
-Mungon verifikimi në terren i subjektit.

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes:** | Mospërmbushje e detyrave në dhënien e mendimit për VNM paraprake/të thelluar. |
| **Situata:** | Shqyrtimi i praktikave me nr.rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9 (shqyrtimi i VNM-ve gjatë vitit 2020 ) dhe praktikat me numër rendor 1-19 (shqyrtimi i VNM –ve gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022), janë bërë në mënyrë elektronike dhe nuk është kryer verifikimi në terren. |
| **Kriteri:** | Ligji Nr. 10 431, datë 09.06.2011 " Për mbrojtjen e mjedisit", neni 63 , pika 6 |
| **Ndikimi/Efekti:** | Nuk janë ruajtur objektivat e mbrojtjes së mjedisit si:<br>a) parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;<br>b) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit. |
| **Shkaku:** | Mungesë objektivash për mbrojtjen e integruar të mjedisit |
| **Rëndësia:** | E mesme |
| **Rekomandim:** | Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të marrë masa për verifikimin në terren të raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ( VNM ) të subjekteve që aplikojnë për tu pajisur me të. |

- **Leje Mjedisi Tipi A/B 2022**

Gjatë vitit 2022, Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës ka kryer dhënie mendimi për **121** Leje mjedisore Tipi A/B .
Nga grupi i auditimit u përzgjodhën praktikat si më poshtë:

**1. Subjekti D. ( LC-2.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin rritje intensive e shpendëve në një instalim me vendndodhje në Bërdicë e Mesme, Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 594 prot., datë 21.04.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**D.**"sh.p.k.(Specialist S. M.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e planifikimit të zonës;**
**-Sipas pikës 2 të formularit informues, nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;**
**-Referuar aplikimit , subjekti nuk ka bashkëngjitur raportin e sigurisë;**
**-Mungon verifikimi në terren i instalimit.**
**2. Subjekti B. K. sh.p.k ( LC-2.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin nxjerrja e mineraleve , rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret me vendndodhje në Njësinë Administrative Golaj, Has.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 522 prot., datë 24.03.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**B.K.**" sh.p.k.( Specialistë Sh.F., A. N., konfirmoi B. Sh.).
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Sipas pikës 2 të formularit informues nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**3.Subjekti A. A. ( LC-2.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin magazinim i hekurishteve /skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme me vendndodhje në Fushë Milot.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 657 prot., datë 11.05.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv (nuk plotëson kapacitetin) drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A.A.**" sh.p.k.( Specialist S. M.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-** Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**4. Subjekti D. ( LC-6.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin rritje intensive e shpendëve në një instalim me vendndodhje në Bërdicë e Mesme, Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 594 prot., datë 21.04.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**D.**"sh.p.k.(Specialistë S. M., Sh.F., konfirmoi B. Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e planifikimit të zonës;**
**-Sipas pikës 2 të formularit informues, nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;**
**-Referuar aplikimit, subjekti nuk ka bashkëngjitur raportin e sigurisë;**
**-Mungon verifikimi në terren i instalimit.**

**5 Subjekti B.( LC-5.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to me vendndodhje në Qafë Mali, Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 594 prot., datë 21.04.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**B.**"sh.p.k.(Specialist S.M.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Sipas pikës 2 të formularit informues, nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;**
**-Mungon verifikimi në terren i instalimit.**
6. **Subjekti A.-L. ( LC-7.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin nxjerrja e mineraleve, rërës, argjilës, nga minierat me shfrytëzim me qiell të hapur me vendndodhje në Bytyc Golaj, Kukës.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 1326 prot., datë 01.12.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A.-L.**"sh.p.k.(Specialist Sh.F., konfirmoi B.Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Sipas pikës 2 të formularit informues nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;**
**-Subjekti nuk ka bashkëngjitur planin e rehabilitimit të funksionimit të instalimit;**
**-Mungon verifikimi në terren i instalimit.**
**7. Subjekti G.S. ( LC-3.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B për aktivitetin përpunim, prerja dhe lustrimi i gurit. Prodhim dhe fraksioni i produkteve minerale jo metalikë me vendndodhje në fshatin Gromësirë.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 768 prot., datë 21.06.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**G. S.**"sh.p.k.( Specialist S. M. , përgjegjës B. Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Sipas pikës 1.6 të formularit informues , mungon dokumenti i planifikimit të zonës;**
**-Subjekti nuk ka bashkëngjitur një dokument për përdorimin e ujit nga institucionet kompetente;(fatura e pasqyruar nga subjekti i përket muajit janar 2022, ndërsa subjekti aplikon në muajin qershor 2022);**
**-Mungon verifikimi në terren i instalimit.**
**8.Subjekti L. Z.( LC-2.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin rritje intensive e shpendëve në një instalim me vendndodhje në Dajc, Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 557 prot., datë 05.04.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**L. Z.**".( Specialist S. M. , përgjegjës B.Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;
-Sipas pikës 2 të formularit informues nuk janë pasqyruar skica, planimetri të instalimit;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**9.Subjekti D. 2. sh.p.k ( LC-3.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin gaz natyror ose GLN, përveç rasteve kur veprimtaria

është e lidhur me Tipin A ose përzierje të aromave. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në Kolsh, Kukës.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 928 prot., datë 07.06.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**D. 2.**" sh.p.k.( Specialist S.M., konfirmoi B. Sh.).
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Certifikata e mbrojtjes nga zjarri i ka përfunduar afati;**
**-Në konsultimin me publikun nuk përshkruhet i gjithë aktiviteti për të cilën aplikuesi kërkon të pajiset me leje mjedisi ( përshkruhet vetëm aktiviteti karburant);**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**10.Subjekti F. ( LC-4.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin përpunim , prerja dhe lustrim i mermerit dhe gurëve dekorativ me vendndodhje në rrugën Bushat, Bashkia Vau i Dejës.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 847 prot., datë 18.07.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**F.**"sh.p.k.(Specialist Sh. F., përgjegjës B. Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Nuk është pasqyruar një miratim nga institucionet kompetente për përdorimin e ujit;**
**-Certifikata e pronësisë është për tokë arë;**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;
-Sipas pikës 2 të formularit informues, nuk janë pasqyruar skica, planimetri për të përshkruar proceset e punës të instalimit;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**11.Subjekti P.-P. ( LC-5.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zona urbane me vendndodhje në Bushat, Qarku Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 939 prot., datë 06.09.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**P.-P.** "sh.p.k.(Specialist Sh. F., përgjegjës B.Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Raporti i mbrojtjes nga zjarri nuk është për subjektin aplikuar;
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues, nuk është bashkëngjitur një dokument i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**12. Subjekti P. ( LC-5.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin nxjerrja e mineraleve, rërës, argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell të hapur dhe nga guroret me vendndodhje në objektin Gjana, Bashkia Has.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 941 prot., datë 06.09.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**P**"sh.p.k.(Specialist A. M.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Sipas pikës 2 të formularit informues nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;
-Mungon verifikimi në terren i subjektit.

**13. Subjekti V. ( LC-6.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit , përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhim i llacit, kollës, gëlqeres. Prodhim i produkteve abrazive, me vendndodhje në rrugën nacionale "Bajram Curri-Fierzë".
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 1043 prot., datë 03.10.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**V.**"sh.p.k.(Specialist A.M., përgjegjës B. Sh.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Referuar objektit të kontratës( prodhim dhe grumbullim i materialeve të ndryshme ndërtimore) me bashkinë Tropojë, nuk përfshihen të dyja aktivitetet për të cilat subjekti kërkon të pajiset me leje mjedisi Tipi B;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**14.Subjekti L.-8 ( LC-7.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin gaz natyror ose GLN përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zona urbane me vendndodhje në bashkinë Lezhë.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 1399 prot., datë 22.12.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**L.-8**"sh.p.k.( Specialist Sh.F.)
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Vërtetimi teknik për sigurinë e aktivitetit është jashtë afatit;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**16.Subjekti K.I. ( LC-1.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit , përfshirë ambalazhimin dhe përzierja e grumbullimi i betonit dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera si dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos si dhe prodhim i llacit , kollës , gëlqeres. Prodhim dhe fraksionimi i produkteve minerale jo metalikë me vendndodhje në Kukës.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 431 prot., datë 01.03.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**K.I.**"sh.p.k.( Specialist Sh.F. )
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Certifikata e pronësisë është për tokë arë;
-Projekti i mbrojtjes nga zjarri nuk ka të specifikuar adresën e kërkuar në aplikim;
-Subjekti deklaron se përdor ujë nga pusi, por nuk ka miratim nga organet kompetente;
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e planifikimit të zonës;
-Sipas pikës 2 të formularit informues nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;
-Mungon verifikimi në terren i instalimit.
**17.Subjekti G. S. ( LC-2.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B për aktivitetin përpunim, prerja dhe lustrimi i mermerëve dhe gurëve dekorativ. Prodhim dhe fraksioni i produkteve minerale jo metalikë me vendndodhje në fshatin Gruemirë.

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 577 prot., datë 17.04.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**G. S**" sh.p.k.( Specialist S.M., përgjegjës B. Sh.)

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

**-Sipas pikës 1.6 të formularit informues , mungon dokumenti i planifikimit të zonës;**

**-Subjekti nuk ka bashkëngjitur një dokument për përdorimin e ujit nga institucionet kompetente (fatura e pasqyruar nga subjekti i përket muajit janar 2022, ndërsa subjekti aplikon në muajin prill 2022);**

**-Mungon verifikimi në terren i instalimit.**

**18.Subjekti K. A.sh.p.k ( LC-0.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin gaz natyror ose GLN, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me Tipin A ose përzierje të aromave. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në rrugën nacionale "Bicaj- Kukës" .

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 69 prot., datë 26.01.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**K.A.**" sh.p.k.( Specialist S. M., konfirmoi B. Sh.).

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

-Mungon relacioni i dëgjesës me publikun;

-Kontrata e qirasë nuk është në formën e duhur ligjore;

-Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;

-Skica dhe planimetritë e subjektit nuk janë të dallueshme;

-Mungon verifikimi në terren për instalimin.

**19.Subjekti K. –L. sh.p.k ( LC-7.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në fshatin Gollja, Has, Qarku Kukës .

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën. 1282 prot., datë 14.11.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin"**K.-L."** sh.p.k.( Specialist Sh. F., konfirmoi B. Sh.).

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

-Certifikata e mbrojtjes nga zjarri i ka mbaruar afati;

-Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;

-Sipas pikës 2 të formularit informues mungon planvendosja e instalimit;

-Mungon verifikimi në terren për instalimin.

**20.Subjekti F-O. G. sh.p.k ( LC-5.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin gaz natyror ose GLN, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me Tipin A ose përzierje të aromave. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në fshatin Bushat, Qarku Shkodër.

ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 963 prot., datë 09.09.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**F-O. G.**" sh.p.k.( Specialist Sh. F., konfirmoi B. Sh.).

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

-Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;

-Sipas pikës 2 të formularit informues mungon planvendosja e instalimit;

-Mungon verifikimi në terren për instalimin.

**21.Subjekti A.F. sh.p.k ( LC-5.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në rrugën "Shtraus", Lezhë.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 912 prot., datë 24.05.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A.F.**" sh.p.k.( Specialist Sh. F. , konfirmoi B. Sh.).
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Konsultimi me publikun është për aktivitetin gaz dhe karburant, ndërsa aplikimi është për karburant;
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**22.Subjekti A. sh.p.k ( LC-5.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin gaz natyror ose GLN, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me Tipin A ose përzierje të aromave. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në rrugën "Tirana" , Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 911 prot., datë 24.08.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin" **A.**" sh.p.k.( Specialist Sh. F. , konfirmoi B. Sh.).
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**23.Subjekti D. sh.p.k ( LC-4.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin gaz natyror ose GLN, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me Tipin A ose përzierje të aromave. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në Hot i Ri, Shkodër.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 867 prot., datë 04.07.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**D.**" sh.p.k.( Specialist S. M., konfirmoi B. Sh.).
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.
**24.Subjekti H. 1 sh.p.k ( LC-3.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në Lagjia "Dardania", Kukës.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën nr. 756 prot., datë 15.06.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**H.**" sh.p.k.( Specialist S. M., konfirmoi B. Sh.).
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-Mungon relacioni për dëgjesën me publikun;**
**-Në planimetrinë e paraqitur nga subjekti në formularin informues pasqyrohet edhe aktiviteti GLN, ndërsa në aplikim pasqyrohet vetëm aktiviteti furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant;**
-Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
-Mungon verifikimi në terren për instalimin.

Duke bërë krahasimin ndërmjet viteve, konstatojmë se numri i mendimeve për leje mjedisi Tipi A/B është rritur, kjo si pasojë e ndryshimit të ligjit Nr.52/2020" Për lejet e mjedisit", ku instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit, klasifikohen si leje mjedisit të tipit B, aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
Modeli tip i dhënies së mendimit për leje mjedisi Tipi A/B është miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit , ku në pikën 6 citohet "*Agjencia Rajonale e Mjedisit... pas shqyrtimit të dosjes elektronike dhe /ose verifikimit në terren për aktivitetin..... jep mendimin e saj pozitiv /negativ në lidhje me aplikimin*".
**Nga auditimi u konstatua se për periudhën 01.09.2020-31.12.2022, dosjet e përzgjedhura për dhënie mendimi për leje mjedisi tipi A/ B rezultojnë të jenë me mangësi në dokumentacion, ndërsa mendimet përkatëse të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës kanë qenë pozitive si dhe nuk është kryer verifikimi në terren i operatorëve që aplikojnë për leje mjedisi Tipi A/B për të vërtetuar saktësinë e deklarimeve të subjektit në formularin informues.**
**Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se** nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit **Lezhë, Shkodër, Kukës** nuk është koordinuar me Qendrën Kombëtare të Biznesit, për vendimet e marra nga Ministri i Mjedisit, kjo në kundërshtim me pikën 5 dhe 9 të kreut VII të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Nr. 120 prot., datë 12.01.2021**,** ku përcakton se;
*-Mban dhe përditëson regjistrin me të dhënat për lejet që ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave të tyre;*
*-Mban lidhje me QKB-në duke koordinuar përgjigjet në kohë për aplikimet e marra.*
Nga auditimi rezultoi se disa prej praktikave për dhënie mendimi nuk janë firmosur nga specialistët e lejeve të Mjedisit, kjo në kundërshtim të Urdhrit "Për njësimin e dokumentit administrativ" (Vendimi Nr.4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë"), pika 1 dhe 2 përcakton se;
*1. Dokumentet administrative të përpiluara sipas Normave tekniko-profesionale të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë në përputhje me modelet bashkëlidhur këtij urdhri.*
*2. Siglimi i kopjes së dytë të dokumenteve kryhet si më poshtë:*
*Konceptoi: Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i konceptuesit .*

**Konkluzione :**
1.Nga auditimi rezultoi se mendimet për leje mjedisi Tipi A dhe B nuk janë dhënë konform legjislacionit mjedisor. Te gjitha praktikat e audituara kanë qenë me mangësi në dokumentacion dhe pavarësisht kësaj, mendimet nga ana e ARM **Lezhë, Shkodër, Kukës** janë dhënë pozitive, veprime këto që bien ndesh me VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 dhe me pikën 5 dhe 9 , kreun VII të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Nr.120 prot. datë 12.01.2021 "Rregullore e brendshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" ku përcaktohet se;
*Detyrat funksionale të specialistit /inspektorit të sektorit:*
*-rishikimin e dokumentacionit mbështetës të kërkesës për lejet mjedisore;*
*-kërkon informacion shtesë nëse del e nevojshme gjatë aplikimit.*
2.Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit **Lezhë, Shkodër, Kukës** për asnjë nga aplikimet e audituara, nuk është kryer verifikim në terren , kjo në kundërshtim me nenin 63, pika e, ë, f të ligjit me Nr. 10 431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit" ku përcaktohet se ;
*Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit përfshin:*
*e) vlerësimin e operacioneve të kryera në veprimtarinë e dhënë;*
*ë) kontrollin e mjediseve dhe të pajisjeve përkatëse, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e tyre;*

*f) kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë;*

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes:** | Mendimet për leje mjedisi Tipi A/B kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion dhe nuk është kryer verifikimi në terren. |
| **Situata:** | Aplikimet për lejet mjedisore me numër rendor 1, 2,3,4,5,6 ( viti 2020) dhe praktikat me numër rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20 (shqyrtimi i Lejeve Mjedisore gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022), nga auditimi kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion. |
| **Kriteri:** | VKM nr.419, datë 25.06.2014 dhe rregullorja e brendshme e Agjencisë Kombëtare e Mjedisit me nr. 120 prot., datë 12.01.2021 dhe neni 63, pika e, ë, f, e ligjit me nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Si pasojë e mos-shqyrtimit të dokumentacionit për leje mjedisi Tipi A/B, nuk është parandaluar, pakësuar dhe mbajtur nën kontroll ndotja e shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. |
| **Shkaku:** | Moszbatim i legjislacionit në fuqi |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandim:** | Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Kukës, Shkodër të marrë masa që të shqyrtojë aplikimet për Leje mjedisi Tipi A dhe B, në respektim të kritereve dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke përfshirë kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja ligjore e dokumentacionit, si dhe të kryejë verifikimin në terren të instalimit. |

**Konsultimet me publikun**

Në bazë të VKM Nr. 419 , datë 25.06.2014 " Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit , si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL", kreu VI , Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të delegojë ARM për të marrë pjesë në procedurën e konsultimit me publikut. Subjekti kur aplikon për tu pajisur me leje mjedisi Tipi A/B duhet të dorëzojë edhe relacionin e dëgjesës me publikun në Qendrën Kombëtare të Biznesit( QKB) .

Për periudhën 01.09.2020-31.12.2020, Agjencia Rajonale e Mjedisit **Lezhë, Shkodër, Kukës** ka realizuar **19** dëgjesa me publikun.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e konsultimeve si më poshtë;

| Nr. | Subjekti | Aktiviteti | Mangësitë e konstatuara | Delegimi i konsultimit nga AKM | Data e zhvillimit të konsultimit me publikun | Personat përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | D. | Pulari për prodhim mishi | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. Nuk ka autorizim | 21.09.2020 | 28.09.2020, ora 10:00 | B. S., A. M. |
| 2. | G. Sh. | Lyerja dhe lustrimi i makinave | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. Nuk ka autorozim | 17.09.2020 | 24.09.2020, ora 11:00 | B. Sh., A.M. |
| 3. | R. | Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. Nuk ka autorizim | 16.10.2020 | 23.10.2020, ora 9:00 | B. Sh., A. M. |
| 4. | P. G. | Magazinim i hekurishteve/skr | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit | 18.12.2020 | 28.12.2020 | B. Sh., A. M. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | apeve të metalit ose cmontim i | në ëebin e ARM-së. Nuk ka autorizim | | | |

**Viti 2021**

Gjatë vitit 2021, Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës ka realizuar **98** dëgjesa me publikun.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e konsultimeve si më poshtë;

| Nr.rendor | Subjekti | Aktiviteti | Vendndodhja | Data e ardhjes së email nga AKM | Mangësitë e konstatuara | Data e zhvillimit të konsultimit me publikun | Personat përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | A. C. | Përzierja e cimentos ose përdorimi i cimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit , | - | 11.01.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 15.01.2021 ora 10 | B. Sh., A. M. |
| 2. | M. | Rritje intensive e shpendëve në një instalim | - | 03.02.2021 | - | 23.02.2021 ora 11:00 | B. Sh., A. M |
| 3. | D. | Rritje intensive e derrave në një instalim | - | 20.02.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 02.03.2021, ora 11:00 | A. M., A. D. |
| 4. | A.A. | Magazinim i kimikateve | | 10.03.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 16.03.2021, ora 11:00 | B. Sh., A. M. |
| 5. | A.S. | Kërkim zbulim për llojin e materialit krom | | 19.03.2021 | - | 08.04.2021 ora 12 : 00 | B. F. , A. M. |
| 6. | T. T | Ndërtim i Hec Era 1 | | 09.04.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. Nuk ka autorizim | 16.04.2021 | B. Sh., A. M. |
| 7. | M. | Ndërtim Hec | - | 29.02.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së Nuk ka autorizim | 27.05.2021;ora 12:00 | B. Sh., A. M. |
| 8. | E. | Impiant i pasurimit të mineraleve | - | 29.04.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së Nuk ka autorizim | 07.05.2021, ora 11:00 | B. F., Sh. F. (Konc.shkresën B.Sh.) |
| 9. | D.O. | Gaz natyror ose GLN pervec rasteve kur veprimtaria është | Fshati Skuraj, Milot | 21.06.2021 | Nuk ka autorizim | 23.07.2021 ora 10:30 | B.Sh., A. M. |
| 10. | K. C. M. | Impiant i pasurimit të mineraleve | - | 18.06.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. Nuk ka autorizim | 24.06.2021 ora 10:30 | B. Sh., A. M. |
| 11. | F.N. | Thertore. Trajtimi dhe përpunim i materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve | Në fshatin Fushë Mamuras | 21.06.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. Nuk ka autorizim | 29.06.2021 , ora 11 :00 | B. Sh., A. M. |
| 12. | J. | Prodhim dhe fraksionim i produkteve minerare jo metalike | Milot | 28.06.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 08.07.2021 , ora 11 :00 | B. Sh., A. M. |
| 13. | B. 31 | Prodhim dhe fraksionim i produkteve minerare jometalike | Fshati Gajush, Zejmen | 30.06.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. | 09.07.2021 , ora 11:00 | B. Sh., A. M. |
| 14. | B.T. | Gaz natyror ose GLN pervec rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A ose përzierje e aromave. Furnizim me | - | 7.7.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 15.07.2021 , ora 10:00 | B.Sh., A. M. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | karburant i makinave zonat urbane | | | | | |
| 15. | Gj. | Nxjerrja e mineraleve , rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret . | Lezhë, km 6 | 12.07.2021 | - | 29.7.2021 ora 10:00 | B.F.,, A. M. |
| 16. | B. | Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane | Lagjjia Nr.1 | 04.08.2021 | Nuk ka autorizim | 23.08.2021 , ora 11:30 | B. Sh., A. M. |
| 17. | A. | Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike. Ringjyrosje ose rispruсim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre. | Bashkia Vau i Dejës | 16.08.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. Nuk ka autorizim | 24.08.2021 , ora 10:00 | B. Sh., A. M. |
| 18. | V. I. | Shesh për grumbullimin e mineralit të kromit | Bashkia Kukës | 13.09.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. Nuk ka autorizim | 17.09.2021 , ora 11 :00 | B. Sh., A. M. |
| 19. | F. e P. të k. në B. | Shfrytëzim i mineralit të kromit | - | 13.09.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. | 21.09.2021, ora 11:00 | S.M., Sh. F. |
| 20. | M.A. | Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve | | 04.10.2021 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 08.10.2021 ora 10:00 | B.Sh,Sh. F. |

**Viti 2022**

Gjatë vitit 2022, Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë , Kukës ka realizuar **92** dëgjesa me publikun.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e konsultimeve si më poshtë;

| **Nr.rendor** | **Subjekti** | **Aktiviteti** | **Vendndodhja** | **Data e ardhjes së email nga AKM** | **Mangësitë e konstatuara** | **Data e zhvillimit të konsultimit me publikun** | **Personat përgjegjës** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | K. I. | Impiant fraksionimi të inerteve malore dhe prodhim betoni | - | | Mungon autorizimi. Mungon emaili i delegimit nga AKM | 12.1.2022 , ora 12:00 | B. F, S. M. |
| 2. | U. C. | Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane | - | 30.12.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së.Mungon autorizimi | 14.01.2022 ora 12 :00 | A. M., S. M. |
| 3. | A. B. | Gaz natyror ose GLN , përvec rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A ose përzierje të aromave | Fshati Mes, Ura e Mesit Shkodër | 14.01.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. | 26.01.2022 ora 11:00 | A. M. |
| 4. | B. K. 2010 | Shfrytëzim mineral kromi me punime sipërfaqësore | Fshati Vlahen, Bashkia Has | 25.01.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. | 02.02.2022, ora 12:00 | B. F., S. M. |
| 5. | S.A. | Shfrytëzim mineral kromi | Bajram Curri | 07.02.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. Mungon autorizimi | 14.02.2022, ora 11:00 | S. M. Sh. F. |
| 6. | B. | Prodhim i bitumit | Gurorja e Fierzës | 13.2.2022 | Mungon autorizimi | 28.02.2022, ora 12 :00 | B. F., S. M. |
| 7. | G.sh.p.k | Shrytëzim i mineralit të kromit | Fshati Fregen. Njësia | 15.03.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i | 23.03.2022, ora 12 :00 | B. Sh., A.M. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Administrative Ungrej | | publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | | |
| 8. | Gj. | Shfrytëzim i mineralit Gabro | Fshati Gjobardhaj | 23.03.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së. Mungon autorizimi | 29.03.2022, ora 10 | A. N., B. F. |
| 9. | K. | Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zona urbane | - | 29.04.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 10.05.2022, ora 12 :00 | A. M., S. M. |
| 10. | F. | Përpunim, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ | Bashkia Vau i Dejës | 16.05.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 25.05.2022, ora 12 :00 | B. F., A. M. |
| 11. | A. | Gaz natyror aromatik ose GLN , përvec rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A . Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant | - | 7.6.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 14.06.2022, ora 11 | A. M, B. Sh. |
| 12. | P. | Shfrytëzim i mineralit të kromit | Bashkia Has | 29.06.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 08.07.2022 ora 11 :00 | B. F., B. Sh. |
| 13. | P. g. | Shfrytëzim sipërfaqe i mineralit të kromit | Fshati Fusharë, Bashkia Kukës | 15.07.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 22.07.2022, ora 11:00 | B. F., A. M. |
| 14. | E. | Gaz natyror aromatik ose GLN , përvec rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A . Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant | Bashkia Vau i Dejës | 12.09.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 22.09.2022, ora 11:00 | B. Sh.,, Sh. F. |
| 15. | M.C E. G. | Instalim për prodhim hidroenergjie "Ndërtim Hec Gojan" | Njësia Administrative Gjegjan | 06.10.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 13.10.2022, ora 11:00 | B. F., A. M. |
| 16. | R. I. S. | Magazinim , rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose cmontim i mjeteve jashtë përdorimit | Balldre, Lezhë | 14.11.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 18.11.2022 , ora 10 :00 | B. F., A. M. |
| 17. | B. P. | Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme. Përvec rasteve të përmendura në veprimtarinë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce. Prodhim i produkteve prej plastike | Fushë Mamurras | 20.12.2022 | Nuk është plotësuar afati 15 ditor i publikimit të njoftimit në ëebin e ARM-së | 28.12.2022 ora 11:00 | B. Sh., A. M. |

**Çdo praktikë konsultimi me publikun ka bashkëlidhur;**
-akt verifikimin e mbajtur nga ana e specialistëve të ARM Lezhë, Shkodër, Kukës.
Në akt verifikimet e mbajtura nga ana e specialistëve është përshkruar që pjesëmarrësit në konsultimet nuk kanë patur ankesa/shqetësime për instalimin për të cilën është kryer konsultimi.
Njoftimi në faqen e web-it http://drmlezhe.akm.gov.al/faces/konsultimmepublikun.xhtml përmban të dhëna si; data e takimit, subjekti, vendi i takimit.
Nga auditimi u konstatua se konsultimet me publikun janë realizuar në një afat të shkurtër ( 5-7 ditë) nga delegimi i konsultimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

**<u>Konkluzione:</u>**

1.Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas Vendimit Nr. 419, datë 25.6.2014 " Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B

, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e tyre", kreu VI " Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B , pika 10 ; ku përcaktohet se : "*Njoftimi për dëgjesën me publikun shpallet gjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve:*
*c) në tabelën e njoftimeve, në një vend të dukshëm në mjediset e NJQV-së dhe ARM-së së qarkut përkatës*".
Për sa më lart, të gjitha procedurat e konsultimit me publikun janë realizuar në një afat të shkurtër ( 5-7 ditë ) nga delegimi i konsultimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
2. Njoftimi në faqen e ëeb-it http://drmlezhe.akm.gov.al/faces/konsultimmepublikun.xhtml nuk përmban të dhënat e mëposhtme;
-Lloji e instalimit / veprimtarisë;
-Adresa e vendndodhjes së kompanisë, veprime që bien në kundërshtim me Vendimin Nr. 419, datë 25.6.2014 " Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B , për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e tyre" Kreu VI " Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të Tipit A dhe B, pika 11 ku përcaktohet se ;
*Njoftimi duhet të shoqërohet me:*
*a) llojin e instalimit/veprimtarisë;*
*b) emrin e personit fizik/juridik;*
*c) adresën e vendndodhjes së instalimit;*
*ç) vendin ku gjendet kopja e njoftimit në NJQV-në dhe adresën elektronike të AKM-së ku është publikuar njoftimi;*
*dh) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të dëgjesës me publikun.*

**Përsa u trajtua në këtë projekt raport mbajnë përgjegjësi:**
Z. B. F., Drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës
Z. B. Sh., përgjegjës i sektorit të lejeve të mjedisit
Z.A. M., specialist i lejeve mjedisore
Z. Sh.F. , specialist i lejeve mjedisore
Znj.A. D., specialiste e lejeve mjedisore
Z.S. M., specialist i lejeve mjedisore

**Trajtimi i observacioneve**
Me shkresën me nr.504 prot., datë 16.06.2023, protokolluar në KLSH me nr.351/2 prot., datë 16.06.2023, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës ka dërguar observacionet si vijon:

**-Pretendimet e subjektit:**
Lidhur me verifikimin në terren të raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis( VNM) , detyrat funksionale të specialistit ( sipas rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKM dhe ARM-së ) është rishikimi i dokumentacionit mbështetës të kërkesës për lejet mjedisore. Për dhënien e mendimit kemi vijuar me të njëjtën format siç ka qenë më parë , pasi nga organi epror nuk na është vënë në dispozicion një format uniform. Për verifikimin në terren e kemi vlerësuar të ezauruar nëpërmjet dëgjesës me publikun e cila kryhet

në vendin ku zhvillohet veprimtaria. Janë pjesë e procedurës për lejet e mjedisit , që kanë në procedurë dëgjesën me publikun.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Lidhur me pretendimin e pikës 1, pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, sqarojmë se grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë.

Referuar legjislacionit mjedisor, aplikimi për leje mjedisore ndryshon nga një aplikim për VNM. Lidhur me formatin për dhënien e mendimit, formati është i miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 228 prot. datë 03.02.2016, i përcjellë në ARM e qarqeve për zbatim , ku pika 6, përcakton se verifikimi të bëhet në terren dhe jo nga dosja që vjen elektronikisht.

**-Pretendimet e subjektit:**

Lidhur me dhënien e mendimit për lejet mjedisore të Tipit A dhe B, mendimi ynë nuk është themelor , pasi procedura vazhdon , pavarësisht dhënies apo jo të mendimit të ARM dhe nuk prodhojmë akt administrativ , për këtë arsye analizimi i dosjeve nga ana jonë i është përmbajtur pikave të modelit që na është dërguar dhe mendimi ynë ka patur të bëjë me ndikim në mjedis të veprimtarisë. Verifikimin në terren e kemi vlerësuar të ezauruar nëpërmjet dëgjesës me publikun e cila kryhet në vendin ku zhvillohet veprimtaria.

**Qëndrimi i grupit të auditimit**:

Lidhur me pretendimin e pikës 2, pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, sqarojmë se grupi i auditimit e merr pjesërisht në konsideratë, duke bërë edhe ndryshimet përkatëse. Theksojmë se, sipas rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, detyrat e specialistit të lejeve mjedisore ( faqja 127) , pika 1 dhe 3 janë:

-*Rishikim i dokumentacionit mbështetës të kërkesës për leje mjedisore;*

-*Kërkon informacion shtesë nëse del e nevojshme gjatë shqyrtimit të aplikimit .*

Ndërsa përsa i përket ezaurimit të verifikimit në terren nëpërmjet dëgjesës me publikun sqarojmë se;

Relacioni i dëgjesës me publikun realizohet sipas pikës 12, kreu VI, të VKM Nr. 419 , datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri , të kushteve për lejet respektive të mjedisit , si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL", ndërsa verifikimi në terren për subjektin përfshin: vlerësimin e operacioneve të kryera në veprimtarinë e dhënë, kontrollin e mjediseve dhe të pajisjeve, kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë etj.

**-Pretendimet e subjektit:**

Lidhur me afatet e realizimit të dëgjesës me publikun, kemi vepruar sipas VKM nr.419 datë, 25.06.2014.

**Qëndrimi i grupit të auditimit**:

3.Lidhur me pretendimin e pikës 3, pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, sqarojmë se grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë.

Referuar VNM nr.419 datë 25.06.2014 , kreu VI , pika 10 përcakton se :

*Njoftimi për dëgjesës me publikun shpallet gjatë 15 ditëve në mjediset e ARM të qarkut.*

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes:** | Caktimi i datës dhe publikimi në ëeb i njoftimeve për dëgjesat me publikun |
| **Situata:** | Në praktikat me numër rendor: 1,2,3,4 (viti 2020), 1, 3,4,6,7,8,10,11,12,13,14,17,18,19,20(viti 2021) , |

| | |
|---|---|
| | 2,3,4,5,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17 ( viti 2022) konsultimet janë realizuar në një afat 5-7 afat të delegimit të e-mailit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit |
| **Kriteri:** | VKM Nr.419 , datë 25.06.2014 "kreu i VI "Informimi i publikut" |
| **Ndikimi/Efekti:** | Pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjesën me publikun ka qenë e ulët. |
| **Shkaku:** | Moszbatim i legjislacionit në fuqi |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandim:** | Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të marrë masa që njoftimi i dëgjesës me publikun të qëndrojë i publikuar në web-in zyrtar përgjatë afatit 15 ditor, për qëllim njoftimin, sensibilizimin dhe informimin e sa më shumë pjesëmarrësve në takim. |

**2. 5. Auditimi i planeve të inspektimit , programeve mujore të miratuara nga IQ, dhe Ministria e Mjedisit dhe Turizmit**

Për auditimin e pikës 5 u **shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:**

**1.Planet mujore dhe vjetore,** për periudhën 4/mujori i dytë 2020 viti 2021 dhe vitin 2022 ku përfshihen.

**2.**Programet mujore të miratuar nga Drejtori i ARM-së dhe programet vjetore të miratuara nga Inspektorati Qëndror dhe Ministri i Mjedisit dhe Turizmit.

**3.**Raportet mujore e raportet vjetore të Sektorit të inspektimit të Mjedisit dhe Sektorit të Inspektimit të Ujerave.

**4**.Autorizimet, Procesverbalet e inspektimit, korrespondenca zyrtare me institucionet e tjera, evidencat e mbajtura për vendimet administrative, për inspektimet e kryera dhe dëmet e konstatuara.

-Mbi bazën e praktikave u hartuan tabelat me te dhënat si: autorizimet, subjektet dhe aktiviteti që kryen, problematikat e konstatuara, leje mjedisore ,ri-inspektimet, konstatimet si dhe vendimet administrative.

Sektori i inspektimit mjedisor ka në përbërje të tij një përgjegjës dhe 10 inspektorë dhe sektori i ujerave 1 përgjegjës dhe tre specialistë.

-Për periudhën objekt auditimi / mujori i dytë 2020, 2021 dhe vitin 2022 nga Sektori i Mjedisit janë hartuar dhe janë miratuar plane pune nga Drejtori AKM-së, për vitin 2022 në nga ***Inspektorati Qendror Tiranë***.

Referuar situatës problematike të krijuar nga përhapja e infeksionit nga Covid 19, Sektori i Inspektimit në Mjedis ka filluar kontrollet në terren për zbatueshmërinë e kushteve të lejeve mjedisore dhe legjislacionit mjedisor në fuqi në muajin shtator ,tetor 2020, referuar Planit Vjetor të Monitorimit, miratuar nga titullari i institucionit.

-Për periudhën objekt auditimi

**Viti 2020** Inspektimet on-line për sektorin e Mjedisit kanë filluar në muajin Shtator të vitit 2020 dhe muajin tetor, mbas këtij muaji janë janë ndërprerë inspektimet me urdhrin nr.28 datë 21.10.2020, të Kryeinspektorit të Përgjithshëm për sensibilizimin e qytetarëve për masat anti covid. Kjo situatë ka vazhduar për deri në funde të vitit 2020.

**Vitin 2021**-Për vitin 2021 Inspektimet kanë filluar me program mujore në Qershor të vitit 2021 ose rreth 1 vite me vonesë, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Urdhrin nr.284, datë 03.05.2017, të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line"; Për 6-mujorin e dytë Qershor-Dhjetor 2021 janë kryer inspektime nga ku rezultoi se programet janë hartuar në mungesë të treguesit sasior.

Në vitin 2020 planet e inspektimeve nuk janë protokolluar, nuk janë nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit te Mjedisit, si dhe titullari i institucionit, por janë përcjellë nëpërmes e-mail-it.
Janë hedhur në portalin o-nline te inspektimeve autorizime në çdo rast.
**Viti 2022** Inspektimet on-line për sektorin e Mjedisi, janë kryer vetëm dy muajt e fundit të vitit 2022, pasi nuk janë miratuar në asnjë muaj planet nga AKM.
Janë hartuar plane mujore të inspektimit por jo të mbështetura në metodologjinë e vlerësimit të riskut duke përcaktuar numrin e akteve të inspektimit dhe subjektet e inspektimit, si dhe të krijojë bazë të dhënash të plota të subjekteve, të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis, mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore te inspektimit. Për vitin 2020-2022. Janë përcaktuar dhe tematikat e inspektimeve por nuk është përcaktuar treguesi sasior i inspektimeve, kjo parashikuar në nenin 4 të urdhrit nr 5 datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë për programimin e inspektimeve" Nuk është kryer analizimi mujore mbi realizimin e inspektimeve sanksionet e vendosura të cilat duhen dërguar brenda dt. 5 të çdo muaji në DIK si dhe brenda dt 20 në Ministri dhe IQ.

a. Nga Drejtori dhe përgjegjësit e sektorit të Mjedisit dhe Ujërave nuk është bërë analiza për numrin e inspektimeve si rrjedhojë këtyre veprimeve.
b. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se:

**1.** ARM Kukës, Lezhë, Shkodër nuk disponon një data bazë për gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në Qarkun Lezhë të plotësuara me të dhënat si: licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetit, lejet mjedisore etj. Janë bërë përpjekje për marrje të këtij informacioni nga Faqja zyrtare në internet e Qendrës Kombëtare të Biznesit , i cili nuk jep informacion të plotë në lidhje me aktivitetin që ushtron subjekti aktualisht nga gjithë veprimtaritë e regjistruara, adresat si dhe licencat që disponon subjekti. Gjithashtu nuk është bërë e mundur të kryhet korrespondence zyrtare me DRT Lezhë, për informacion më të detajuar. Për këtë arsye programet vjetore nuk i kanë shërbyer në masë të plotë realizimit të objektivave të institucionit për identifikimin e subjekteve pa leje mjedisore.
-Sektori i Inspektimit Mjedisit dhe Ujërave nuk ka krijuar dosje të përhershme të inspektimit për çdo subjekt të inspektuar kërkesë kjo e Urdhrit të Inspektoratit Qendror Nr.13datë 23.04.2015"Për miratimin e manualit të përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë" si dhe portalit unik e-Inspektimi", kreut III urdhrit nr.432, datë 28.9.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr.15/2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit e-Inspektimi";
**2.** ARM Lezhë ,Kukës Shkodër, nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut të subjekteve që do të inspektohen, me qëllim përcaktimin e subjekteve që kanë risk më të lartë dhe frekuencën e inspektimit gjatë një viti;
-Kujdes i shtuar duhet bërë në dokumentimin dhe evidentimin e punës inspektuese. Sipas kërkesave të manualit të inspektimit, sektorët e inspektimit duhet të mbajnë një dosje të përhershme për çdo subjekt, dosje të cilës i referohet për çdo inspektim që do të kryhet, e cila duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo inspektimi me qëllim që të sigurohet përditësimi i përmbajtjes së saj. E cila është edhe pjesë e sistemit elektronik "e-inspektimi", ***e cila jo në çdo ratë është plotësuar nga Inspektorët, për inspektimet që kanë kryer në terren.***
**3.**Në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Kukës, Shkodër janë relacionet, raportet e realizimit të inspektimeve, nga Sektorët Mjedisit Ujërave, ku nga raportimet mujore konstatojmë se kryesisht treguesit janë raportuar vetëm në nivelin faktik dhe jo të tabeluar e krahasuar me treguesit e parashikuar në Planet vjetore (pasi edhe planet vjetore mungojnë),me

ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë“, nenin 7 dhe neni 16 ”Misioni dhe Funksionet e Inspektoratit Qendror” pika 2 germat “b” dhe “c” dhe me VKM nr. 568 datë, 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim te Urdhrit të Kryeministrit nr.23, datë 03.02.2020 "Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" *Parashikimi dhe realizimi i numrit të inspektimeve për 6/mujorin e dytë 2020 ,2021dhe vitin 2022.*

**4.** Në inspektimet e kryera në terren, për plotësimin e procesverbalit të inspektimit nuk është i gjithë informacionin i nevojshëm duke u bazuar në kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti dhe zbatimin e secilit prej kushteve, si dhe të të gjitha mangësive të konstatuara nga ushtrimi i aktivitetit, sipas inspektimit në terren nga ana e inspektorëve, nuk ka përshkrime specifike mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore dhe kryerjen e dërgimin e vetë monitorimeve. Detyrat që lihen nuk janë të lidhura me konstatimet konkrete të situatës në terren të kryera nga specialistë të fushës së mjedisit. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 3, neni 45, ligji nr.10433, datë 16.06.2011 Neni 45, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

**5.** Përzgjedhja e subjekteve për tu inspektuar nuk kryhet sipas rëndësisë së tyre dhe sipas ndikimit që mund të kenë në mjedis, pasi nuk kanë një listë subjekteve të pajisura me leje mjedisore, nga praktikat e përzgjedhura subjektet janë me ndikim të ulët ose të mesëm në mjedis. Veprime që bien në kundërshtim me udhëzimit nr.5 datë 19.02.2015“Rregullat e përgjithshme mbi bazë programimi” i ndryshuar.

-Sektori i Inspektimit mjedisit në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Kukës Shkodër , nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të llastuara sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun Lezhë, Kukës, Shkodër, mbështetur në këto të dhëna të bëhej identifikimi i subjekteve dhe veçimi i atyre me risk të lartë e ndikim në mjedis. Kjo në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhrat e Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015 *"Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë"* dhe nr.6 datë 19.02.2015*"Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.*

**6.** Në shume raste inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet, se nuk gjendet në adresën e dhëne, ose nuk kryen aktivitet .Këto mangësi dhe pasaktësi të konstatuara në kryerjen e inspektimeve janë në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit ”dhe me ligjin nr.10433 .

-Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së ,nuk është zbatuar neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi” të ligjit nr. 10431,datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera.

Në formularin e Inspektimit, në paragrafin I “Të dhënat të përgjithshme të subjektit”, në pika 3“Lloji i aktivitetit ekonomik” gjëndërohet nga sistemi e plotësuar me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet.

-Nga Inspektorët nuk janë kryer në çdo rast veprimet sipas urdhrit nr.26 datë 07.03.2017,”Formati Standard I vërtetësisë së Inspektimit” kap III pika 3,6.

**7.** Në formatin e procesverbalit të inspektimit, në paragrafin 7“Gjetje të konstatuara” jo në çdo shënohen shkeljet por citohet vetëm si gjetjet, këto janë shkelje të neneve të caktuar ligjorë, të cilët përmenden në vijim të procesverbaleve.

**Sektori i inspektimit të Mjedisit periudha Shtator- Dhjetor 2020, 2021, 2022 sektori i mjedisit.**

Me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale nr.156 datë 10.03.2020"Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19",dhe urdhrit të Kryeinspektorit të Përgjithshëm nr.28 datë 21.10.2020"Për bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokolleve të sigurisë në kuadër të tas forcës , anticovid-19, pika 1 e urdhrit të sipërcituar, janë ndërprere inspektimet në terren .

-Për 4/ mujorin e fundit të vitit 2020 është hartuar dhe miratuar plani nga Drejtori i ARM –së, për dy muaj e përkatësisht për muajin shtator tetor 2020, janë planifikuar 56 subjekte dhe realizuar 33 subjekte. Për muajin shtator është realizuar i gjithë plani.

-ndërsa në muajin tetor janë anuluar pasi janë hedhur në sistem 23 inspektime.

Nuk ka një dokument, apo urdhër nga Drejtori i AKM,-së, për anulimin e inspektimeve, pasi ashtu siç miratohen nga AKM, në raste të pezullimi duhej dhe pezullimi.

Na është vënë në dispozicion për këtë rast një relacion, nga J. Sh. përgjegjëse sektorit të mjedisit e komanduar dhe miratuar nga Drejtori i ARM –së, B. F. në të cilën përshkruhet se janë realizuar vetëm 5 inspektime nga të cilat 2 janë konstatuar me shkelje ndërsa për 23 inspektimet nuk është dhënë asnjë shpjegim, arsyet përse nuk janë realizuar inspektimet këto veprime bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, date 16.6.2011'' Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë'' kreu IV rregulla të përgjithshme për programimin dhe autorizimin e inspektim konkretisht Neni 29 pika 3. Shtyrja bëhet me propozim të inspektorit dhe me vendim të nëpunësit përgjegjës për lëshimin e autorizimit. Vendimi i njoftohet subjektit të inspektimit përpara skadimit të kohëzgjatjes dhe nuk mund të ankimohet veçmas. këto veprime bëjnë përgjegjës titullarin e institucionit**.**

-Vitin 2021 inspektimet kanë filluar në korrik –dhjetor 2021, pasi deri në këtë muaj nuk janë miratuar programet e punës nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

-Për këtë vitin janë planifikuar 189 inspektime nga ARM Lezhe dhe janë miratuar nga Drejtori I AKM –se, 184 inspektime nga të cilat janë realizuar 178 inspektime nuk është realizuar I gjithë plani.

Për vitin 2022, në muajin shkurt me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm janë hartuar programe pune për inspektimin e guroreve, miniera me qiell të hapur për 45 subjekte . **Përkatësisht Shkurt- Prill 2022 në bazë të urdhrin nr.25 datë 07.02.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtarë të Mjedisit , janë kryer inspektime dhe ngritjen e grupeve të punës për zbatimin dhe evadimin e problematikave, guroreve, karriere rërës dhe argjilës** për 45 subjekte .

Drejtori i ARM së Lezhë, në bazë të urdhrit te DP ka hartuar autorizime me grupet e punës për verifikimin në terren të subjekteve. Nga inspektimet e kryera në 15 raste janë konstatuar shkelje të kushteve të lejeve mjedisore ndaj të cilës janë marre masa administrative me gjobë trajtuar në material, ndërsa ;

Në 7 raste nuk është realizuar inspektimi për arsye të kushteve atmosferike përkatësisht në Subjektin"R."sh.p.k,"A.","N.&ch."sh.p.k,"V.D.I. e." sh.p.k, B. sh.p.k, M.shp.k."M. F. N.,"M. Xh. 2."A., "M.F. N." sh.p.k

**Në 6 raste nuk është lejuar inspektime në subjekte dhe janë marrë masa administrative me gjobë, ndaj subjekteve .**

Si dhe janë kryer inspektime për 3 muaj me urdhër të Drejtoritë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit , muaji tetor-nëntor 2022 referuar planeve mujor miratuar nga titullari i institucionit.

**I - 4/mujori I vitit 2020**

**1-Nga auditimi me zgjedhje për 23 praktika të hedhura në sistem rezultuan pa rregulluesi në 4 praktika, ku janë konstatuar se subjektet nuk ushtrojnë aktivitet, praktika këto të paraqitura në tabele përmbledhëse.**

<u>Viti 2021</u>

**2-Nga auditimi me zgjedhje për 67 dosje rezultuan:**

**në 9 dosje nuk është i plotë dokumentacioni në sitëm.**

**në 22 raste subjektet nuk kryejnë aktivitet /të mbyllura të paraqitura në tabelë.**

Rastet te cilat nuk kanë gjithë dokumentacion ne sistem.

**1. Me Listë verifikim Nr. AKM-LE-2021**-000225 - 2/1 Datë: 04/11/2021, Emri i Subjektit M. Lloji i aktivitetit ekonomik ‘‘**Industria minerare’’** Inspektuar nga **J. Sh. B. L.,** në ceke liste citohet se Referuar Planit të Menaxhimit të mbetjeve , si pjesë Raportit Vjetor të Mjedisit, janë zbatuar kushtet e lejes.

**Në sistem Mungon:**1) Tarifën vjetore për Lejen e Mjedisit 2)Raportin 6 mujor të monitorimit 3) Raportin vjetor të mjedisit 4) Planin e menaxhimit të mbetjeve, regjistri I shkarkimit, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 10448, date 14.7.2011“ Për lejet e mjedisit” I ndryshuar, neni 29, **në këto kushte ndaj subjektit duhej marrë masë administrative me gjobë nga 300,000 mije deri në 500,000 mijë lekë.**

**2. Me listë verifikim nr.** Nr. AKM-LE-2021-000224 - 2/1 Datë: 05/11/2021 ,Emri i Subjektit S.U. Lloji i aktivitetit ekonomik ‘*’Menaxhimi i mbetjeve’’*, **inspektuar nga J. Sh. dhe B. L.,** në ce-ke listë janë plotësuar dy rubrika , në proces verbal pika 7‘’Gjetje konstatuara’’. Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i ruajnë dokumentet e transferimit për një periudhë kohe prej të paktën 2 vjetësh, ndaj dokumentacioni qe ai zotëronte ishte vetëm një kontrate me Landfillin e Bushatit në mënyre që aty të transferonte një kategori mbetjesh në rast nevoje dhe vendim përfundimtare nuk janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore.

**Në sistem Mungon**; **dokumentacioni shoqërues, në sistem**

-raporti i vetmonitorimit

-shkresë informuese drejtuar AKM-së, për mbyllje të aktivitetit

<u>-subjekti ka përfunduar kontratën e grumbullimit të mbetjeve te rrezikshme në datë 30 prill 2020</u>.

-mungon regjistri I transferimit të mbetjeve, **veprime që bien në kundërshtim me** neni 61 pika 10,19,20 Ligji nr. 10463 dt.22.09.2011“Për Transferimin e mbetjeve të rrezikshme”. Ligji nr.10433 dt.16.06.2011"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", **në këto kushte ndaj subjektit duhej marrë masë administrative me gjobë 1,000,000 lekë.**

**3.Me listë verifikim** Nr. AKM-LE-2021-000010 - 2/1 Datë:18/06/2021, Emri i Subjektit L. Gj., Lloji i aktivitetit ekonomik “*Prodhime te ndryshme betoni, hekuri*”ndërsa leja mjedisore dhe inspektime është bërë për veprimtarin **‘’përpunim dhe trajtim qumështi’’ Inspektuar nga J. Sh., N. D.**, në liste verifikimi citohet se subjekti është mbajtës i një leje te tipit C me PN-9595- 03-2015, është kontrolluar në kuadër të ndryshimeve ligjore të ndodhura në shtojcën Nr.1 të ligjit për lejet e mjedisit, nga ku na rezulton që nuk kemi shkelje të kërkesave ligjore apo kushteve të lejes dhe gjithashtu konkludojme që ky subjekt nuk i plotëson kriteret për tu pajisur me leje te tipit B, në baze të verifikimeve të bëra gjatë inspektimit dhe deklarimeve të bëra nga vete subjekti. Bashkëlidhur ndodhet shkresa e subjektit, për sasinë e qumështit .

**Në sistem mungon:**

**-** Faturat e shitjes ndaj subjektit që vërteton se subjekti nuk kalon kapacitete për të kaluar në leje te tipit B, , veprime ne kundërshtim me ligjin Nr. 52/2020 “Për Lejet e Mjedisit”, të

ndryshuar, ndaj subjektit **duhet të ishte marre masë administrative me gjobe në vlerën 300,000-500,000 lekë.**

**4. Me listë verifikim** Nr. AKM-LE-2021-000220 - 2/1 Datë: 09/11/.2021 Emri i Subjektit **B.**, Lloji i aktivitetit ekonomik "*Menaxhimi i mbetjeve*'' **inspektuar J. Sh. dhe B. L..** Në cek-liste citohet, u konstatua që; Subjekti ka zbatuar kushtet e licencës se kategorisë III.2.B, me ID 105, datë 03.02.2014. Subjekti është i pajisur me kontrate shërbimi me Bashkinë Kurbin, Kontrate me V. R., si dhe i pajisur me dokumentet e transferimit te mbetjeve jo të rrezikshme dhe me regjistrin e mbetjeve. Nga inspektimi në vend ne subjektin " B." Për Lejet e Mjedisit", " , u konstatua qe: Subjekti ka zbatuar kushtet e licencës se kategorisë III.2.B, me ID 105, date 03.02.2014. Subjekti është i pajisur me kontrate shërbimi me Bashkinë Kurbin, Kontrate me V.R., si dhe i pajisur me dokumentet e transferimit te mbetjeve jo të rrezikshme dhe me regjistrin e mbetjeve ne sistem **është bashkëlidhur leja e tipit c, sipas ligjit** Nr. 52/2020 për disa ndryshime në ligjin nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar.
**Në sistem Mungon**;
-dokumentet e transferimit te mbetjeve jo të rrezikshme dhe me regjistrin e mbetjeve., të paraqitura pranë AKM –së, veprime në kundërshtim **me ligjin** Nr. 52/2020 "Për Lejet e Mjedisit", për disa ndryshim, në këto kushte ndaj subjektit **duhet të ishte marre masë administrative me gjobe në vlerën 300,000-500,000 lekë.**

**5. Me Listë verifikim për m**jedisin Nr. AKM-LE-2021-000221 Datë: 12/11/2021 Qarku: Lezhe Emri i Subjektit "**L. 2.**" Lloji i aktivitetit ekonomik "*Menaxhimi i mbetjeve''* inspektuar nga **J. Sh. dhe B. L., citohet se;** subjekti ka plotësuar dokumentacionin; Regjistrin e mbetjeve tetor 2021, Si dhe me dokumentet e transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme. Në proces verbal dhe vendim përfundimtarë ndaj subjektit nuk është marrë masë administrative, shkelje të kushteve te licencës se kategorisë III.2.B, me nr .prot 1694 date 02.08.2017, *pika d, në të cilën theksohet se subjekti duhet te regjistrojë sasinë e mbetjeve që grumbullon dhe transporton ne çdo 6-muaj pranë ARM-së përkatëse* inspektuar nga
**Në sistem Mungon**;
- regjistri i mbetjeve pa nr datë si dhe i pa firmosur nga subjekti, regjistri i mbetjeve pa nr. Prot datë,i paraqitur vetëm për një muaj, ky regjistër duhet te paraqitje pranë AKM së , veprime që bien në kundërshtim me ***nr***.10 463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve' **Neni 21 Përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve si dhe neni 62 pika 6, n**ë këto kushte ndaj subjektit duhej marrë masë administrative **me gjobë 1,000,000 lekë.**

**6.Me listë verifikim** Nr. AKM-LE-2020-000079 - 1 Datë: 23/10/2021 Të dhëna mbi subjektin e inspektimit: Emri i subjektit: "I.N. N. F." NIPT: K..." IN., Lezhe, grupi I auditimit **P. F., N.H.,** në liste verifikim janë plotësuar 2 rubrika, ku janë shprehur se subjekti plotëson kushtin e lejes sipas Ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, neni 31/39, zbatuar, referuar kushti 7.1. shkarkimet në ajër, në procesverbal dhe vendim përfundimtarë nuk janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore ndaj subjektit në sistem bashkëlidhur nuk ndodhet asnjë dokumentacion justifikues.
**Në sistem Mungon**;
-Tarifa vjetore,
- Mungon dokumenti sipas kushti 7.1. shkarkimet në ajër?
-raporti I vetë monitorimit i dorëzuar pranë AKM së.
-Raporti I vetë monitorimit,

Veprimet në kundërshtim me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit". Neni 44 Detyrimet e operatorit e përputhshmërisë, si dhe në veprime në kundërshtim me ligjin 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", me nenin 19 "Vetë monitorimi".
**Në këto kushte ndaj subjektit duhej marrë masë administrative me gjobë minimale 300, 000-500,000 lekë.**

**7.Me listë verifikim** nr.AKM-LE-2021-000029-2/1Datë:14/06/2021,emri i Subjektit c. a. SHPK Lloji i aktivitetit ekonomik "*Miniera Kariera".* Inspektuar nga ***P.F. B.L..***
**Në sistem Mungon**;
-gjithë dokumentacioni, shoqërues
-shkresa përcjellëse
Dokumentacioni pa nr.dt të protokolluar pranë AKM –së veprime në kundërshtim me *Ligjin10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit",* më nenin 19 "Vetë monitorimi" dhe neni 29, në këto kushte ndaj subjektit duhej marrë masë administrative, **në këto kushte ndaj subjektit duhej marrë masë administrative me gjobe minimale 300,000-500,000 lekë**.

**8. Me listë verifikim** Nr. AKM-LE-2021-000229 - 2/1 Datë: 15/11/2021 Emri i Subjektit U.. Lloji i aktivitetit ekonomik'' Menaxhimi i mbetjeve'' inspektuar nga **P.F., K. U., në çek listë.** Nga inspektimi në vend në Subjektin " me LN-7482-06-2019, Nr.ID 333,u konstatua se subjekti nuk ushtronte aktivitet: " Transportim i mbetjeve inerte". Subjekti nuk kishte asnjë kontrate aktive me ente shtetërore apo subjekte private në lidhje me ushtrimin e aktivitetit .
**Në sistem mungon** ;
- raportim pranë AKM-së, siç është përcaktuar në licencë brenda çdo 6-mujori, duhet të raportojë pranë AKM –së, **veprime në kundërshtim me** Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", me nenin 19 "Vetë monitorimi",29.**në këto kushte ndaj subjektit duhej marre masë administrative minimale 300,000 -500,000 lekë .**
*Në 8 praktikat e trajtuara më lartë, rezultoi se në sistemin online të inspektimeve, nuk janë bashkëlidhur i gjithë dokumentacioni, shoqërues dhe vërtetues, si rezultat i këtyre veprimeve nuk është marrë masa administrative gjobë në kundërshtim me Ligjin nr.10488 datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" Neni 29 Kundërvajtjet për lejet e mjedisit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë; ligji nr.10463, date 22.09.2011"Për Menaxhimin e Integruar te mbetjeve "neni 17/19/21/22/23, gjoba 1,000,000 lekë si dhe Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", me nenin 19 "Vetë monitorimi",29.*
**1*1,000,000 = 1,000,000 lekë,**
**1*500,000 = 500,000 lekë,**
**6* 300,000 = 1,800,000 lekë,**
**3,300,000 lekë, vlerë kjo që konsiderohet e ardhur e mungur në buxhetit e shtetit,**

***Viti 2022, Nga auditimi i 56 praktikave në sistem rezultoi se në 13 raste kishte pa rregullësi në dokumentacion*** **bashkëlidhur sistemit online të Inspektimit ,trajtuar si më poshtë .**
**1. Me listë verifikim** nr. akm-le-2022-000050-2/1, datë 18/03/2022 emri i subjektit A., Lloji i aktivitetit ekonomik "Industria minerare "inspektuar nga **P. F., E. Gj.,** në komente shprehen se subjekti ka lejen e pezulluar. Por nuk ka dokumentin bashkëlidhur. Në vendim përfundimtar për këto shkelje nuk është marrë masë ndaj subjektit , sipas Ligjit nr.10433, datë 16.06.201"i ndryshuar, detyrimet e subjektit të inspektimit:

**Në sistem mungon;**
- shkresa për pezullim të aktiviteti nga Ministria e Mjedisit,
-revokimi i lejes mjedisore siç dhe janë shprehur në një rubrikë,
a) të caktojë një përfaqësues për të komunikuar me inspektorin gjatë inspektimit, në rast se nuk dëshiron të komunikojë drejtpërdrejt me inspektorin;
b) të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektimit, në këto kushte ndaj subjektit duhej **marrë masë administrative me gjobë nga 300,000** lekë.

**2. Me listë verifikim** Nr. AKM-LE-2022-000025 - 2/1 Datë: 28/02/2022 Lloji i aktivitetit ekonomik"' ***Industria minerare'',*****T. A. C.** inspektuar nga ***P. F. B. L.,*** në cek liste theksohet se *;* u konstatua qe subjekti nuk ushtron aktivitetin në subjekt nuk kishte mjete pune dhe sipërfaqja dukshëm nuk ishte shfrytëzuar. Kjo vërtetohet edhe nga fotot e bëra në vendndodhjen e subjektit, si dhe nga kontakti me përfaqësuesin e subjektit.
**Në sistem mungon;**
-raporti i vetë monitorimit,
-shkresë informuese pranë AKM së, për mbyllje të aktivitetit, foto **etj...**veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, neni 29/. **Në këto kushte ndaj subjekti duhej marrë masë administrativë me gjobe 300,000-500,000 lekë .**

**3.Me listë verifikim** Nr.AKM-LE-2022-000028-2/1Datë:02/03/2022,të dhëna të përgjithshme të subjektit, emri i subjektit A. – K.. Lloji i aktivitetit ekonomik "Industria minerare" inspektuar nga **P. F., B. L., në liste verifikim nuk janë plotësuar të gjitha rubrikat** bashkëlidhur nuk ka dokumentacion veprime ne kundërshtim me Ligjin nr.10433 datë 16.6.2011 "Inspektimit në Republikën e Shqipërisë" Neni 39 Marrja e kopjeve dhe sekuestrimi i dokumenteve", si dhe neni 41,në procesverbal dhe vendim përfundimtarë nuk janë konstatuar shkeljet kërkesave ligjore.
**Në sistem mungon;**
Planin e menaxhimit të mbetjeve, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar te mbetjeve" neni 21, 62, **në këto kushte ndaj subjektit duhej marrë masë administrative me gjobë 1,000,000 lekë.**

**4. Me listë verifikim** Nr. AKM-LE-2022-000038 - 2/1 Datë: 10/03/2022,Emri i Subjektit I. M. I. Lloji i aktivitetit ekonomik "Industria minerare" inspektuar nga **Sh. C., N.D..** Kontrata e mbetjeve është për periudhën 14.09.2020 deri në 14.09.2021 ndërsa inspektimi është kryer në datë 15.10.2021, kontrata ka përfunduar në kohën e kryerjes së inspektimit, veprime në kundërshtim Ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011"Për menaxhimin e integruar te mbetjeve "neni 17,veprime në kundërshtim me ligjin në kundërshtim me Neni 61 pika 10,19,20
**Në sistem mungon;**
-regjistri për transferimin mbetjeve nga Instalimi, **ndaj subjektit duhej marrë masë administrative me gjobë 300,000-500,000 lekë.**

**5. Me listë verifikim** Nr.AKM-LE-2022-000013-2/1Datë:18/02/2022 Qarku: Kukës Subjekt i inspektuar Emri i Subjektit "G.", Lloji i aktivitetit ekonomik ''Industria minerare'' Kukës inspektuar nga **P. F., E. Gj. , liste verifikimi i plotësuar në të gjitha rubrikat.**

**Bashkëlidhur** i gjithë dokumentacioni, por në asnjë nga dokumentet e paraqitur në sistem nuk është i protokolluar në Agjencinë Kombëtarë të Mjedisit , në këto kushte ndaj subjektit për shkelje duhej marre mase administrative **gjithë në vlerë 300,000-500,000 lekë .**

**6. Me listë verifikim** Nr. AKM-LE-2022-000068 - 2/1 Datë: 21/10/2022 Subjektit R.. Lloji i aktivitetit ekonomik‘’ Industria minerare’’ inspektuar **nga J. Sh. B. L., janë** plotësuar te gjitha rubrikat , në sistem janë hedhur materialet përkatëse.
**Në sistem mungon;**
-raporti i monitorimit
-raporti i vetë monitorimit është pa nënshkrim dhe pa vulë të studios mjedisore, gjithashtu subjekti nuk ka një kontratë sipas kusht 8.1 Plani i menaxhimit te Mbetjeve i cili dorëzohet çdo gjashtë muaj.
- kontratë me Njësitë e Qeverisjes Vendore për vende grumbullimi.
-fature që paguan rregullisht taksen vjetore të pastrimit pranë NJQV, veprime në kundërshtim me me ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011"Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve’’ **në këto kushte duhej marre masë administrative me gjobë 300,000-500,000 lekë.**

**7. Me listë verifikim** për mjedisin Nr. AKM-LE-2022-000120 - 2/1 Datë: 03,02,2022.Lloji i aktivitetit ekonomik “**Blegtoria”,** inspektorët **Sh. C., J. Sh. dhe B. L.,** në liste nuk janë plotësuar të gjitha rubrikat , por në një komente është cituar se subjekti është ne kundërshtim me nenin 36, pika b), te ligjit 10433 date 16.06.2011 " Për Inspektimin ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Në vendim përfundimtare kanë lenë mase administrative “paralajmërim” .
**Në sistem** janë hedhur dokumentacioni shoqërues, por jo i plote pasi :
**Në sistem mungon;**
-Shkarkimit dhe transferimit të ndotësve referuar vkm nr 742 datë 09,09,2015“Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit e transferimin e ndotësve”, nuk është protokolluar pranë AKM –së,
-Plani i menaxhimit të mbetjeve është pa nr prot pranë AKM –së
-Raporti i vetë monitorimit për 6 mujorin e parë 2022, pa nr. prot pranë AKM –së, veprimet janë në kundërshtim me ligjin nr, 162/2014 për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis 1 neni 20 kundërvajtjet i) për lejet e mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në **vlerën 300,000 -500,000 lekë.**

**8. Me listë verifikim** Nr. AKM-LE-2022-000016 - 2/1 Datë: 21/02/2022. Emri i Subjektit S.-A.. Lloji i aktivitetit ekonomik “Industria minerare’’. **P. F.,E. Gj., B.L., në** cek listë është cituar se subjekti i plotëson të gjitha kushtet e lejes.
**Në sistem mungon:**
**Raporti vjetor i monitorimit veprime në kundërshtim me ligjin për në këto kushte ndaj subjektit duhej marre masë 300,000-500,000 lekë.**

**9. Me listë verifikim** nr. AKM-LE-2022-000026-2/1 Datë:03/03/2022 Emri i Subjektit Ll. Lloji i aktivitetit ekonomik ‘***’Industria minerare’’ inspektuar nga*** **P. F. B. L., ne ceke liste shprehen se subjekti ka realizuar të gjitha kushtet e lejes dokumentacion shprehen se;** Subjekti ka mbajtur Regjistrin e Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotësve dhe raportuar ne AKM, sipas Ligji nr. 10448, date 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” I ndryshuar, neni 29/.

**Mungon në sistem ;** Regjistrin e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve i pa raportuar në AKM, mos zbatim të kushteve të lejes në këto kushte ndaj **marre masë 300,000-500,000 lekë.**

**10. Me listë verifikim** nr Nr. AKM-LE-2022-000118 - 2/1 Datë: 15/11/2022,Emri i Subjektit C. A. shpk. Lloji i aktivitetit ekonomik ''Industria minerare'' inspektuar nga **J. Sh. , B. L. në ceke listë janë plotësuar të gjitha rubrikat, në 4 kushte të lejes janë shprehur se subjekti nuk vepron në përputhje me** Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë se ajrit ne mjedis", neni 13/14/15/2020,Bazuar në raportin e vete monitorimit për periudhën 20 korrik-20 tetor 2022 rezultoi se subjekti nuk ka kryer monitorimin e shkarkimeve te përcaktuar ne kushtin 7.1.3. dhe në shtojcën 1.1, tabela 1.1.2 a), shtojcën 1.2, tabela 2.2.1, te lejes mjedisore te tipit A, Në kundërshtim me Ligji nr. 10448, date 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, neni 29 në kundërshtim me Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, neni 44 ,Subjekti nuk ka realizuar monitorimin e shkarkimeve ne ajër siç parashikohet ne shtojcën 1.2, tabela 2.2.1 te lejes se mjedisit te tipit A.
Në proces verbal Datë: 15/11/2022 në paragrafin 7. ""Gjetjet e konstatuara'' Ka shkelje të kërkesave ligjore: Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve: 1. Neni: 29 : Kundërvajtjet . Ligji: Nr. 10 448 date 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar . Pika: 1 b. i) për lejet e mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë ***në vlerën 1 000 000 lekë***. Komente: Subjekti nuk ka zbatuar kushtet e lejes mjedisore te tipit A (e cila në vetvete bie në kundërshtim me procesin e punës qe operatori kryen), sipas konstatimeve te bëra në listë verifikim.
Në vendimin përfundimtar të marre në datë Datë: 12/12/2022, është mbyllur pa masë administrative.
**Në sistem mungon;**
-raporti i monitorimit te shkarkimit te përcaktuar ne kushtin 7.1.3.
-monitorimin e shkarkimeve ne ajër siç parashikohet ne shtojcën 1.2, tabela 2.2.1 te lejes se mjedisit.
-gjithë dokumentacioni është pa nr prot të AKM-së, në këto kushte ndaj subjektit, duhej marrë **masë administrative 1,000,000 lekë**.

**11. Me Listë verifikim** Nr. AKM-LE-2022-000028 - 2/1 Datë: 02/03/2022,Emri i Subjektit A.- K.. Lloji i aktivitetit ekonomik "Industria minerare'' inspektuar nga **P. F., B. L.,** në proces verbal dhe vendim përfundimtarë nuk janë konstatuar shkeljet kërkesave ligjore. **Në sistem Mungon; raporti vjetor i protokolluar pranë AKM-se, mungon** Planin e menaxhimit të mbetjeve, **në këto kushte ndaj subjektit duhej marrë masë administrative me gjobë 1,000,000lekë.**

**12.** Me listë verifikim Nr.AKM-LE-2022-000013- 2/1 Datë: 18/02/2022Subjekti inspektuar, të dhëna të përgjithshme të subjektit Emri i Subjektit "G.", Lloji i aktivitetit ekonomik" Industria minerare " Kukës inspektuar nga **P. F., E. Gj.,** listë verifikim i plotësuar në të gjitha rubrikat, **Bshkëlidhur** i gjithë dokumentacioni, por në asnjë nga dokumentet e paraqitura në sistem nuk është, protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, detyrim ligjore Raporti i monitorimit, vetë monitorimit me nr. prot nga AKM, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit" I ndryshuar, neni 29, në këto kushte ndaj subjektit për shkelje duhej marrë masë administrative gjobë në vlerë **300,000 lekë** .

Në 12 praktika nuk kanë hedhur në sistem on-line, të gjithë dokumentacionin shoqërues, ndaj subjekteve nuk është marrë masa administrative gjobë në kundërshtim me Ligjin nr.10488 datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" Neni 29 Kundërvajtjet për lejet e mjedisit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë, ligji nr.10463, datë 22.09.2011 "Per Menaxhimin e Integruar te mbetjeve "neni 17/19/21/22/23.

**3 x 1,000,000 =3,000,000 lekë,**
**1 x 500,000= 500,000 lekë,**
**8 x 300,000 = 2,400,000 lekë,**
**Vlera prej 5,900,000 lekë *(për mos plotësim e dokumentacionit në sistem kjo konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit )***
**Tabela e mëposhtme pasqyron subjektet që kanë aktivitet te ndryshme.**

Realizimi i inspektimeve me zgjedhje për vitin 2021/2022

| Nr | Emërtimi i Subjektit | NIPT | Aktiviteti | Data e inspektimit | Nr. serial i ceshtjes | Problematikat e konstatuara/ detyrat e lena (afatet) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **K.** | J... | Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim dhe asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme | **03.09.2021** | LN-1902-08-2016 | Nuk ushtron aktivitet |
| 2 | U.N.<br>N. Sh. | J... | Transportim i mbetjeve inerte | | LN-7482-06-2019 | Nuk ushtron aktivitet |
| 3 | I.<br>A. K. | K... | Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme. | **08.09.2021** | PN-5636-08-2017 | Nuk ushtron aktivitet |
| 4 | A . G .<br>P. T. | K... | Grumbullim , Transportim , rujatje riciklim, perpunim apo asgjesim I mbetjeve te llojeve te ndryshme | | LN-1153-03-2016 | Nuk ushtron aktivitet |
| 5 | Emri i Subjektit v.-ll.. | 2020-000063 | ekonomik"Industria minerare'''inspektiar | 05/10/2020 | | Nuk ushtron aktivitet P. F. M.K., N. H. V. Gj. |
| 6 | M. m. V. K. | 2020-000061 | aktivitetit ekonomik ''Fabrika/punishte/pika për prodhimin e perpunimin e produkteve te mishi t''inspektuar nga | 06/10/2020 | | P. F., M. K. N. H. V. Gj. |
| 7 | Kompleksi k. | L... | Prodhim i produkteve abrasive | 29.07.2021 | AKM-LE-2021-000125 | Ne progres |
| 8 | V.<br>A.V. | K... | Cdo proces per aplikime mbi nen-shtresat ose qe ben tharjen, kujdeset pas ketyre aplikimeve, stampon me boje ose ngjyros ose aplikon cdo material tjeter veshes si nje veprimtari prodhimi ose gjate veprimtarise se prodhimit. | 11.10.2021 | Nr.AKM-LE-2021-000135 | Ne progres |
| 9 | V. D. I. E. | L..... | Nxjerrja e mineraleve te reres dhe argjiles nga minierat ne qiell te hapur | 22.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000174 | Progres |
| 10 | R.M. shpk | L.... | Industria minerare | 26.10.2021 | Nr.AKM-LE-2021-000210 | Progres |
| 11 | B. | L.... | Prodhim i aslfalto-betonit | 30.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000242 | Progres |
| 12 | M.-K.V.<br>A.V. | K.... | Cdo proces per aplikime mbi nen-shtresat ose qe ben tharjen, kujdeset pas ketyre aplikimeve, stampon me boje ose ngjyros ose aplikon cdo material tjeter veshes si nje veprimtari prodhimi ose gjate veprimtarise se prodhimit | 11.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000135 | Ne progres |
| 13 | B. P. | L..... | Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj<br>a)Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne cistern te palevizshme me ndonje terminal ose ngarkim/shkarkim i naftes dhe nenprodukteve te saj | 11.10.2021 | Nr.AKM-LE-2021-000176 | Nuk ushtron aktivitet. Kerkese per revokim leje. |
| 14 | "A. M. – P.". " | 2021-000219 | **Aktivitete te tjera''** | 08/11/2021 | 2021-000219 | Nuk ushtron aktivitet J. Sh. dhe B. L. |
| 15 | K. | J..... | Furnizim me karburant | 21.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000193 | Mbyllur me mase administrative. Pengim inspektimi |
| 16 | K... | | Furnizim me karburant | 26.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000195 | Progres |
| 17 | S.<br>S. Sh. | K..... | Fraksionim inertesh | 20.09.2021 | AKM-LE-2021-000157 | Nuk ushtron aktivitet. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | B. S. | L.... | Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike duke perfshire fabrikat e bi | 09.08.2021 | AKM-LE-2021-000091 | Nuk ka filluar ende aktivitetin. |
| 19 | G. B. | L.... | Nxjerrja e mineraleve te reres dhe argjiles nga miniarat me | 03.08.2021 | AKM-LE-2021-nr akm 000087 | Nuk ka filluar ende aktivitetin |
| 20 | R.2.. A.B. | L......... | Rritje intensive e shpendeve ne njeinstalim | 21.09.2021 | AKM-LE-2021-000158 | Nuk ushtron aktivitet. |
| 21 | K. – 2. A. K. | L... | Nxjerrja e mineraleve reres dhe argjiles nga minierat ne qiell te hapur dhe guroret | 17.09.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000166 | Subjekti nuk ka filluar akoma veprimtarine. |
| 22 | S.I.. E. A. | L... | Rikuperim i mbetjeve Jo te rrezikshme | 23.09.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000165 | Subjekt i mbyllur. Nuk ushtron aktivitet. |
| 23 | B. H. B. | J... | Karriere guri gelqeror | 14.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000172 | Nuk ushtron aktivitet |
| 24 | A.- B. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 25.02.2022 | AKM-LE-2022-000023 | Subjekti nuk e ushtron aktivitetin |
| 25 | A.- L. | K... | Nxjerrja e mineraleve dhe argjiles Gurore | 17.12.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000258 | Nuk ushtron aktivitet |
| 26 | M.. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 08.03.2022 | AKM-LE-2022-000041 | Subjekti nuk ka filluar ende veprimtarine e tij. |
| 27 | K.C. | | ekonomik ''Industria minerare'' | Datë: 25/02/2022 | AKM-LE-2022-000023 | Nuk ka filluar ende aktivitet *P. F. B. L.* |
| 28 | Subjektit "P. M." | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 18/03/2022 | AKM-LE-2022-000048 | Nuk ka filluar ende aktivitet *P.F. B. L.* |
| 29 | V. | | | 17/02/2022 | AKM-LE-2022-00012 | Nuk ka filluar ende aktivitetin P.F., E. Gj. |
| 30 | D. A. | | aktivitetit ekonomik Industria minerare | 23/02/2022 | AKM-LE-2022- | Nuk ushtron aktivitet P. F., E. Gj., B. L. |
| 31 | G. B. "inspektua nga | | "*'Veprimtari të tjera* | 03/08/2022 | 2021-000087 | Sh. C., P. F., B. L. |

**1.** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për 31 subjekte dhe auditimi i dosjeve të tyre në ARM Lezhë, Shkodër Kukës konstatohet se për subjektet nuk janë hedhur në sistemin on-line i gjithë dokumentacioni informues dhe shoqërues si statusi sipas QKB-së, shkresa informuese pranë Agjencisë Kombëtarë të Mjedisit në raste kur subjektet nuk ushtrojnë aktivitet

-6 subjekte në progres, ndaj të cilëve nuk është ndërmarrë asnjë masë për hartimin e programeve mujore.

- 21subjekte të cilët nuk ushtrojnë aktivitet e konkretisht për: dokumentit të QKB-së, nëse kanë status aktiv/pasiv, shkresa informuese pranë Agjencisë Kombëtarë të Mjedisit në raste kur subjektet nuk ushtrojnë aktivitet.

-12 subjekte me aktivitet në nxjerrjen e mineraleve, rërës argjilës nga karrierat në qiell të hapur dhe guroret.

-9 subjekte me veprimtari të ndryshme, të cilët nga auditimi i AKM në teren gjenden të mbyllura dhe nga verifikimi i tyre në QKB nga AKM, rezultojnë aktiv.

Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim **me ligjin** nr.10431 datë 09.06.2011"Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit", me ligjin nr. 10433 datë16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" nenin 45-48 dhe me ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" neni 29, pika1/i, "Kundërvajtjet", për të cilët mbajnë përgjegjësi, *B. F.në cilësinë e Drejtoritë të Agjencisë Rajonale të Mjedist, J. Sh. në cilësinë e Përgjegjës së sektorit të Mjedisit e komanduar, B. L., P. F., E. Gj., Sh. Ç.,N. H., N. D., V. Gj., K. U., me detyrë inspektorë .*

-Nga inspektimi në 45 subjekte, nga të cilat në *12 raste,* me aktivitet "nxjerrjen e mineraleve, rëres argjilës nga karrierat në qiell të hapur dhe nga guroret subjekte për të cilat rezultojnë së nuk ushtrojnë aktivitet aktualisht, megjithëse ato figurojnë me status aktiv sipas QKB. Nuk është bërë /apo programuar një inspektim i dytë për të konstatuar dhe evidentuar situatën e gjendjes së mjedisit, ekzaminimin e dëmtimeve në mjedis të shkaktuar nga aktiviteti i tyre. Nuk ka një vlerësim të shkallës së ndikimit në mjedis në terrenet ku është shtrirë aktiviteti i tyre si

dhe nuk është bërë përcaktimi i vlerës së dëmit e nxjerrjen e përgjegjësisë, të cilat duhet të ishin pjesë e raportimeve në institucionet përgjegjëse të Ministrisë së Mjedisit, për të cilat nuk përcaktohet se çfarë lloj sipërfaqe është pjesë jo pyjore e fondit pyjor apo fond pyjor e shpërndarë sipas zërave kadastra të fondit pyjor e kullosor si: pyll tru ngishte, pyll cungishte, pyll shkurre, kullota, tokë me bimësi pyjore dhe djerr, tokë in produktivë ose të zhveshur, nuk ka informacion nëse janë hequr nga fondi pyjor, i cili është detyrim i çdo do bashkie, kur një fond pyll cungishte, etj... është i pajisur me leje shfrytëzimi dhe të jene hequr nga fondi pyjore, sipas VKM-së, nr.391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" pika 8 i cili përcakton: "8. Për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 8, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi "Lidhja 8 "Tarifat e shpërblimit të dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor" pika 15.

**2.** ARM Kukës, Lezhë, Shkodër, në planifikimet vjetore e mujore, të inspektimeve nuk ka përfshirë një masë të konsiderueshme të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Lezhë si aktivitet që me ndryshimet ligjore kanë kaluar nga leje të tipt C në leje të Tipit B, si dhe me aktivitete me ndikim në mjedis, dhe janë lënë jashtë planifikimit vjetor një numër subjektesh, në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit", ku në nenin 62 "Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit" Pika (e) përcaktohet: "e) ***kryen kontrollin*** *për zbatimin e detyrave, të shoqëruara me hetimin* ***e zonave*** *të ndotura apo* **potencialisht të ndotura**, *si dhe të detyrave e të programit për rehabilitimin e zonës së ndotur.*

Tabela e subjekteve 2021,2022

| Nr | EmërtimiiSubjektit | NIPT | Aktiviteti | Data e inspektimit | Nr. serial i ceshtjes | Problematikat e konstatuara/ detyrat elena (afatet) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gj.sh.p.k | J... | Gurore | 11.06.2021 | AKM-LE-2021-000044 | Eshte subjekt i mbyllur |
| 2 | S. A. A. | K... | Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to. | 26/07/2021 | AKM-LE-2021-000061 | Subjekti eshte gjobitur per pengim inspektimi |
| 3 | A. B. O.B. | J.... | Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret. | 25.08.2021 | AKM-LE-2021-000106 | Subjekti nuk e ushtron aktualisht veprimtarine |
| 4 | RT M. shpk | L... | Industria minerare | 26.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000210 | Pengim inspektimi |
| 5 | E. – 0. SHPK | K... | Nxjerrja e mineraleve dhe argjilës Gurore | 25/02/2022 | Nr. AKM-LE-2021-000265 | Eshte marre mase admi gjobe ne vlere 300, 000 leke per pengim ne inspektim. |
| 6 | B.P. | L... | Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos ne mase te madhe | 18.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000179 | Mase administrative. Pengim inspektimi.10,000 lkë |
| 7 | V.G. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjiles nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 17.02.2022 | AKM-LE-2022-000007 | Dënim administrativ kryesor: Gjobë : 50.000 Lekë Per pengim inspektimi |
| 8 | C... | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 18.02.2022 | AKM-LE-2022-000008 | Dënim administrativ kryesor: Paralajmerim |
| 9 | R. 2. M. Gj. | K... | Impiant fraksionizmi insertesh lumore | 14.09.2021 | AKM-LE-2021-000156 | Subjektit i eshte lene mase administrative paralajmerim. |
| 10 | XH... | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 24.02.2022 | AKM-LE-2022-000018 | Dënim administrativ kryesor: Gjobë : 50.000 Lekë Per pengim inspektimi |
| 11 | E...-06 | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 28.02.2022 | AKM-LE-2022-000029 | Dënim administrativ kryesor: Gjobë : 50.000 Lekë Per pengim inspektimi |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | K. CH. M. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 01.03.2022 | AKM-LE-2022-000030 | Nuk eshte realizuar inspektimi per shkak te kushteve atmosferike. |
| 13 | G.S. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 03.03.2022 | AKM-LE-2022-000032 | Dënim administrativ kryesor: Gjobë : 20.000 Lekë Per pengim inspektimi |
| 14 | M. V. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 07.03.2022 | AKM-LE-2022-000035 | Nuk eshte realizuar inspektimi per shkak te kushteve atmosferike. |
| 15 | K.I. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 09.03.2022 | AKM-LE-2022-000037 | Dënim administrativ kryesor: Paralajmërim |
| 16 | I. M. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 11.03.2022 | AKM-LE-2022-000039 | Dënim administrativ kryesor: Gjobë : 10.000 Lekë Për pengim inspektimi |
| 17 | S.-A. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 22.02.2022 | AKM-LE-2022-000020 | Subjekti ka pezulluar aktivitetin minerar si rezultat i mos miratimit te Programit vjetor te punës për lejen minerare |
| 18 | S. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 23.02.2022 | AKM-LE-2022-000021 | pengim inspektimi Ligji 10433, date 16.06. 2011 "Për Inspektimin ne Republikën e Shqipërisë". 36, Detyrimet e subjekti te inspektimit a) të caktojë një përfaqësues për të komunikuar me inspektorin gjatë inspektimit, në rast se nuk dëshiron të komunikojë drejtpërdrejt me inspektorin., Ndaj subjektit është marre mase administrative me gjobë 20, 000 mije lekë, perse dy standarde B.L. |
| 19 | 2. G. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 09.03.2022 | AKM-LE-2022-000042 | Nuk është realizuar inspektimi për shkak te kushteve atmosferike. |
| 20 | T.-A. K. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 01.03.2022 | AKM-LE-2022-000027 | Nuk është realizuar inspektimi për shkak te kushteve atmosferike. |
| 21 | K. CH. M. | | Nxjerrja e mineraleve,rerez dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret | 16.03.2022 | AKM-LE-2022-000052 | Nuk është realizuar inspektimi për shkak te kushteve atmosferike. |
| 22 | R.M. shpk | L.... | Industria minerare | 26.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000210 | Paralajmërim |
| 23 | B. sh.a | K... | Industria minerale | 26.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000209 | Paralajmërim |

**3.** Në 7 raste janë dhënë masa administrative me gjobë "Për pengim inspektimi'' ku me të njëjtat mangësi, janë marrë vendime të ndezshëm, janë përdor standarde të dyfishta për plotësimin e kushteve dhe kritereve. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin për lejet e mjedisit dhe ligjet të inspektimeve sidomos rastet kur pengohet për kryerjen e inspektimit në disa raste 10/ 20/50 mijë lekë, veprime që nuk janë në përputhje me Ligji i Inspektimit Neni 54 Kundërvajtjet administrative, Prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve a instalimeve, si dhe çdo shenjë tjetër, të vendosura nga inspektorët, si dhe pengimi i inspektimit, nëse nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në vlerën nga 10 000 deri në 100 000 lekë. Të drejtën e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjes e ka çdo inspektor i inspektoratit kompetent.

**4.** Nga auditimi rezultoi se në 4 subjekte, të pajisura me leje mjedisore, nga sektori i mjedisit janë lënë masa kryesore më Paralajmërim, nga Drejtori i ARM-së, nuk janë marrë masa për të hartuar programe pune për të kryer ri-inspektime, për subjekt nëse kanë plotësuar dokumentacioni, nuk është proceduar për rishikim në periudha të mëvonshme nëse këto subjekte kanë plotësuar detyrat për plotësimin e kushteve të lejeve mjedisore. Mungesa e ri-inspektimeve ka sjellë mos verifikimin deri në plotësim të dokumentacionit si mbajtës të lejes, të subjekteve në proces dhe mos evidentimin e rasteve të refuzimeve. Përgjegjësi të Mjedisit nuk ka hartuar dhe paraqitur periodikisht pranë Titullarit një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, për verifikimin e detyrave të lëna**.** Si pasoje e kësaj dhe titullari si menaxher i institucionit nuk ka hartuar apo autorizuar inspektorët, për rishikim dhe detyrim deri në plotësimin e kushteve, ose në të kundërt vendosjen e masave administrative_"dënim me gjobë" në masën 300,000 lekë-500,000 lekë të cilat përbëjnë objekt dënimi me gjobë Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit "seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit", me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" nenin 45-48 dhe me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", neni 29, pika1/ii, "Kundërvajtjet".

**5.** Në shumë raste procedurat e trajtuara më sipër të përzgjedhura për auditim rezultoi se, grupet e inspektimit në terren nuk kishin zbatuar objektivat e inspektimit, duke mos u shprehur lidhur me: kontrollin e dokumentacionit tekniko-ligjor për ushtrimin e aktivitetit, të dhënat e vetmonitorimit për shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë, planin e menaxhimit të mbetjeve, raportimin e të dhënave të vet monitorimeve në institucionet përgjegjëse ARM Lezhë dhe AKM Tiranë, duke kryer vetëm një verifikim të thjeshtë për lëshimin e lejes mjedisore dhe pagesat vjetore lidhur me to. Në këto raste proces-verbalet mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo efecientë, jofunksionale, të paplota, në mospërputhje me nenin 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", nenit 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për lejet e mjedisit", nenit 14 "Vlerat 26 kufi të shkarkimeve", sipas shtojcës "2", bashkëlidhur ligjit, "Lista indikativë e substancave kryesore ndotëse që duhen dhe marrë parasysh në qofte se kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve" të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", me nenin 19 "Vetë monitorimi".

Tabela me subjektet e inspektuara për periudhën objekt auditimi, pikat e karburantit që me ndryshimet ligjore, sipas kapaciteteve kanë kaluar në leje të Tipit B,

*Tabela e subjekteve të karburanti të inspektuar për vitet 2020,2021,2022*

| | Emërtimi i Subjektit | NIPT | Aktiviteti | Data e inspektimit | Nr. serial i ceshtjes | Problematikat e konstatuara/ detyrat elena (afatet) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | V. K. | K... | 1.10 Furnizimi me karburant i makinave ne një stacion të furnizimit me karburant 1.11 Furnizim për mbushje gazi GLN 10.5 Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave nqs nuk janë përmendur diku tjeter ne kete shtojce 7.7.n Gatim dhe tregtim i produkteve ushqimore te gatshme dhe gjysmë te gatshme | 10/09/2020 | AKM-LE-2020-000003 | Ska problematika, per shkak te ndryshimeve qe ka patur ne Ligjin per Lejet e Mjedisit dhe vend ndodhjes ky subjekt nuk eshët me pjese e shtojces 1 |
| 2 | S. Sh.p.k | J... | Pike karburanti me pakice. | 17/09/2020 | AKM-LE-2020-000021 | Ska problematika, për shkak te ndryshimeve qe ka patur ne Ligjin per Lejet e Mjedisit subjekti plotëson kriteret për tu pajisur me leje tip |
| 3 | V.&V. – g | K... | 1.10 Furnizimi me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant 1.11 Furnizim per mbushje gazi GLN | 21/09/2020 | AKM-LE-2020-000023 | Ska problematika, për shkak te ndryshimeve qe ka patur ne Ligjin për Lejet e Mjedisit subjekti plotëson kriteret për tu pajisur me leje tip B |
| 4 | D. B. O. | L... | 1.10 Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant. 1.11 Furnizim për mbushje gazi GLN. | 25/09/2020 | AKM-LE-2020-000025 | Skaj problematika, |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | për shkak te ndryshimeve qe ka patur ne Ligjin per Lejet e Mjedisit subjekti plotëson kriteret për tu pajisur me leje tip B |
| 6 | L.-F.G.<br>Z. H. | K... | Gaz natyror aromatic ose GNL | 25.06.2021 | AKM-LE-2021-000014 | Nuk janë konstatuar problematika |
| 7 | V.&V.– g<br>Gj. G. | K... | Furnizimi me karburant i makinave ne një stacion te furnizimit me karburant Furnizim per mbushje gazi GLN | 09.07.2021 | AKM-LE-2021-000075 | Nuk janë konstatuar problematika/ Inspektuar leja Me PN-0307-03-2021 |
| 8 | A.<br>A.Xh. | K... | GazNatyroraromatikose GLN | 27/07/2021 | AKM-LE-2021-000078 | Nuk jane konstatuar problematika |
| 9 | E. O.<br>E. B. | L... | Magazinimi naftes dhe nenprodukteve te saj ne nje terminal | 28/07/2021 | AKM-LE-2021-000080 | Pengim inspektimi |
| 10 | E. G. | K... | Gaznatyror, aromatic ose GNL | 17.08.2021 | AKM-LE-2021-000117 | Nuk janë konstatuar problematika |
| 11 | 2A E... | K... | Gaz Natyror aromatic ose GLN | 12.08.2021 | AKM-LE-2021-000112 | Nuk janë konstatuar problematika |
| 12 | B. P.<br><br>M. M. B. | L. | Shperndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve te saj<br>a)Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne cistern te palevizshme me ndonje terminal ose ngarkim/shkarkim i naftes dhe nenprodukteve te saj ne / nga nje cistern e levizshme, | 11.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000176 | Nuk ushtron aktivitet.<br>Kërkese për revokim leje. |
| 13 | K.<br><br>P. N. | J.. | Furnizim me karburant | 21.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000193 | Mbyllur me mase administrative.<br>Pengim inspektimi |
| 14 | K.<br>N. B. | L. | Furnizim me karburant | 26.10.2021 | Nr. AKM-LE-2021-000195 | Nuk janë kinstatuar problematika |

**6.** Siç shih dhe nga tabela është inspektuar një numër i vogël i këtyre subjekteve.
Nga përgjegjësi i sektorit nuk janë planifikuar dhe hartuar plane pune, për kryerjen e inspektimeve të këtyre subjekteve, pasi ka kaluar rreth 2 vite pas ndryshimeve ligjore.
Gjithashtu dhe nga titullari I institucionit nuk është kërkuar informacion, në lidhje më subjekte që kalojnë nga leje te Tipit C, në Leje të Tipit B, veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr.10 433, datë 16.6.2011"Për Inspektim në Republikën e Shqipërisë" Kreu IV rregulla të përgjithshme për programimin dhe autorizimin e inspektimit neni neni 26 Kohëzgjatja vjetore e inspektimit në vendin e ushtrimit të veprimtarisë pika 1.Gjatë një viti kalendarik, një subjekt i caktuar inspektimi mund t'u nënshtrohet inspektimeve në vend, në fushën e veprimit të këtij ligji, për një periudhë kohore jo më të gjatë se periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor.
*Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi B. F. në cilësinë e Drejtoritë të ARM –së për gjithë periudhën objekt auditimi.*

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes:** | Nga inspektorët nuk ka informacione dhe të dhëna për ndjekjen e inspektimeve për herë të dytë, ku në rast të mos zbatimit të detyrave të lëna duhet të merren masë me gjobë ose mbyllje të aktivitetit. |
| **Situata:** | Në rastet kur subjektet janë gjetur të mbyllur, nuk është përcaktuar kohë e kryerjes për herë të dytë të inspektimit, apo njoftimi i detyruar nga subjekti me informacione vërtetuese. |
| **Kriteri:** | Ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Nuk janë hartuar plane pune për subjektet që janë konstatuar që nuk ushtrojnë aktivitet / të mbyllura. |
| **Shkaku:** | Mos hartimi i planeve të punës nga Titullari |

| | |
|---|---|
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandim** | ***Rekomandim.*** Titullari i institucionit në bashkëpunim me përgjegjësin e sektorit të marrin masa që të hartojë programime nga vetë inspektorati, bazuar në metodologjitë e vlerësimit të rrezikut dhe në detyrimin për inspektimin të parashikuara nga ligjin i posaçëm. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes:** | Përzgjedhja e subjekteve për tu inspektuar nuk kryhet sipas rëndësisë së tyre dhe sipas ndikimit që mund të kenë në mjedis, pasi nuk kanë një liste ë subjekteve të paisura me leje mjedisore, nga praktikat e përzgjedhura subjektet janë me ndikim të ulët ose të mesëm në mjedis. |
| **Situata:** | Sektori i Inspektimit mjedisit në Agjencinë Rajonale të Mjediset Lezhë, Kukës Shkodër nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të llastuara sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun Lezhë, Kukës, Shkodër, mbështetur në këto të dhëna të bëhej identifikimi i subjekteve dhe veçimi i atyre me risk të lartë e ndikim në mjedis.. |
| **Kriteri:** | Kjo në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhrat e Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015 *"Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë"* dhe nr.6 datë 19.02.2015*"Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut.* |
| **Ndikimi/Efekti:** | Inspektim i një numri të ulët të subjekteve që kanë ndikim në mjedis. |
| **Shkaku:** | Nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të llastuara sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun Lezhë, Kukës, Shkodër. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandim** | ***Rekomandim*:** Agjencinë Rajonale të Mjediset Lezhë, Kukës Shkodër , të hartojnë një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në këtë Qark. |

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi punonjësit e trajtuar në Projekt raport.

**Pretendimet e subjektit:** Me **shkresën nr.504** datë 16.06.2023, ARM Lezhë, Shkodër Kukës ka dërguar komentet mbi trajtimin e inspektimeve në fushën mjedisit nga inspektorët e Sektorit të Mjedisit.

Dokumentacioni i përcjellë me shkresë është i pa firmosur nga punonjësit përgjegjës. Gjithashtu i gjithë dokumentacioni është fotokopje, me gjithë këto pa rregullsi grupi i auditimit është përpjekur për të marrë në konsideratë pjesë të dokumentacionit që është menduar që është i saktë dhe vërtetues për konstatimet e lëna në subjekt.

**Gjithashtu konstatohet se në asnjë rast nga ana e ARM Lezhë-Shkodër-Kukës, nuk i është drejtuar Ministrit, me propozimin për pezullimin e lejes së subjektit, i cili nuk ka paguar gjobën,** në kundërshtim me ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT", neni 69, pika 8, ku citohet se:

*"Ministri, me propozimin e inspektoratit, në rastet kur gjoba nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, pezullon lejen përkatëse mjedisore deri në pagesën e gjobës"*

**Përsa u trajtua më sipër mbajnë përgjegjësi:**
**Z. B. F., Drejtor**
**Z. K.H., Jurist**
*(Sa më sipër është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 6, datë 09.06.2023)*

**Pretendimi i subjektit:**

*ARM Lezhë-Shkodër-Kukës, me shkresë nr. 504, datë 16.06.2023, ka dërguar observacionin për Akt-Konstatimin nr. 6, datë 09.06.2023, **observacion i cili nuk është i konfirmuar nga hartuesi me emrin dhe mbiemrin**, por megjithatë u shqyrtua nga ana jonë.*
*Observimi ka të bëjë me:*
*Problematikat e ndjekjes dhe arkëtimit të gjobave të vendosura, ku observuesi vëren se:*
*"Përsa i përket Urdhrave të Ekzekutimit, i kemi dërguar përsëri për të qenë më preciz për të mos patur vonesa nga ana e gjykatës. Për pjesën e shndërrimit në tituj ekzekutiv nuk kemi mbërritur në atë fazë, pasi për disa subjekte nuk ka ardhur vendimi i zbardhur, ndërsa nuk është në proces, jemi në pritje të vendimit të gjykatës.*

***Duhet theksuar se jemi në afat kohor të parashikuar nga legjislacioni për kërkimin e lëshimit të urdhrave të ekzekutimit.***
*Përsa i përket 15 subjekteve, ju bëjnë më dije se :*
*-Jemi në proces përgatitje të lëshimit të urdhrave ekzekutivë pasi jemi Brenda afateve ligjore për subjektet:E.C. dhe E.M., E., A.E. E., E. 06, K. Ch. M..*
*-Kërkesat e Lëshimit të Urdhrave Ekzekutivë janë dërguar në gjykatë për subjektet: B., F. Sh. (bashkëlidhur).*
*Është zhvilluar procesi gjyqësor dhe **është fituar nga ana e ARM** Lezhë pa të drejtë ankimi nga pala tjetër, jemi në pritje të zbardhjes së vendimit, për subjektin: D..*
*-Janë paguar gjobat nga subjektet (bashkëlidhur dokumentet): E.B.C.O, S., S., K., B. B., 2R G., A. B. 0.*
*-Përsa i përket gjobave të vendosura në Shtator 2020 janë paguar për subjektet (bashkëlidhur dokumentet): P.= 300,000 lekë, R. 2015=50,000 lekë.*
**Qëndrimi i grupit të auditimit:**
*Megjithëse observacioni lë shumë për të dëshiruar me parregullsitë e paraqitjes, për shkak të mos konfirmimit të tij si dhe dokumentacionit fotokopje, merret parasysh në çështjet të cilat konsiderohen të pandryshueshme dhe reflektohet në Projekt-Raportin e Auditimit.*
*Konsiderohen të pranueshme vërejtjet që kanë të bëjnë me faktin:*
*-Pagesat e gjobave nga subjektet: E.B.C.OIL, S., K., B. B., 2. G., P., të cilat kanë dokumentet bashkëlidhur.*
*Nuk konsiderohen të pranueshme vërejtjet:*
*- Për subjektin D., pasi nuk janë paraqitur dokumente për faktin e procedurës gjyqësore.*
*- Për faktin se janë paguar gjobat nga subjektet: S., A. B. 0., pasi mungojnë dokumentet bashkëlidhur.*
*- Përsa i përket gjobës së vendosur në Shtator 2020 për subjektin: R. 2.=50,000 lekë, pasi mungojnë dokumentet bashkëlidhur.*
*- Përsa i përket faktit se është në process përgatitje të lëshimit të urdhrave ekzekutivë për subjektet: E. C. dhe E. M., E., A. E. E., E.0., K. Ch. M., për të cilët duhej dërguar kërkesa për lëshim urdhri ekzekutiv, pavarësisht se janë Brenda afatit.*
*-E Kërkesave të Lëshimit të Urdhrave Ekzekutivë të cilat janë dërguar në gjykatë për subjektet: B., F. Sh., të cilat kanë dokumentet bashkëlidhur, por janë dërguar në gjykatë më datë 13.06.2023, dhe praktikisht ndodhen në prag të parashkrimit. U çuan në gjykatë pas dorëzimit të akt-konstatimeve, me nr. 492 dhe 493, datë 13.06.2023, praktikisht të parashkruara.*
*Observacioni qëndron pjesërisht.*

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetje** | Mos ndjekja e procedurave ligjore deri në arkëtimin masave administrative të vendosura në inspektimet e realizuara nga ARM Lezhë. |
| **Situata:** | ARM Lezhë-Shkodër-Kukës gjatë periudhës 01.09.2020 deri 31.12.2022, nga 43 inspektime të kryera, në 38 (tridhjetetetë) raste janë vendosur sanksione kryesore ligjore (gjoba) në vlerën e përgjithshme prej 9,330 mijë/lekë.<br>Institucioni ka hasur problematika të lidhur me dërgimin e gjobave përmes postës. Lajmërim marrja nga subjektit kundërvajtës është mjaft e rëndësishme për arsye sepse këtu nisin afatet ligjore për ndjekjen procedurave për ekzekutimin e gjobave. Një pjesë e dërgesave postare kthehen, ose kur dërgohen lajmërim marrja në institucion vonon, kjo përbën një pengesë për ndjekjen e gjobave. |

| | |
|---|---|
| | Për periudhën e viteve 2021, 2022, ARM Lezhë, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lezhë, me kërkesë për nxjerrjen e urdhrit ekzekutiv për 11 vendime dënimi administrativ, për të cilat subjekte gjykata nuk ka dërguar shkresë dhe 11 kërkesat janë në pritje të nxjerrjes së urdhrave të ekzekutimit.<br>Lidhur me dorëzimet e praktikave të proceseve gjyqësore dhe praktikat e vendimeve, dënimeve administrative (gjobat ) nga ish -ISHMPUT (ISHMPUT Dega Lezhë, ISHMPUT Dega Kukës dhe ISHMPUT Dega Shkodër), konstatohet se nuk është përcjellë dokumentacioni lidhur me gjobat e vendosura nga ish-ISHMTP-të.<br>Për **8** subjekte në shumën **930 mijë/lekë**, nga ana e ARM Lezhë nuk është ndërmarrë asnjë hap për të filluar procedurën e arkëtimit të gjobave, pavarësisht se janë brenda afatit.<br>Gjoba e vendosur gjatë muajit Shtator 2020, për subjektin R. 2015, prej **50 mijë/lekë, është parashkruar.**<br>*Janë pothuajse të parashkruara gjobat e vendosura në muajin Qershor 2021, për:*<br>-B.- 50 mijë/lekë, data 24.06.2021<br>-F. SH.-100 mijë/lekë, data 25.06.2021<br>Nga ana e ARM Lezhë-Shkodër-Kukës, në asnjë rast nuk i është drejtuar Ministrit, me propozimin për pezullimin e lejes së subjektit, i cili nuk ka paguar gjobën.<br>-Konstatohet se në asnjë rast nga ana e ARM Lezhë-Shkodër-Kukës, nuk i është drejtuar Ministrit, me propozimin për pezullimin e lejes së subjektit, i cili nuk ka paguar gjobën. |
| **Kriteri:** | - Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" neni 46,*"Parashkrimi i dënimit administrative"*.<br>-Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT", neni 69, pika 8. |
| **Ndikimi/Efekti** | Rrisk i lartë për mos arkëtimin e gjobave |
| **Shkaku** | Mungesë koordinimi dhe njohjeje |
| **Rëndësia** | E Mesme |
| **Rekomandim** | Agjencia Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës (Sektori i Financës), të marrë masat që anëtarët e komisionit të inventarizimit të përpilojnë deklaratat e konfliktit të interesit në momentin e fillimit të procesit të inventarizimit si dhe të hartojë/plotësojë regjistrin e aktiveve. |

***2.7. Mbi verifikimin dhe ndjekjen e Ankesave;***

Në lidhje me*: Verifikimin, ndjekjen dhe kthimin e përgjigjeve të ankesave të ardhura në* ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, *nga qytetar dhe institucione të ndryshme për periudhën 01.09. 2020 deri 31.12.2020.*

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua:

Janë protokolluar pranë institucionit 9 Ankesa

- Në vijimësi po paraqesim Ankesat që u konstatuan me mangësi në dokumentacion.

**<u>Ankesa me mangësi në dokumentacion</u>**

***Nga auditimi i ankesave për vitin 2020***

**1 - Ankesë nga banori Gj.Ll.,** shkresa nr. 145 prot, datë 01.09.2020, në të cilën shpreh shqetësimin se pronari i stallës së lopëve M. M. ka ndotur ambientin që ndodhet në afërsi të shtëpisë së ti. Ky dokument i është deleguar znj. J. Sh..

**Dokumentacioni në praktikë**:

Asnjë dokument nuk ndodhet këtë praktikë përveç ankesës.

**Mangësi**

-Nga ana e Titullarit nuk është lëshuar autorizim për monitorimin e ankesës veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale" Pika 16, si dhe nuk është bërë një kthim përgjigje, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale" Pika 14 dhe pika 15.

- Nuk është përpiluar relacion për Titullarin e ARM mbi monitorimin e kryer për ankesën, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "Detyrat Funksionale të specialist të sektorit të inspektimit mjedisor", pika 11 si dhe në kundërshtim me rregulloren e brendshme "Detyrat Funksionale të specialist/inspektor të sektorit të inspektimit mjedisor", pika 3 dhe pika 4.

**2 - Ankesë nga banorët e lagjes Skëndërbeg, Lezhë,** shkresa nr. 150 prot, datë 02.09.2020, në të cilën shprehin shqetësimin për ndotje mjedisore nga subjekti I.N.C.A. N. F..

**Dokumentacioni në praktikë**:

Relacion nga inspektorët P. F. dhe A. B. nr. 148 prot, datë 02.09.2020

**Mangësi**

-Nga ana e Titullarit nuk është lëshuar autorizim për monitorimin e ankesës veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale" Pika 16, si dhe nuk është bërë një kthim përgjigje për banorët e lagjes Skëndërbeg, Lezhë, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale" Pika 14 dhe pika 15.

- Nuk është përpiluar relacion për Titullarin e ARM mbi monitorimin e kryer për ankesën, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "Detyrat Funksionale të specialist të sektorit të inspektimit mjedisor", pika 11 si dhe në kundërshtim me rregulloren e brendshme "Detyrat Funksionale të specialist/inspektor të sektorit të inspektimit mjedisor", pika 3 dhe pika 4.

*Për sa është trajtuar në këtë Akt-Konstatim nr.7, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me të tyren nr. 504 prot., datë 16.06.2023 dhe me tonën nr. 351/2 prot datë 16.06.2023.*

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

<u>Viti 2020</u>

**Ankesa nr. 3. Ankesë nga banori K. N., Lezhë,**

Plotësim dokumentacioni.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>

Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për këtë ankesë merret në konsideratë.

**Ankesa nr. 4. Ankesë nga banorët e lagjes Skëndërbeg, Lezhë, shkresa nr. 305 prot, datë 07.10.2020.**

Plotësim dokumentacioni.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për këtë ankesë merret në konsideratë.
Pretendimi i subjektit:
Viti 2020
**Ankesa nr. 5. Ankesë nga banorët e lagjes Skëndërbeg, Lezhë, shkresa nr. 348 prot, datë 22.10.2020,**
Plotësim dokumentacioni.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për këtë ankesë merret në konsideratë.
***Nga auditimi i ankesave për vitin 2021***
Në lidhje me*: Verifikimin, ndjekjen dhe kthimin e përgjigjeve të ankesave të ardhura në* ARM Shkodër, Lezhë, Kukës*, nga qytetar dhe institucione të ndryshme gjatë vitit 2021.*
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua:
Janë protokolluar pranë institucionit 14 Ankesa
- Në vijimësi po paraqesim Ankesat që u konstatuan me mangësi në dokumentacion.
**Ankesa me mangësi në dokumentacion**
**1 - Ankesë nga subjekti K. A. A. SH.A**. shkresa nr. 284, datë 22.04.2021, në të cilën subjekti K. A. A. SH.A., i cili ushtron aktivitet në fushën e mbarështimit dhe rritjen intensive të peshkut, bën ankesë për qytetarin A. N., i cili bën kufizimin e prurjes së ujit pasi kanali në të cilik kalon uji është në pronësi të tij.
ARM Shkodër, Lezhë, Kukës ka nxjerrë autorizimin me nr. 285 prot, datë 22.04.2021, mbështetur në VKM nr. 568, datë 17.07.2019, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKM-së", Ligjit 44/2015, "Kodi i procedurës administrative" dhe ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në të cilin drejtori B.F.autorizon grupin e punës i përbërë nga z. V. Gj. dhe z. K. U., që të monitorojnë situatën në vend. Ky grup ka dalë me një akt Konstatim ku konstatohet se z. A. N., i gëzon certifikatën e pronësisë në truallin ku kalon burimi ujor, ka ndërhyrë duke kufizuar pjesërisht kalimin e ujit për tek subjekti K.A. A. SH.A.
**Dokumentacioni në praktikë**:
Autorizim nr. 285 prot, datë 22.04.2021
Akt Konstatim nr. 285/1datë 22.04.2021
Leje për përdorim të burimit Ujor, lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit si dhe nga Këshilli i Basenit Ujor Drin – Bunë nr. 179/6, datë 10.04.2017.
Miratim Licence lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1798/1.
Certifikatë për Vërtetim Pronësie e z. A. Z. N.
**Mangësi**
-Nga ana e Titullarit nuk është bërë një kthim përgjigje për subjektin K. A.A. SH.A., veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale" Pika 14 dhe pika 15.
**2 - Ankesë nga znj R.Sh.** për mbetje inerte zonën me adresë Rruga nr. 6, Velipojë, Njësia Administrative Velipojë.
**Dokumentacioni në praktikë**:
Autorizim lëshuar nga titullari nr. 344, datë 12.05.2021,
Relacion nga inspektorët Sh.C., B. L. dhe K. U. nr.344/1, datë 12.05.2021,
Kthim Përgjigje nga ana e titullarit nr. 344/2 prot, datë 12.05.2021.

**Mangësi**
- Nuk është bashkangjitur në praktikë dokumenti i Ankesës.

**5- Ankesë nga qytetari B. F.** me e-mail datë 13.11.2021, ankesë në emër të banorëve të Shëngjinit për Fabrikën P. nga e cila vijnë aroma të rënda dhe të pakëndshme të cilat vinë nga kanalizimet e qytetit.

**Dokumentacioni në praktikë**:
Autorizim nr. 1291/1, datë 15.11.2021,
Informacion për titullarin nga inspektorët N.D. dhe Sh. C. nr.1291/2, datë 15.11.2021

**Mangësi**
- Nga ana e Titullarit nuk është bërë një kthim përgjigje, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale" Pika 14 dhe pika 15.

*Për sa është trajtuar në këtë Akt-Konstatim nr.7, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me të tyren nr. 504 prot., datë 16.06.2023 dhe me tonën nr. 351/2 prot datë 16.06.2023.*

<u>Pretendimi i subjektit:</u>
<u>Viti 2021</u>

**Ankesa nr. 1. Ankesë nga subjekti K. A. A. SH.A. shkresa nr. 284, datë 22.04.2021**
Plotësim dokumentacioni.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>
Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për këtë ankesë nuk merret në konsideratë pasi në dispozicion të grupit të auditimit është vënë shkresa nr. 284/1, datë 23.04.2021 me lëndë kthim përgjigje por pa asnjë dokument bashkangjitur që justifikon kthimin e përgjigjes nga ana e Drejtorit të ARM Lezhë.

**Ankesa nr. 3. Ankesë nga z. M.D. nr. 347063, datë 21.05.2021**
Plotësim dokumentacioni.

**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>**
Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për këtë ankesë merret në konsideratë.

Ankesa nr. 4. Ankesë nga një banor në Rubik, shkresa nr. 789 prot, datë 27.07.2021.
Plotësim dokumentacioni.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>
Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për këtë ankesë merret në konsideratë.

**Ankesa nr. 5. Ankesë nga qytetari B.F. me e-mail datë 13.11.2021**
Plotësim dokumentacioni.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>
Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për këtë ankesë nuk merret në konsideratë pasi në dispozicion të grupit të auditimit është vënë një e-mail datë 15.11.2021, por pa asnjë dokument bashkangjitur që justifikon kthimin e përgjigjes nga ana e Drejtorit të ARM Lezhë.

***<u>Nga auditimi i ankesave për vitin 2022</u>***
Në lidhje me*: Verifikimin, ndjekjen dhe kthimin e përgjigjeve të ankesave të ardhura në* ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, *nga qytetar dhe institucione të ndryshme gjatë vitit 2022.*
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua:
Janë protokolluar pranë institucionit 14 Ankesa
- Në vijimësi po paraqesim Ankesat që u konstatuan me mangësi në dokumentacion.

**Ankesa me mangësi në dokumentacion**
**2- Ankesë nga qytetarë të lagjes Vojo Kushi, Shkodër, e ardhur nga Platforma e Bashkëqeverisjes,** çështja nr. 375592, ankesë në të cilën ankohen për zhurma që shkaktohen nga disa transformator të supermarketit “B.M.”
**Dokumentacioni në praktikë**:
Autorizim nr. 758 datë 16.06.2022,
Relacion nr.758/2, datë 17.06.2022, dokument pa adresë, pa emra si dhe pa firmë të inspektorëve që kanë monitoruar ankesën.
Kthim përgjigje për AKM nr. 758/1, datë 17.06.2022.
**Mangësi**
- Në praktikë nuk është bashkangjitur Ankesa.

**3- Ankesë nga banorët e pallatit nr. 45, Lagja nr. 3**, Shkresa nr 982 prot, datë 15.09.2022, ankesë në të cilën banorët shprehin shqetësimin për zhurma që shkaktohen nga disa gjenerator të bizneseve që ndodhen pranë këtij Pallati.
**Dokumentacioni në praktikë**:
Autorizim nr. 982/1 datë 20.09.2022,
Relacion nr.982/2, datë 20.09.2022, dokument pa adresë, pa emra si dhe pa firmë të inspektorëve që kanë monitoruar ankesën.
**Mangësi**
- Nga ana e Titullarit nuk është bërë një kthim përgjigje, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, “Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale” Pika 14 dhe pika 15.

*Për sa është trajtuar në këtë Akt-Konstatim nr.7, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me të tyren nr. 504 prot., datë 16.06.2023 dhe me tonën nr. 351/2 prot datë 16.06.2023.*
<u>Pretendimi i subjektit:</u>
<u>Viti 2022</u>
**Ankesa nr. 1. Ankesë nga z. A. D., Lezhë, shkresa nr. 545 prot, datë 02.04.2022.**
Plotësim dokumentacioni.
**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>**
Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për këtë ankesë merret në konsideratë.
**Ankesa nr. 4. Ankesë nga banorja znj. V. L., Shkresa nr 1365 prot, datë 12.12.2022**
Plotësim dokumentacioni.
<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>
Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për këtë ankesë merret në konsideratë.

| **Titulli i gjetje** | Mangësi në dokumentacion në procesin e ankesave. |
|---|---|
| **Situata:** | Në lidhje me*: Verifikimin, ndjekjen dhe kthimin e përgjigjeve të ankesave të ardhura në* ARM Shkodër, Lezhë, Kukës*, nga qytetar dhe institucione të ndryshme për periudhën 01.09. 2020 deri 31.12.2020.*<br>Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua:<br>Janë protokolluar pranë institucionit 9 Ankesa nga të cila në dy raste:<br>- Nga ana e Titullarit nuk është lëshuar autorizim për monitorimin e ankesës veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, “Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë |

| | |
|---|---|
| | Rajonale” Pika 16, si dhe nuk është bërë një kthim përgjigje, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, “Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale” Pika 14 dhe pika 15.<br>Si dhe në dy raste:<br>- Nuk është përpiluar relacion për Titullarin e ARM mbi monitorimin e kryer për ankesën, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, “Detyrat Funksionale të specialist të sektorit të inspektimit mjedisor”, pika 11 si dhe në kundërshtim me rregulloren e brendshme “Detyrat Funksionale të specialist/inspektor të sektorit të inspektimit mjedisor”, pika 3 dhe pika 4.<br>Në lidhje me*: Verifikimin, ndjekjen dhe kthimin e përgjigjeve të ankesave të ardhura në* ARM Shkodër, Lezhë, Kukës*, nga qytetar dhe institucione të ndryshme gjatë vitit 2021.*<br>Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua:<br>Janë protokolluar pranë institucionit 14 Ankesa nga të cilat në dy raste:<br>- Nga ana e Titullarit nuk është bërë një kthim përgjigje, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, “Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale” Pika 14 dhe pika 15.<br>Si dhe në një rast:<br>- Nuk është bashkangjitur në praktikë dokumenti i Ankesës.<br>Në lidhje me*: Verifikimin, ndjekjen dhe kthimin e përgjigjeve të ankesave të ardhura në* ARM Shkodër, Lezhë, Kukës*, nga qytetar dhe institucione të ndryshme gjatë vitit 2022.*<br>Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua:<br>Janë protokolluar pranë institucionit 14 Ankesa nga të cilat në një rast:<br>- Nga ana e Titullarit nuk është bërë një kthim përgjigje, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, “Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale” Pika 14 dhe pika 15.<br>- Nuk është bashkangjitur në praktikë dokumenti i Ankesës. |
| **Kriteri:** | - Rregullore e brendshme për organizmin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit. |
| **Ndikimi/Efekti** | Mangësia në dokumentacionin për monitorimin e ankesave sjell një risk për saktësinë dhe efektivitetin në procesin e ankesave si dhe në kthimin e përgjigjes për to. |
| **Shkaku** | Mos plotësimi i Vakancave në Agjencinë Rajonale të Mjedisit. Lezhë, Shkodër dhe Kukës dhe mungesa e korrespondencës me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për plotësimin e tyre. |
| **Rëndësia** | E Mesme |
| **Rekomandim** | Të përgatiten dhe të protokollohet dokumentet e nevojshme gjatë procesit të monitorimit të ankesave duke respektuar dispozitat Ligjore. |

Për sa u trajtua në këtë Raport /përfundimtarë mbajnë përgjegjësi punonjësit e trajtuar në material.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në, Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, fondet për zërin shpenzime operative (llogaria 602 kanë qenë të reduktuar. Gjatë vitit 2021 ARM ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme shtesa fondesh për zëra të ndryshëm në llogarinë 602.Kryesisht ka patur detyrime të akumuluara për shërbimet e energjisë elektrike dhe postës. Faturat tatimore për këto lloj shërbime nuk janë likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontrakture e tregtare*", neni 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandim:** Drejtori i Institucionit në bashkëpunim me Sektorin e Financës të marrë masa për likuidimin e detyrimeve kontrakture dhe tregtare brenda afateve të përcaktuara.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, rezulton se ARM Lezhë, Shkodër, Kukës nuk ka hartuar dhe dorëzuar raportimet 4 mujore të monitorimit të buxhetit, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në kundërshtim me nenin 65 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandim:** Drejtori i Institucionit në bashkëpunim me Sektorin e Financës të marrin masa për hartimin dhe dërgimin periodik të raporteve të zbatimit të buxhetit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për të gjitha periudhat e raportimit.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, u konstatua se nuk respektohet struktura e miratuar pasi numri i punonjësve është 29 kur në bazë të Urdhrit nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit duhet të jetë 42 punonjës, ose pozicione pune të paplotësuara me punonjës rreth 30%, faktor i cili ndikon në realizimin e objektivave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 20-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandim:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të marrë masa për plotësimin e pozicioneve të lira të punës sipas organikës.

**Në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, për periudhën objekt auditimi nuk është kryer nga Specialisti i Burimeve Njerëzore azhornimi i dosjeve të personelit, regjistrave, librezave të punës etj., në sistemin HRMIS. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 21-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandim:**Specialisti i Burimeve Njerëzore të marrë masa të kryej azhornimin e vazhdueshëm të informacionit të dosjeve të personelit me sistemin HRMIS.

**Në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 13 dosjeve personale të punonjësve të ARM Lezhë u konstatua se në 6 prej tyre mungonte Fleta e inventarit me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje, kjo në kundërshtim me VKM nr.117, datë 05.03.2014 "*Për përmbajtjen,*

*procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit"* në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë: Lidhja nr. 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 19-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**5.1.Rekomandim:** Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Financës të marrë masa për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të dosjeve të personelit sipas kërkesave ligjore.

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, (anëtarët e komisionit), në momentin e fillimit në objekt të procesit të inventarizimit, nuk kanë përpiluar deklarata, nëse kanë konflikt interesi, në moszbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*".
-ARM Lezhë-Shkodër-Kukës, (Sektori i Financës) nuk ka hartuar/plotësuar regjistrin e aktiveve formati i të cilit përmban datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, datën e kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, kohën e shpenzimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes , datën e daljes nga pronësia, në moszbatim të UMF nr.30, datë 27.12.2011"*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* pika 82, 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1. Rekomandim:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës (Sektori i Financës), të marrë që anëtarët e komisionit të inventarizimit të përpilojnë deklaratat e konfliktit të interesit në momentin e fillimit të procesit të inventarizimit si dhe të hartojë/plotësojë regjistrin e aktiveve.

**Në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Sektori i Ujërave në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë-Shkodër-Kukës, (Sektori Ujëra) në inspektimet e kryera gjatë periudhës Qershor 2021-Dhjetor 2021, ka ushtruar inspektime në 57 subjekte, sipas autorizimeve për inspektim të lëshuara nga Drejtori i ARM-së, Lezhë me objekt: "leje të burimeve ujore", *vetëm për zbatimin e kushteve të lejes së përdorimit të burimit ujor (Pus e çpim),* në një kohë që plani i miratuar nuk parashikon zgjedhje të procedurave të veçanta për inspektim, por vetëm subjektin e inspektimit, në moszbatim të planeve mujore të inspektimeve Qershor-Dhjetor 2021.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 87-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**7.1. Rekomandim:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, të marrë masa të kryejë inspektimet e Sektorit të Ujërave mbi bazën e planit të miratuar për vitin dhe të detajuar për çdo subjekt.

**Në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Sektori i Mjedisit dhe Burime Ujore Lezhë, Shkodër, Kukës, gjatë periudhës 01.09.2020 deri 31.12.2022, nga inspektimet e kryera, në 38 (tridhjetetetë) raste janë vendosur sanksione kryesore ligjore (gjoba) në vlerën e përgjithshme prej 9,330 mijë/lekë.
Për **8** subjekte në shumën **930 mijë/lekë**, nga ana e ARM Lezhë nuk është ndërmarrë asnjë hap për të filluar procedurën e arkëtimit të gjobave, pavarësisht se janë brenda afatit.
Gjoba e vendosur gjatë muajit Shtator 2020, për subjektin R. 2015, prej **50 mijë/lekë, është parashkruar.**
*Janë pothuajse të parashkruara gjobat e vendosura në muajin Qershor 2021, për:*

-B. 50 mijë/lekë, data 24.06.2021
-F. SH.-100 mijë/lekë, data 25.06.2021
Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "*Për Kundërvajtjet Administrative", "Parashkrimi i dënimit administrative"* neni 46.
**Gjithashtu konstatohet se në asnjë rast nga ana e** Drejtorit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit **Lezhë, Shkodër, Kukës, nuk i është drejtuar Ministrit, me propozimin për pezullimin e lejes së subjektit, i cili nuk ka paguar gjobën,** në kundërshtim me ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", neni 69, pika 8.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 89-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**8.1. Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, deri në arkëtimin e plotë të gjobave të vendosura, duke nisur me ato gjoba që janë më afër afateve të parashkrimit 2 vjeçar, si dhe t`i drejtohet Ministrit, me propozimin për pezullimin e lejes së subjektit, për ata që nuk paguajnë gjobën.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk ka bazë të dhënash të subjekteve të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis, mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit bazuar mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut, në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "*Për Mbrojtjen e Mjedisit"* seksioni 2, nenet 62-66 "*Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit*". Po ashtu, nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut dhe frekuencën e inspektimit gjatë një vetitë subjekteve që do të inspektohen (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr.56-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**9.1.Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës në bashkëpunim me sektorin e Mjedisit dhe të sektorit të Ujërave, të marrë masa për krijimin e regjistrave të subjekteve që ushtrojnë aktivitet si dhe krijimin e dosjeve për çdo subjekt në sistem, e-Inspektimit .

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**10.1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, programi vjetor i inspektimit për periudhën shtator 2020 dhjetor 2022, nuk është hartuar sipas përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjat "a, c, ç dhe d" të pikës 2 të Urdhrit nr.5, datë 19.02.2015 "*Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve".*
Gjithashtu programet mujore të inspektimit, nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 "*Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi*".
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 60-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**10.1. Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës në bashkëpunim, me sektorët e inspektimit, të marrë masa për subjektet e inspektuara, të bëjë një vlerësim të paraqitjes sipas kërkesave ligjore, ku në bazë të këtij vlerësimi të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët), gjatë planifikimit të inspektimit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Në inspektimet e kryera në terren, për plotësimin e procesverbalit të inspektimit nuk është i gjithë informacioni i nevojshëm duke u bazuar në kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti dhe zbatimin e secilit prej kushteve, si dhe të gjitha mangësitë

e konstatuara nga ushtrimi i aktivitetit, sipas inspektimit në terren nga ana e inspektorëve, nuk ka përshkrime specifike mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore, veprime në kundërshtim me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011"*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*" nenin 45-48,ku neni 45 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 70-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të marrë masa që Sektori i Mjedisit dhe Ujërave pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës në çdo inspektim të kryer në terren, të plotësoj sipas formatit procesverbalin e inspektimit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Përgjegjësi i Sektorit të Mjedisit dhe Ujërave ka hartuar dhe paraqitur periodikisht pranë Drejtorit raporte mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, për verifikimin e detyrave të lëna, por nuk janë paraqitur periodikisht pranë AKM –së, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 90-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të marri masa që në çdo fund muaji të hartojnë dhe të paraqesin periodikisht pranë AKM –së, një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, me qëllimi miratimin e planeve mujore për verifikimin e detyrave të lëna**.**

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, sektori i mjedisit nuk ka kryer verifikim në terren për subjekte, që kalojnë kapacitetet, nga lejet të Tipit C, në leje të Tipit B, pas ndryshimeve ligjore nr. 52/2020 "*Për Lejet Mjedisore*". *Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr.40-4,të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, në bashkëpunim me Sektorin e Mjedisit, të marrë masa për të kryer verifikimin në terren të subjekteve, që kalojnë kapacitetet për tu pajisur me leje mjedisore.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se formulari i Inspektimit, për paragrafin "I", pika 3 "*Të dhënat të përgjithshme të subjektit*", "*Lloji i aktivitetit ekonomik*" gjenerohet nga sistemi dhe plotësohet me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë, gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet kjo nga numri i lartë i aktiviteteve që operojnë në Qarkun e Lezhë, Shkodër, Kukës .(*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të marrë masa, që në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, të përmirësojnë formatin elektronik, "pikën 3 Lloji i aktivitetit", me qëllim që të identifikohet saktë veprimtaria dhe aktiviteti i subjektit në rubrikën përkatëse.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në 21 subjekte, nga të cilat 12 raste në nxjerrjen e mineraleve, rërës argjilës nga karrierat në qiell të hapur në 9 subjekte me veprimtari të ndryshme, inspektorët në procesverbal kanë cituar se: "*subjekti u gjend i mbyllur*", ose nuk kryen aktivitet, Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit dhe nuk është lënë detyrë për paraqitje në ARM për marrje dijeni të problemeve të trajtuara. Veprime jo në

përmbushje të Nenit 36- *Detyrimet e subjektit të inspektimit pika "d";* me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "*Për Mbrojtjen e Mjedisit*" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit" si dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011"*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr.61-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB-së, me qëllim që të hartojnë dhe nxjerrjen e autorizimeve për kryerjen e inspektimeve, ndaj subjekteve që janë aktiv/pasiv, në të kundërt të merren masa administrative (gjobë) sipas ligjit në fuqi.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua që subjektet që kryejnë veprimtari të ndryshme por që nuk kanë detyrim ligjorë për zbatimin e te gjitha kushteve të lejes mjedisore, nuk kanë përcjelle pranë AKM së Tiranë , raport me përshkrim të saktë , sipas Urdhrit të Ministrit nr.163 datë 16.06.2020,"Për instalimet ekzistuese të lejeve te Tipit C të cilat kalojnë kapacitete në leje te Tipit B,( *Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe.62-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1. Rekomandim:** Inspektorët e sektorit të Mjedisit, të marrin masa dhe të identifikojnë të gjitha subjekte që kryejnë veprimtari të ndryshme, por që nuk kanë detyrim për plotësimin e të gjitha kushteve të lejes tu lihet detyre që të paraqesin pranë AKM-së, një raport me shkrim për veprimtarinë që kryejna që mos të jenë të përfshirë në liste verifikim .

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, nga shqyrtimi i ankesave të qytetarëve të protokolluara pranë ARM Lezhë, Shkodër, Kukës, u audituan 37 ankesa nga të cilat rezultojnë parregullsi si më poshtë:

- Nga ana e Drejtorit në dy raste nuk është lëshuar autorizim për monitorimin e ankesës veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "*Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale*" Pika 16, si dhe nuk është bërë një kthim përgjigje, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "*Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale"* Pika 14 dhe pika 15.
- Në dy raste nuk është përpiluar relacion për Drejtorin e ARM mbi monitorimin e kryer për ankesën, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "*Detyrat Funksionale të specialist të sektorit të inspektimit mjedisor*", pika 11 si dhe në kundërshtim me rregulloren e brendshme "*Detyrat Funksionale të specialist/inspektor të sektorit të inspektimit mjedisor"*, pika 3 dhe pika 4.
- Në tre raste nuk është bërë një kthim përgjigje, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme për ARM Shkodër, Lezhë, Kukës, "Detyrat funksionale të Drejtorit të Agjencisë Rajonale" Pika 14 dhe pika 15.
- Në dy raste nuk është bashkangjitur në praktikë dokumenti i Ankesës. ( *Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 94-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1. Rekomandim:** Drejtori Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës dhe grupet e punës të përgatisin dhe të protokollojnë dokumentet e nevojshme gjatë procesit të monitorimit të ankesave të qytetarëve duke respektuar procedurat**.**

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ankesave të mbërritura në ARM, mbi çështjet e ndotjes së mjedisit, rezulton se shqetësuese mbetet mungesa e laboratorit dhe pajisjeve të akredituara, për realizimin e matjeve dhe nxjerrjen e përfundimeve. Deri në momentin e auditimit, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk janë marrë masa për t’i dhënë një zgjidhje këtij problemi. Në pjesën më të madhe të ankesave, në mungesë të laboratorit dhe pajisjeve matëse të akredituara, ARM nuk është në gjendje t’i kthejë përgjigje qytetarëve nëse shqetësimi i tyre mbi nivelin e ndotjeve qëndron dhe rrjedhimisht të marrë edhe masat e nevojshme, siç përcaktohet në kuadrin ligjor që sanksionon veprimtarinë e saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 94-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**18.1. Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të marrë masa në bashkëpunimin me Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, të zgjidhin procesin e realizimit të matjeve të nivelit të ndotjeve në mjedis.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, për periudhën shtator 2020 dhjetor 2022, në 97 praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B, në dosjet përkatëse mungojnë dokumente mbështetëse, që dëshmojnë realizimin e procedurave si: akt-verifikime apo akt inspektime në terren, dokumente këto paraprake, mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 48-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**19.1. Rekomandim:** Sektori i Lejeve, në praktikat e dhënies së mendimit për VNM apo mendime për Leje Mjedisore Tipi A/B, të bashkëlidhin dhe përfshijnë në dosje dokumente plotësuese dhe mbështetëse, që të vërtetojnë realizimin e procedurave në dhënien e mendimit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**20. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi u konstatua se 85 raste, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës për periudhën shtator 2020- dhjetor 2022, ka dhënë mendime për VNM paraprake të thelluar dhe për leje mjedisore të Tipit A, B, duke i përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Si palë e përfshirë në proces, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës nuk ka marrë informacione për vendimet e marra nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, veprime këto që janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe me nenin 11 të Ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011 “*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*”.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 44-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**20.1. Rekomandim**: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të kryejë korrespondencë zyrtare me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për vendimet e marra për VNM paraprake/të thelluar dhe me Qendrën Kombëtare të Biznesit për aplikimet për Leje mjedisore Tipi A/B dhe përditësimin në formë elektronike të regjistrit të lejeve të tipit A/ B dhe VNM-ve.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, gjatë periudhës shtator 2020 dhjetor 2022, për 34 raste, procedurën e dëgjesës me publikun për lejet mjedisore Tipi A / B, i ka realizuar në një afat të shkurtër kohor ( 5-7 ditë

) nga delegimi i dëgjesës nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit .*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 36-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**21.1.Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të marrë masa që njoftimi i dëgjesës me publikun të qëndrojë i publikuar në faqen e web-it, për një afat 15 ditor, me qëllim sensibilizimin dhe informimin sa më shumë pjesëmarrësve në takim.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**22**. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se 12 subjektet me aktivitet, gurore nxjerrja e mineraleve rërës dhe argjilës, nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe etj.. aktiviteti të kësaj natyre, për të cilat nuk përcaktohet se çfarë lloj sipërfaqe është pjesë jo pyjore e fondit pyjor apo fond pyjor e shpërndarë sipas zërave kadastra l të fondit pyjor e kullosor si: pyll tru ngishte, pyll cungishte, pyll shkurre, kullota, tokë me bimësi pyjore dhe djerr, tokë in produktivë ose të zhveshur, nuk ka informacion nëse janë hequr nga fondi pyjor, i cili është detyrim i çdo do bashkie, kur një fond pyll cungishte , etj... është i pajisur me leje shfrytëzimi dhe të jene hequr nga fondi pyjore., sipas VKM-së, nr.391 datë 21.06.2006 "*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*" pika 8 i cili përcakton: "Për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 8, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi Lidhja 8 "*Tarifat e shpërblimit të dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor*" pika 15.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 60-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**22.1. Rekomandim:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të marri masa dhe të bashkëpunojë me Bashkitë të cilat kanë në juridiksionin e tyre subjektet të cilat kryejnë veprimtari "të nxjerrjes guri, argjile dhe zhavorr miniera gurore dhe nxjerrje mineralesh të ndryshme", për të konstatuar dhe evidentuar situatën e gjendjes së mjedisit, ekzaminimin e dëmtimeve në mjedis të shkaktuar nga aktiviteti i tyre. Nëse këto subjekte disponojnë kontrata dhe të dhëna të tjera tekniko-ligjore, mbi bazën të cilave duhet të bëhet një vlerësim i shkallës së ndikimit në mjedis në terrenet pyjore e kullosore dhe në raste kur ka shkelje të bëhet përcaktimi i vlerës së dëmit dhe kërkimin e rehabilitimit të këtyre parcelave, në të kundërt të bëhet dënimi me masë administrative "gjobë".

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, për 20 subjekte (për plotësimin e dosjeve të subjekteve me dokumentacion si dhe të dosjeve në sistemin e-Inspektimeve duke aplikuar masa administrative) për subjektet të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e vetmonitorimit/vete monitorimit mjedisor si dhe dokumentacion ligjore, përkatësisht,

| Nr. | Subjekti | Aktiviteti | Listë verifikimi |
|---|---|---|---|
| 1. | M. | Industria minerare | AKM-LE-2021-000225 - 2/1 |
| 2. | S.M.O.U. | Menaxhimi i mbetjeve | AKM-LE-2021-000224 - 2/1 |
| 3. | L.Gj. | Prodhime te ndryshme beton | AKM-LE-2021-000010 - 2/1 |
| 4. | B. | Menaxhimi i mbetjeve | AKM-LE-2021-000220 - 2/1 |
| 5. | L.2. | Menaxhimi i mbetjeve | AKM-LE-2021-000221 |
| 6. | I.N.C.A. N. F. | Veprimtari te ndryshme | AKM-LE-2020-000079 - 1 |
| 7. | Co. A.SHPK | Miniera Karriera | AKM-LE-2021-000029-2/1 |
| 8. | U. | Menaxhimi i mbetjeve | AKM-LE-2021-000229 - 2/1 |
| 9. | A. | Industria minerare | akm-le-2022-000050-2/1 |
| 10. | T.A. c. | Industria minerare | AKM-LE-2022-000025 - 2/1 |
| 11. | A. – K. | Industria minerare | AKM-LE-2022-000028-2/1 |
| 12. | I.M. I. | Industria minerare | AKM-LE-2022-000038 - 2/1 |
| 13. | G. | Industria minerare | AKM-LE-2022-000013-2/1 |
| 14. | R. | Industria minerare | AKM-LE-2022-000068 - 2/1 |
| 15. | 2R-G. | Blegtoria | AKM-LE-2022-000120 - 2/1 |
| 16. | S.-A. | Industria minerare | AKM-LE-2022-000016 - 2/1 |
| 17. | Ll. | Industria minerare | AKM-LE-2022-000026-2/1 |
| 18. | C. A. | Industria minerare | AKM-LE-2022-000118 - 2/1 |
| 19. | A. – K. | Industria minerare | AKM-LE-2022-000028 - 2/1 |
| 20. | K. | Veprimtari te tjera | AKM-LE-2022-000013- 2/1 |

për 20 subjekte (për plotësimin e dosjeve të subjekteve me dokumentacion si dhe të dosjeve në sistemin e-Inspektimeve duke aplikuar masa administrative)për subjektet të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e vetmonitorimit/vete monitorimit mjedisor si dhe dokumentacion ligjore, *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5 në faqet 63-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**23.1.Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të kryejë inspektimin dhe verifikimin e 20 subjekteve sipas tabelës së mësipërme, të cilët nuk kanë plotësuar raportet e monitorimit mjedisor dhe të aplikoj masa administrative.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

***Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.***

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**